

AKADEMIA E SHKENCAVE E RPSSH TË SHQIPËRISË
INSTITUTI I HISTORISË

949.65

P 94

**PROBLEME
TË PAVARËSISË
SË SHQIPËRISË**

84P.65

294

AKADEMIA E SHKENCAVE E RPS TË SHQIPËRISË
INSTITUTI I HISTORISË

PROBLEME TË PAVARËSISË
SË
SHQIPËRISË

(Referate)



TIRANË 1987

Në këtë libër botohen referatet e mbajtura në Konferencën Kombëtare kushtuar 75-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë të organizuar nga Akademia e Shkencave e RPSSH në bashkëpunim me Universitetin e Tiranës «Enver Hoxha».

196 kört libet bolohen reletet e mpa-
tura na konteneren Kompletne kashnau
Tš-vertout to špajjes se Pavševiš se
Špajjes to organizat na Alaboma e
Špajjes e TUSA na bashkoven na me
Univerzitetin Tins - Tins - Tins

ALEKS BUDA

FJALA E HAPJES

Të dashur shokë e shoqe!

Ngjarja së cilës i kushtohet Konferenca jonë, e organizuar nga Akademia e Shkencave në bashkëpunim me Universitetin «Enver Hoxha» të Tiranës me rastin e 75-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, nuk e merr rëndësinë e saj dhe domethënien thjesht e vetëm nga vitet që na ndajnë prej saj — në historinë e një populli shtatë dekada nuk janë shumë. Domethënien e saj të veçantë ajo e merr nga rruga aq e vështirë që iu desh popullit shqiptar të vijë te kjo ditë, një rrugë aq dramatike, hipje e zbritje, vuajtjesh e sakrificash drejt pavarësisë kombëtare. Janë pikërisht këto rrethana që e bëjnë popullin shqiptar ta presë këtë ditë si një datë kulmore, madhore të historisë së tij. Me gjithë masat punonjëse që e presin këtë ditë me një hov të ri patriotizmi e fitoresh në punën e tyre krijuese, bashkë me ne e presin këtë ditë të gjithë bashkatdhetarët, të gjithë shqiptarët kudo që të jenë, të cilët me atdheun mëmë janë të lidhur me mendje e zemër, me mijëra fije të dashurisë e të traditës historike.

Më lejoni që në emrin tuaj t'u shpreh gëzimin e mirënjohjen tonë shokut Ramiz Alia dhe udhëheqësve të tjerë të Partisë e të shtetit që na nderojnë me praninë e tyre në punimet e kësaj konference.

Nuk janë në vetvete dekadat; domethënien e kësaj dite e jep ai dimension tronditës, tragjik e heroik, ai raport midis një robërie mijëvjeçare në kuadrin e nën thundrën e perandorive botërore që e çuan popullin shqiptar deri në buzë të greminës, të zhdukjes së tij fizike dhe kësaj fitore të vonë të jetës së pavarur shtetërore — më vonë se shumica e popujve evropianë.

Këtë rrugë historike drejt pavarësisë e sovranitetit, Konferenca jonë i vë vetes për detyrë ta pasqyrojë në disa aspekte kryesore në dritën e metodologjisë dhe dialektikës sonë materialiste, në dritën e mendimit shkencor të Partisë dhe të mësuesit tonë të madh, shokut Enver: të zbulojë ndërthurjen dramatike, dialektikën e bashkëveprimit të faktorëve të brendshëm subjektivë e objektivë, pozitivë, me faktorët e jashtëm aq herë negativë; të vejë në dukje proceset ekonomike e shoqërore, politike dhe ideologjike-kulturore të ndërlikuara që vepruan për arritjen e asaj fitoreje që përbën 28 nëntori 1912. Me konceptet dhe rezultatet e saj shkencore që do pasqyrohen në disa aspekte në këtë konferencë, historiografia jonë i kundërvihet në mënyrë ballore një vargu pikëpamjesh metodologjike semipliste, antishkencore, prapa të cilave fshihen shpesh qëndrime antishqiptare që shfaqen ende sot, sidomos në lidhje me rrugën historike të popullit drejt 28 nëntorit 1912.

Akti historik i Vlorës, ajo sfidë historike nuk qe, siç është thënë, një rrjedhim mekanik i zbrazëtisë që paska shkaktuar shembja e perandorisë së sulltanëve, një rrjedhim koniunkturash diplomatike, makar as një dhuratë miqsh të dyshimtë, ashtu si nuk qe ky popull, ashtu siç duan ta paraqesin, karakterizuar gjatë historisë së tij nga paaftësia për një jetë të përparuar shoqërore e shtetërore, nga përçarja në krahina, fise e fe — një konglomerat pa unitet ekonomik e territorial — asgjë tjetër veçse një

material brut për të mbushur e plotësuar kërkesat e njerës a tjetrës fuqi të madhe ose të vogël.

Rrjedhë procesesh shekullore, konvergjençash ekonomike-shoqërore, kulturore e historike, tradita të mëdha lirisdashëse, lufta për lirinë dhe pavarësinë, për përparimin ka përbërë një komponente të përhershme, të vazhdueshme, të pashlyeshme që ka përshkuar historinë e këtij populli fanatik lirisdashës nëpër shekuj.

Sfida shqiptare e 1912-ës nuk lejoi realizimin e planeve grabitqare të imperializmit e shovinizmit ndërkombëtar: por ajo nuk mundi t'i ndalë dorën politikës kriminale shtetmadhe që u vu në lëvizje e veprim sa herë që i shfaqej mundësia e volitshme për të realizuar copëtimin e «presë» shqiptare. Prologu qe 1878, verdikti imperialist u dha më 1912-13 dhe orvatje të reja vijuan më 1915-19-20 për t'u përsëritur më 1939 e 1943.

Jo në tryezën e gjelbër të diplomacisë u vunë bazat e lirisë sonë shtetërore e të pavarësisë e të përparimit. Ajo faqe e re që u hap në Vlorë në librin e historisë, ajo portë drejt së ardhmes nuk mund të mbyllej më kurrë; ashtu si nuk mund të shuhej më kurrë ajo shprehje objektive e ligjshme e zhvillimit historik, kërkesa për bashkimin e këtij kombi, e shprehur botërisht kaq herë në vendimet, thirrjet, kërkesat drejtuar bashkëkohësve, drejtuar botës në kuvendet e shekujve, nga lidhja e madhe shqiptare në Prizren, nga Kuvendet kryengritëse të Greçes, Sinjës, Junikut, në pragun e pavarësisë dhe në kuvendin Kombëtar në Vlorë. Njësia ishte komponentja plotësuese e Pavarësisë; kjo donte të thoshte mishërimi i kombit si realitet veprues, i pavarur, i përparimit historik-shoqëror, ekonomik, politik e kulturor.

Është një komponente themelore e konstante e historisë së veprimit e proceseve madhore të përparimit që janë shprehje ligjësish objektive, siç qe 28 nëntori 1912, mund ta vonojnë, por nuk mund t'i shpërbëjnë as intrigë e mashtrim, as komplete e tradhti të klasave sunduese dhe politika e tyre antipopullore e antikombëtare, kur prapa tyre qëndrojnë forcat e masave popullore dhe në krye të

tyre qëndron një mendim politik, një ideologji përparimtare e revolucionare. Me gjithë kufizimin e tyre, ky qe mësimi i ngjarjeve të 1878, të 1912, 1920, por ky qe mësimi madhor i pavdekshëm i asaj epoqe që nisi më 8 nëntor 1941 dhe çoi në fitoren më të madhe të popullit shqiptar — në fitoren e 29 nëntorit 1944.

Dy datat e mëdha që për vit vijnë të dyja së bashku, bij të lavdishëm të nëntorit tonë të kuq, janë pjesë të pandashme të historisë sonë. Ato janë mish prej mishi e gjak prej gjaku të historisë së popullit tonë punonjës, i cili nën udhëheqjen e Partisë së klasës punëtore me në krye shokun Ramiz Alia, duke ndjekur mësimet e udhëheqësit e mësuësit të pavdekshëm Enver Hoxha, po ndërton sot në këtë truall të lashtë të kombit tonë mbi themelet e një historie heroike mijëravjeçare, kështjellën vigane të socializmit.

STEFANAQ POLLO

SHPALLJA E PAVARËSISË SË SHQIPËRISË

Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë më 28 nëntor 1912 i dha fund sundimit shekullor osman duke shënuar një kthesë rrënjësore në fatet e vendit. «Populli shqiptar, ka thënë shoku Enver Hoxha, i dha grushtin e fundit ushtarako-politik Perandorisë Otomane, duke kurorëzuar ëndrat dhe aspiratat mijëvjeçare dhe revolucionare të tij... Shqipëria u shpall sovraane, e pavarur jo vetëm ndaj zgjedhës otomane por edhe ndaj çdo zgjedhe e zinxhirëve të rinj që farkëtoheshin për ne në kudhurat e imperialistëve e të fqinjëve».¹ Rilindja Kombëtare arrinte me këtë apogjenë e vet, sepse pavarësia kurorëzonte luftërat e përpjekjet heroike të brezave të tërë për të kthyer lirinë e humbur, për të gëzuar të drejtat kombëtare dhe për t'i hapur vendit rrugën e zhvillimit e të përparimit.

Me vendimin historik të Kuvendit të Vlorës triumfante edhe në Shqipëri parimi i kombësisë i shpallur nga rilindësit tanë dhe nga demokracia ballkanike dhe evropiane qysh në shek XIX. Vihej në vend kështu një e drejtë imanente e një kombi të formuar në territorin e vet të

1) Enver Hoxha. *Për shkencën*. Tiranë, 1985, v. I, f. 113.

banuar pa ndërprerje gjatë shekujve, me gjuhë, kulturë, histori e individualitet të vetin, e drejtë e fituar në llogoret e një lufte të gjatë e të ashpër, e drejtë që i takonte edhe për kontributin e vyer që kishte dhënë në procesin çlirimtar ballkanik dhe evropian.

Me gjithë kufizimet e saj, pavarësia, e parë edhe nën prizmin e zhvillimeve të mëvonshme, e afirmoi me dinjitet idenë e madhe të kombësisë dhe të unitetit kombëtar edhe pse vendi ishte në pjesën më të madhe i pushtuar nga ushtri të huaja.

Pavarësia e Shqipërisë nuk ishte thjesht vepër e një grushti patriotësh që ngritën flamurin në Vlorë. Ata sigurisht kanë vendin e tyre të nderuar në histori. Por ata dhe Kuvendi Kombëtar i Vlorës sanksionuan juridikisht me një akt të nënshkruar nga përfaqësuesit e kombit atë që kishin përgatitur gjatë dhjetëra e dhjetëra vjetëve, me luftë, vuajtje e sakrificat masat e gjera popullore në të gjitha trevat shqiptare. Në themelet e pavarësisë kishte vënë gurë e gjithë Shqipëria.

Ngjarjet e shënuara përfaqësojnë vepra madhore të popullit. Ato marrin një vlerë të veçantë kur kanë karakter progresiv, i japin lëmshtit të kontradiktave një zgjidhje të drejtë në përputhje me prirjet pozitive të zhvillimit historik. Shpallja e Pavarësisë bën pjesë në ato ngjarje që shënojnë etapa në procesin historik. Ajo mbylli një epokë, epokën e shkëlqyer të Rilindjes për t'u çelur brezave të ardhshëm rrugë të reja. Si e tillë ajo ka rëndësi jo vetëm për kohën kur ndodhi e për kthesën që shënoi, por edhe për pasojat pozitive që la pas. Ajo ruan vlerën e saj edukuese e mobilizuese edhe për të ardhmen. Prandaj kremtimi i përvjetorëve të saj, evokimi i bëmave të të parëve tanë, vlerësimi i tyre në dritën e dialektikës marksiste përbën një detyrë jo vetëm për historianët, por për gjithë shoqërinë. Dashuria dhe respekti për të kaluarën e ndritur janë një nga dëshmitë më shprehëse të patriotizmit e të vitalitetit të popullit tonë. Kremtimi i ngjarjeve të mëdha historike bëhet nga ana tjetër një nxitje për t'u thelluar në studimin e tyre mbi bazën e fakteve të reja

e të nivelit të arritur metodologjik të shkencës historike.

Historiografia jonë e re i ka pasur gjithmonë në qendër të vëmendjes së saj problemet e pavarësisë ashtu si edhe ato të ngjarjeve të tjera të mëdha të historisë sonë kombëtare. Trashëgimi shkencor për këto probleme, siç dihet, ka qenë relativisht i varfër. Duke u mbështetur në radhë të parë në dokumentet e botuara e të pabotuara, vendase e të huaja, në shtypin e kohës dhe në memorialistikën me vlerë të brezit të pavarësisë, që përveç fakteve të pafixsuara në dokumentet na japin edhe opinionet, qëndrimet, gjykimet, aspiratat e pjesëmarrësve aktivë në ngjarjet, historianët tanë të udhëhequr nga teoria dialektike materialiste, nga mësimet e Partisë sonë e të shokut Enver Hoxha kanë thënë fjalën e tyre me peshë për problemet e pavarësisë, siç e dëshmojnë edhe botimet e këtyre viteve të fundit.

Problemet e pavarësisë së Shqipërisë dhe të rrugëve që çuan te ajo kanë qenë objekt i një interesimi të veçantë dhe nga historiografia e huaj, sidomos ballkanike. Krahas përpjekjeve për një trajtim objektiv të ngjarjeve janë dhënë sidomos në vitet e Shpalljes së Pavarësisë, edhe trajtesa të sipërfaqshme e tendencioze, me vlerësime të pathemelta dhe aprioristike.

Pas Luftës së Dytë Botërore filluan të duken në studimet e huaja për problemet e pavarësisë shqiptare vlerësime të reja objektive që i detyrohen zhvillimit të historiografisë në përgjithësi, pozitave të pavarura demokratike e progresiste të autorëve, si edhe, në radhë të parë, rolit aktiv të historiografisë së re shqiptare në botën e jashtme. Megjithatë edhe sot e kësaj dite vazhdojnë t'i ofrohen lexuesit, por në formë më të stërholluar e me disa «lëshime», shtrembërimet e vjetra tradicionale anti-historike dhe antishqiptare të nisura kryesisht nga interresa joshkencore.

Problemi kyç ku janë ndeshur e ndeshen pikëpamjet diametralisht të kundërta të historiografisë shqiptare nga njëra anë dhe të një pjese të asaj të huaj nga ana tjetër

ka qenë nëse pavarësia e Shqipërisë ishte vepër e shqiptarëve apo e të huajve, ka qenë rezultat i luftës së pandërprerë të kombit shqiptar për çlirimin e vet dhe formimin e shtetit të pavarur, pra një kurorëzim i Rilindjes sonë apo ka qenë dhuratë e Fuqive një vendi që s'e priste, pra një zgjidhje koniukturore artificiale e përcaktuar nga interesat e këtyre fuqive, nëse shteti i pavarur shqiptar ishte vepër e forcave të brendshme kombëtare apo një krijesë ndërkombëtare e Fuqive të Mëdha etj. etj.

Historiografia e re shqiptare e ka përcaktuar tanimë qëndrimin e vet ndaj këtyre çështjeve dhe u ka dhënë atyre një përgjigje të argumentuar e të dokumentuar.

*
* *
*

Shpallja e pavarësisë nuk ishte një akt i veçantë. Ajo u përgatit hap pas hapi, me kujdes, durim, guxim, me ndjenjën e përgjegjësisë për dhjetëra e dhjetëra vjet. Ashtu si protagonistit kryesor të saj Ismail Qemalit i vinte pas historia, siç thotë kënga popullore, ashtu edhe pavarësisë i parapriu një histori e tërë. Akti i 28 nëntorit nuk mund të kuptohet pa këtë histori. Ata që e nënshkruan dokumentin e pavarësisë nuk ishin njerëz të rinj që i nxori në skenë gjendja e ndërlikuar e krijuar nga Lufta e Parë Ballkanike dhe nevoja për të gjetur një rrugëdalje. Një pjesë e mirë e atyre që u mblodhën në Kuvendin e Vlorës e kishin filluar veprimtarinë patriotike shumë kohë përpara dhe ishin dalluar si luftëtarë të pushkës e të penës për çlirimin kombëtar.

Pavarësinë e lidhin organikisht me Rilindjen jo vetëm protagonistët, por edhe mendimi e veprimi patriotik e revolucionar i tyre e në mënyrë të veçantë i masave popullore që panë te akti i 28 Nëntorit shpërblimin për gjakun e dërdhur, për vuajtjet e sakrificat e bëra për të arritur atë ditë. Prandaj pavarësia dhe Rilindja jonë janë një e tërë dhe e pandarë.

Rilindja luftoi kundër shtypjes kombëtare jo vetëm me mjetet materiale të qëndresës së armatosur, por edhe me mjetet intelektuale, me idetë të cilat argumentonin të drejtat e popullit shqiptar për një ekzistencë të pavarur dhe e frymëzuan, e mobilizuan atë në luftë. Kur patriotizmi i rilindësve u vesh me idetë e mëdha të iluminizmit dhe racionalizmit evropian mendimi politik e shoqëror i Rilindjes u ngrit në një shkallë më të lartë e mori një përmbajtje të re. Këto ide iu përshtatën realitetit shqiptar e iu përgjigjën kërkesave të shtruara nga vetë shoqëria shqiptare në zhvillim. Kështu idetë mbi lirinë e pavarësinë e atdheut gjetën në penën e rilindësve argumentimin teorik të mbështetur jo vetëm mbi të drejtën natyrore të popullit shqiptar. Ata iu drejtuan edhe historisë për të vërtetuar lashtësinë e shqiptarëve në trojet e veta, individualitetin e tyre kombëtar, luftërat e parreshtura kundër sundimit të huaj, kontributin e dhënë në çështjen e përbashkët të çlirimit të popujve ballkanikë dhe evropianë etj. Intelektualët patriotë gjallëruan kujtimet historike që populli i kishte ruajtur në këngët e legjendat e tij, ata vunë në dukje traditat e përbashkëta, ata e kuptuan dhe bënë ta kuptonin të tjerët rëndësinë e bashkësisë gjuhësore, territoriale, shpirtërore, ata luftuan për ta kthyer vetëdijen popullore në ndërgjegje kombëtare. Në një vend si Shqipëria ku bashkimi në lëvizjen për çlirimin kombëtar, i popullsisë së ndarë në tri fe të ndryshme, ishte kusht i domosdoshëm i suksesit, kjo ndërgjegje nuk mund të formohej veçse jashtë feve, mbi fetë, duke shpallur si parim themelor të Rilindjes — shqiptarizmin.

Idetë e reja u përhapën gjerësisht në rrethet e kulturuar brenda e jashtë vendit nëpërmjet librave e shtypnit dhe depërtuan dora-dorës edhe në mendjen dhe në zemrat e njerëzve të thjeshtë nëpërmjet transmetimit gojor. Ato ndihmuan popullin të zbulonte identitetin e vet historik dhe kombëtar dhe pavarësisht nga ndarjet krahinore, fetare etj., ta ndiente veten një bashkësi me të njëjtën histori, me të njëjtën kulturë e zakone, me të njëjtat shoetësime dhe shpresa, me të njëjtat kërkesa. Shqiptarët filloi t'i bashkonte e kaluara e lavdish-

me, por edhe e dhimbshme dhe lufta për të siguruar të njëjtën të ardhme. Idetë e reja luajtën një rol shumë të rëndësishëm në shndërrimin e ndërgjegjes etnike në ndërgjegje kombëtare në të cilën filloi të shkrihej vullneti i kombit. Ishin këto ide që gjatë Rilindjes sidomos me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, duke u rrënjësuar thellë e në mënyrë të qëndrueshme në masat popullore i vunë ato në lëvizje si në vitet e krizave dhe të përleshjeve të armatosura me armiqtë, ashtu edhe në periudhat e zhvillimit relativisht të qetë. Lëvizja e Rilindjes që u shfaq në drejtimet më të ndryshme — në rrafsh teorik, ideologjik, politik, kulturor, ushtarak, organizativ përshpejtoi procesin historik dhe i dha atij ritme zhvillimi që nuk i kishin njohur periudhat e mëparshme.

Ideologjia e Rilindjes u konkretizua në programet politike. Të ndërgjegjshëm për domosdoshmërinë dhe jo më pak për të drejtën për të qenë të lirë e të pavarur dhe për një zhvillim normal të vendit, ideologët e Rilindjes përpunuan në përputhje me kohën dhe rrethanat një strategji politike të qartë mbi rrugët drejt autonomisë e pavarësisë dhe mbi formën dhe përmbajtjen e tyre. Autonomia dhe pavarësia janë konceptuar gjithmonë si dy etapa në zgjidhjen e çështjes shqiptare të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Platforma e autonomisë nën sovranitetin e sulltanit mbizotëroi gjatë Rilindjes deri në nëntorin e 1912-ës. Ajo lejonte të ngriheshin strukturat shoqërore-ekonomike dhe institucionet juridiko-politike që do të shërbenin si bazë për rendin shtetëror të pavarur, i cili do të vendosej me t'u krijuar kushtet e përshtatshme. Kjo shpjgohet jo me dëshirën e shqiptarëve, në shumicë myslimanë, për të qenë nën hijen e sulltanit kalif e as me papjekurinë e tyre për vetëqeverisje siç duan ta paraqesin këtë një varg autorësh të huaj. Kjo ishte rruga që kishin ndjekur edhe disa shtete të tjera ballkanike, përveç Greqisë, dhe natyrisht përvoja e tyre nuk mund të mos merrej parasysh. Por në rastin e shqiptarëve kërkesa e autonomisë shpjgohet kryesisht me konsiderata të karakterit ndërkombëtar. Në radhë të parë, vetë Porta e Lartë do ta pranonte më lehtë, në rast se

do të ishte e detyruar ta bënte këtë, një Shqipëri autonome duke ruajtur sovranitetin e saj në këtë zonë sesa një shkëputje të plotë të saj. Në fakt kështu ndodhi. Ajo e njohu autonominë e Shqipërisë, por pas Shpalljes së Pavarësisë. Faktori i jashtëm kryesor që kushtëzoi platformën e autonomisë ishte rreziku serioz e i vazhdueshëm i copëtimit të tokave shqiptare nga ana e monarkive fqinje, rrezik që kishte filluar të dukej qysh në vitet '40 të shek. XIX. Në këto kushte Shqipëria autonome në kuadrin e Perandorisë Osmane mund të përfitonte përsa i përkiste tërësisë territoriale të atdheut qoftë nga interesi i Portës së Lartë për t'i ruajtur të paprekur kufijtë e Perandorisë qoftë nga garancitë e Fuqive të Mëdha për të ruajtur status-quo-në e saj. Shqipëria autonome do të kishte mundësinë të konsolidohej në atë shkallë sa kur të dilte e pavarur të ishte në gjendje t'u qëndronte rreziqueve të jashtme që i kanoseshin.

Një mbështetje e jashtme, një aleancë luftarake, p.sh., me fqinjin grek në luftën çlirimtare kundër Perandorisë Osmane ishte e mjaftueshme për Komitetin Qendror të Stambollit dhe udhëheqësin e tij Abdyl Frashërin që të projektonte qysh më 1877 krijimin e një Shqipërie të pavarur. Qëndrimi negativ që mbajti ndaj këtij projekti qeveria greke e përforcoi bindjen mbi drejtësinë e kërkesës për autonominë territoriale-administrative të vendit. Megjithëkëtë, kur Lidhja e Prizrenit e shpalli vetë autonominë dhe formoi qeverinë e përkohshme më 1881, Sami Frashëri shpresonte se nuk do të vononin të krijoheshin rrethanat e favorshme që Shqipëria të bëhej, siç shprehej ai, «me shkëputje fare». E parë me këtë sy, pavarësia e 1912-ës, e shpallur në kushtet e Luftës së Parë Ballkanike ishte rrjedhim logjik i vijës rilindëse. Rrjedhimisht mund të thuhet se çështja e pavarësisë së Shqipërisë, nga pikëpamja e forcave të brendshme politiko-shoqërore ishte shtruar për zgjidhje qysh në shek. XIX, të paktën qysh në kohën e Lidhjes së Prizrenit, kurse nga pikëpamja e faktorëve politikë ndërkombëtarë evropianë e ballkanikë ajo u shtrua për zgjidhje dhe u realizua në nëntorin e vitit 1912.

Ideja e autonomisë apo pavarësisë konkretizohej me kërkesën themelore që kishte qëndruar në bazë të të gjitha programeve politike jo vetëm gjatë Rilindjes, por edhe para saj — në atë për krijimin e shtetit shqiptar. Kjo kërkesë pati evolucionin e vet, nga një principatë si ajo e Skënderbeut e paraqitur nga kryengritjet e shek. XVI-XVII, te pashallëqet e mëdha të shekullit XVIII — fillimi i shekullit XIX, nga vilajeti, provinca apo shteti shqiptar me autonomi politike administrative të kërkuar nga Lidhja e Prizrenit, Lidhja e Pejës dhe kryengritjet e viteve 1910-1912 deri te shteti i pavarur i 1912-ës. Ndryshe nga udhëheqjet kombëtare të disa vendeve ballkanike që kërkonin të formonin shtetet e veta në kufijtë e perandorëve përkatëse mesjetare, në kurriz të popujve të tjerë të Gadishullit, Rilindja jonë e konceptoi Shqipërinë autonome ose të pavarur me një shtrirje të tillë territoriale që të përfshinte trojet, banorët e të cilëve ishin ose kreytësisht, ose në shumicën dërrmuese shqiptarë.


Platformën shkencore mbi organizimin, përmbajtjen, e detyrat e shtetit demokratik borgjez shqiptar, e cila përfaqësonte përgjithësimin e përvojës dhjetërvjeçare të lëvizjes kombëtare e dha, siç dihet, eruditi Sami Frashëri më 1899, me veprën «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë».

Drejtimi i dytë themelor që përgatiti pavarësinë ishte veprimi revolucionar i armatosur. Mendimi teorik, politik e kulturor i Rilindjes u shoqërua hap pas hapi me luftën e armatosur antiosmane. Në këtë fushë lëvizja jonë patriotike shënoi faqe të shkëlqyera që i bëjnë asaj nder. Është një meritë e madhe e rilindësve më të përparuar që e konsideruan lëvizjen e armatosur çlirimtare si një mjet të domosdoshëm për të fituar të drejtat kombëtare. Por është një meritë edhe më e madhe e masave popullore shqiptare e në mënyrë të veçantë e fshatarësisë që rrëmbyen armët sa herë paraqitej nevoja dhe nuk ngurruan të mateshin me armiq të fuqishëm, edhe pse kjo luftë kërkonte shumë gjak e sakrifica. Kjo luftë që mbush analet e shek. XIX-XX ishte ana më e fortë e lëvizjes sonë kombëtare. Që nga kryengritjet kundër reformave të Tan-

zimatit e deri më 1912 kemi një zinxhir të tërë lëvizjesh të armatosura antiosmane që pasuan njëra-tjetrën, me përmasa e intesitet të ndryshëm, por me një qëllim të vetëm, të shkundnin zgjedhën e huaj dhe të siguronin lirinë. Ishin në radhë të parë këto ngjarje që përgatitën truallin e çelën shtigjet për shpalljen e pavarësisë. Mund të thuhet me plot gojë se flamuri u ngrit në Vlorë mbi një truall të vaditur me gjak e se pavarësinë e pagoi shumë shtrenjtë populli ynë patriot e liridashës.

Pavarësia shqiptare ishte rezultat edhe i një veprimtarie të dendur organizative të zhvilluar gjatë Rilindjes. Dihet se nuk mund të ketë lëvizje çlirimtare të mirëfilltë me karakter kombëtar pa organizim adekuat, pa krijuar organizmat e nevojshëm politikë dhe ushtarakë për ta çuar atë përpara në të gjitha aspektet e saj deri në fitore. Ishin këto, kuvendet tradicionale me shtrirje krahinore e ndërkrasinore të viteve '30-'70 të shek. XIX, të cilat u ngritën në një shkallë më të lartë dhe patën shtrirje e karakter mbarëshqiptar me Lidhjen e Prizrenit, Lidhjen e Pejës të fundit të shekullit XIX, dhe më vonë, në pragun e Shpalljes së Pavarësisë me klubet, komitetet e fshehta e kuvendet kombëtare. Të gjitha këto forma të udhëheqjes politike krijuan edhe organizmat ushtarakë, për të drejtuar kryengritjet e armatosura.

Pavarësia u përgatit kështu nga Rilindja jonë në të gjitha drejtimet. Ajo e gjeti shumicën e popullsisë shqiptare në të gjitha trojet e saj me një ndërgjegje politike tanimë të formuar, të vetëdijshme për detyrat e të drejtat e saj kombëtare dhe të vendosur për t'i fituar e mbrojtur ato me çdo kusht. Pavarësia e gjeti Shqipërinë me rrethe të gjera drejtuese, të dala kryesisht nga shtresat e borgjezisë së mesme e të vogël dhe nga fshatarësia, me përvojë politike organizative dhe ushtarake të fituar në procesin e një lufte të gjatë me Portën e Lartë, Fuqitë e Mëdha dhe monarkitë ballkanike. Shqipëria i kishte mundësitë të ngrihej, të organizohej e të përparonte si shtet i pavarur.



Një ngjarje e tillë si Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë në një vend ku prej kohësh kryqëzoheshin interesa e aspirata të shteteve të ndryshme të mëdha e të vogla, nuk mund të kufizohet vetëm në raportet e saj të brendshme e në hapësirën shqiptare. Ajo pati implikime politike e diplomatike ballkanike dhe evropiane.

Pavarësia u shpall në kushte ndërkombëtare e të brendshme tepër të ndërlikuara të krijuara nga Lufta e Parë Ballkanike, kur ushtritë e monarkive fqinje duke ndjekur trupat osmane kishin pushtuar një pjesë të mirë të tokave shqiptare, të cilat kërkonin t'i aneksonin, sipas planeve të hartuara prej kohësh. Por në rregullimin e Ballkanit dhe të Shqipërisë ndërhyne Fuqitë e Mëdha, të cilat për këtë qëllim, siç dihet, organizuan Konferencën e Ambasadorëve në Londër.

Është folur e shkruar mjaft si për Luftën e Parë Ballkanike dhe karakterin e pasojat e saj lidhur me Shqipërinë, ashtu edhe për mbledhjen e Londrës e verdiktin e saj. Historiografia jonë ka dhënë gjykimin e vet të argumentuar e gjerësisht të dokumentuar të karakterit të padrejtë të synimeve aneksioniste e të veprimeve antishqiptare të aleatëve ballkanikë si dhe të vendimeve që dhanë Fuqitë e Mëdha në Londër më 1913 për copëtimin e tokave shqiptare dhe kalimin e pothuajse gjysmës së tyre nën zgjedhën e huaj serbo-malazeze e më pak nën atë greke.

Le të na lejohet, meqenëse është rasti, që të ndalemi shkurt në disa çështje.

Krvengritjet e mëdha antiosmane të viteve 1910-1912. që ishin vazhdim i atyre të mëparshme, e kishin tronditur nga themelet sundimin e Portës së Lartë në Shqipëri, kishin angazhuar forca e mjete të konsiderueshme ushtarake osmane, kishin përhapur farën e shturisë në radhët e ushtrisë armike dhe të revoltës në zonat e tiera të Perandorisë. Nga ky këndvështrim, lufta e aleancës ballkanike kundër Turqisë, ishte deri diku.

siç thuhej me të drejtë në memorandumimin e Qeverisë së Vlorës drejtuar Konferencës së Londrës, «... vazhdimi i kryengritjeve të fundit të Shqipërisë» dhe sukseset e tyre — fryt i luftës çlirimtare edhe të popullit shqiptar.²

Aleanca e Serbisë, Bullgarisë, Malit të Zi e Greqisë kundër Turqisë që u formua më 1912, kur Shqipërinë e kishte përfshirë kryengritja e përgjithshme antiosmane kishte pra te shqiptarët partnerin, aleatin e natyrshëm dhe nga ana tjetër, populli shqiptar duhej të gjente te aleanca ballkanike një mbështetje të fuqishme në luftën e tij për çlirim kombëtar. Dhe në fakt, një nga objektivat e parë e më të rëndësishëm që i caktuan vetes udhëheqësit e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare të fillimit të shek. XX ishte vendosja e marrëdhënieve të bashkëpunimit me vendet fqinje në luftën për likuidimin e sundimit osman në Ballkan. Për një bashkëpunim të tillë ishin të interesuar në radhë të parë shqiptarët, si popull i vogël, që ndryshe nga vendet e tjera ballkanike nuk e kishin ende as shtetin e tyre. Është e kuptueshme pra përse udhëheqësit shqiptarë Ismail Qemali, Hasan Prishtina, Isa Boletini etj, bënë përpjekjet para se të fillonte Lufta Ballkanike për të vendosur aleancë luftarake me vendet fqinje. Ismail Qemali, më se një herë në fillim të shekullit e kishte theksuar nevojën e këtij bashkëpunimi. «Shqiptarët, thoshte ai më 1900, duhet të rrojnë në paqe me të gjithë fqinjët e tyre dhe të bashkëpunojnë me ta kur ata kanë synime të mira ndaj Shqipërisë».³ Përçapje në këtë drejtim u bënë me Malin e Zi, Serbinë, Bullgarinë. Duke ecur në gjurmët e Abdyl Frashërit, Ismail Qemali i jepte një rëndësi të veçantë bashkëpunimit me grekët. me të cilët shqiptarët i lidhnin interesa të përbashkëta. Por të gjitha këto përpjekje ndeshën në ledhin e pakapërcyeshëm të shovinizmit të monarkive fqinje. Populli shqiptar u vu kështu përpara alternativës tragjike: ose me Turqinë për të pësuar fatin e saj, ose

2) *Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj* (28 nëntor 1912-22 janar 1914). Tiranë, 1963, f. 99.

3) *Gaz. Albania e Vogël*, nr. 19, 15 tetor 1900.

me aleatët ballkanikë për t'i bërë varrin Shqipërisë. Qëndrimi i drejtë përcaktohej nga vlerësimi i matur, i pjekur i tërësisë së faktorëve që vepronin në këto momente, vlerësim që kërkonte një vizion të qartë të perspektivës për t'u dalë përpara të përgatitur rezultateve të mundshme të luftës. Në këto kushte shumë të vështira e kontradiktore rrethet politike të vendit gjetën zgjidhjen më realiste të mundshme duke ecur në rrugën e Lidhjes së Prizrenit dhe në atë të përcaktuar qartë nga Sami Frashëri në fund të shek. XIX e të diktuar nga gjithë zhvillimi i lëvizjes kombëtare: të rrëmbeheshin armët «jo për të forcuar sundimin e Turqisë në Ballkan», jo si aleatë të Portës së Lartë, por «për t'i dalë zot tërësisë territoriale e lirisë së Shqipërisë». Dhe ashtu u veprua.

Dezertimi në masë i shqiptarëve të rekrutuar në ushtrinë osmane, për të mbrojtur atdheun nga ekspansioni i shteteve fqinje pati pasoja të rënda për këtë ushtri dhe e lehtësoi marshimin fitimtar të aleatëve ballkanikë. Por nga ana tjetër, konflikti i armatosur i reparteve vullnetare shqiptare me ta u bë i pashmangshëm. Ky konflikt, i provokuar nga shovinistët e aleancës ballkanike u solli fatkeqësi popujve të të dy palëve, por sidomos shqiptarëve po të kihet parasysh se pushtimi i tokave të tyre u shoqërua me masakra, deportime e shpërngulje masive të popullsisë.

Kësaj hemoragjie të imponuar të popullit tonë iu shtua disa muaj pasi ishte shpallur pavarësia një fatkeqësi e re edhe më e rëndë — copëtimi i Shqipërisë me vendim të Fuqive të Mëdha. Politika imperialiste e Fuqive që nuk përfillte e shkelte të drejtat e popujve të vegjël nuk ishte diçka specifike për Shqipërinë. Egoizmi i tyre veproi ku më shumë e ku më pak edhe në qëndrimin ndaj popujve të tjerë të Ballkanit. Por në rastin e Shqipërisë, vendimi i tyre për t'i copëtuar tokat e saj i shkaktoi atdheut tonë një katastrofë kombëtare. Në çështjen shqiptare u bashkuan me interesa të përbashkëta e kontradiktore imperializmi evropian dhe shovinizmi ballkanik. Dhe si rezultante e kësaj, ndryshe nga vendet e tjera të Gadishullit që pas formimit të shteteve kombëtare i zgjeruan

territoret e veta, tokat shqiptare erdhën duke u rrudhur nga aneksimet e fqinjëve jo vetëm më 1913, por edhe para e pas kësaj date.

«Shqiptarët lirinë dinin si ta fitonin me armë por mjerisht e humbnin me anën e diplomacisë...»,⁴ shkruante «Liri e Shqipërisë» disa ditë pas Shpalljes së Pavarësisë. Është një konstatim i drejtë, por që nuk shpreh gjithë të vërtetën. «Rruga e popullit tonë, ka thënë shoku Enver Hoxha, s'qe rrugë e lehtë, rrugë e dredhisë dhe e përluljes, e nënshtrimit dhe e frikës para më të fortit, por rruga e përlleshjeve me armiqtë e egër, të jashtëm e të brendshëm, të hapët e të maskuar...».⁵ Kryengritjet antiosmane ishin shtypur njëra pas tjetrës jo vetëm sepse lufta kishte qenë e pabarabartë, por edhe sepse kryengritësve u ishin bërë premtime mashtruese e ndaj tyre ishte përdorur gjithë arsenali i diplomacisë së djallëzuar të Portës së Lartë dhe të shteteve të tjera të interesuara në çështjen shqiptare. Duhej të kalonin vite derisa udhëheqësit e qëndresës antiosmane të shihnin qartë se ç'fshihej prapa fasadës. Lidhja e Prizrenit e para nxori nga gjiri i vet një udhëheqje të aftë që u përpoq të çante, ndonëse pa sukses në labirintet e diplomacisë osmane, ballkanike dhe evropiane. Midis personaliteteve të lëvizjes sonë kombëtare që përgatitën pavarësinë u shqua Ismail Qemali me përvojën e tij në punët shtetërore dhe me lidhjet e shumta që kishte me politikanë e diplomatë të huaj. Ai vendosi kontaktet me kancelaritë e Fuqive dhe nuk la rast pa përdorur për të paraqitur pikëpamjen shqiptare, për të bërë sondazhe, për të bindur partnerët që të përkrahnin çështjen shqiptare duke shfrytëzuar edhe kontradiktat midis tyre. Kjo veprimtari u bë më e dendur në nëntorin e 1912-ës në oragun e Shpalljes së Pavarësisë dhe pas saj, si kryetar i Qeverisë së Përkohshme. Ai luftoi që Shqipëria të ishte jo objekt, por subjekt i së drejtës ndërkombëtare dhe për t'i krijuar asaj kushte sa më të favorshme në

4) Gaz. *Liri e Shqipërisë*, 30 nëntor 1912.

5) Enver Hoxha. *Vepra*, vëll. 24, f. 7.

arenën e jashtme. Por, siç dihet, diplomacia imperia-
liste nuk ishte udhëhequr asnjëherë dhe nuk udhëhiqet
nga drejtësia, por nga interesat e të fuqishëmve. Dhe
Shqipëria e 1913-ës ishte viktimë e këtyre interesave.
Vetë kryetari i Konferencës së Londrës, ministri i Jash-
shtëm anglez E. Grei deklaronte në gusht 1913 se zgjidhja
e dhënë për kufijtë e Shqipërisë «... në shumë pika
do të japë shkas për kritika të mëdha nga kushdo që e
njuh vendin...» dhe e justifikonte këtë duke e paraqitur
si një kurban të domosdoshëm gjoja në altarin e paqes
evropiane. Në të vërtetë gjithçka u bë për të fituar kohë
derisa të përgatiteshin më mirë për konfliktin botëror
që shpërtheu një vit më vonë.⁶

*
* *
*

Me Shpalljen e Pavarësisë filloi një betejë e re, te-
për e vështirë, ajo e organizimit të shtetit shqiptar. Qe-
veria duhej të përballonte në rrugën e saj pengesa kolo-
sale që e kishin burimin në radhë të parë te vazhdimi i
politikës thellësisht armiqësore të fuqive imperialiste dhe
të monarkive fqinje edhe ndaj Shqipërisë së pavarur.
Realizimi i aktit historik të Vlorës brenda kufijve të
Shqipërisë së njohur ndërkombëtarisht kërkonte bashkimin
e atdheut nën autoritetin e qeverisë kombëtare, ngritjen
e administratës shtetërore dhe zbatimin e një politike të
brendshme e të jashtme që të siguronte zhvillimin e
përparimin e vendit.

Me largimin e trupave të huaja nga Shqipëria e Mes-
me dhe Veriore qeveria e shtriu pushtetin e vet në kë-
to zona. Por misioni i saj nuk mundi të çohet deri në
fund, jo vetëm sepse ushtritë greke me pretekste të
ndryshme nuk u larguan nga pjesa jugore e vendit, por
edhe ato serbe mbajtën nën sundimin e tyre një rrip
tokash shqiptare brenda kufijve, të cilin ato e quajtën

6) *Historia e Shqipërisë*, vëll. III, f. 105.

«zonë strategjike» duke e përligjur këtë me nevojën e mbrojtjes prej rrezikut që gjoja u vinte nga shqiptarët. Lufta për tërësinë territoriale të shtetit shqiptar vazhdoi për vite të tëra derisa u zgjidh përfundimisht më 1920, por jo pa cenime të reja të territorit shqiptar.

Qeveria e Vlorës qëndroi në fuqi pak më tepër se një vit, por brenda kësaj kohe ajo me gjithë kufizimet klasore që e karakterizonin u dallua në mënyrë të veçantë për demokratizmin dhe patriotizmin e saj. Ajo lindi si një qeveri çifligaro-borgjeze anëtarët e së cilës kishin qenë veprimtarë të lëvizjes kombëtare. Por kur me fillimin e jetës së pavarur kërkonin zgjidhje një varg problemesh të organizimit të jetës së brendshme shtetërore e shoqërore u dukën e vepruan gjithnjë më hapur në qeveri e jashtë saj krahu demokratik i mbështetur nga rrethe të gjera të patriotëve dhe krahu reaksionar i përkrahur në mënyrë të veçantë nga çifligarët e mëdhenj partikularistë. Kryetari dhe anëtarët përparimtarë të qeverisë patën meritën që e vunë këtë në binarët e demokracisë duke u imponuar si në politikën e brendshme, ashtu edhe në atë të jashtme. Me këtë shpjegohen masat e marra nga qeveria në fushën e administratës, ekonomisë dhe kulturës si edhe veprimet, në fazën e fundit të saj, të drejtuara kundër pronarëve të mëdhenj të tokës dhe në përgjithësi kundër mbeturinave të theksuara të feudalizmit. Veprime të tilla kërkonin jo vetëm bindje, por edhe guxim për të përballuar reaksionin çifligar që nuk do të mungonte të hidhej në sulm siç ndodhi në të vërtetë.

Nga pikëpamja e marrëdhënieve ndërkombëtare, Shqipëria e pavarur pësoi po atë fat që patën njohur pak a shumë shtetet e tjera të Ballkanit, të cilat Fuqitë e Mëdha i vunë nën kontrollin apo «mbrojtjen» e tyre. Kontrolli ose «mbrojtja» të trumbetuara si shprehje e kujdesit për të ndihmuar vendet e vogla e për t'i mbrojtur ato nuk ishin në të vërtetë veçse forma për të ndërhyrë më lehtë në punët e brendshme të tyre dhe për të mbrojtur io ato, por interesat imperialiste.

Shqipërisë së pavarur i vunë mbi kurriz Komisionin

Ndërkombëtar të Kontrollit, i cili nga njëra anë përfaqësonte vullnetin e imperializmit evropian për t'ia nënshtruar vendin grabitjes kolektive të fuqive dhe nga ana tjetër pasqyronte kontradiktat e tyre, të cilat të projektuara në realitetin shqiptar u bënë shkas që të pengohej e të sabotohej veprimtaria e Qeverisë së Vlorës.

Ismail Qemali bëri gjithçka varej prej tij për ta përballuar këtë kontroll të huaj dhe presionet e vazhdueshme të Fuqive, për të mbrojtur sovranitetin e shtetit shqiptar. Me ndjenjën e përgjegjësisë për fatin e atdheut, por edhe si diplomat i shquar manovroi me shkathtësi dhe ndoqi një politikë në të mirë të vendit.

Por me gjithë demokratizmin dhe patriotizmin që karakterizonte Qeverinë e Vlorës, ajo nuk mundi t'u bënte ballë deri në fund ndërhyrjeve të Fuqive me të cilat bënë kauzë të përbashkët çifligarët reaksionarë. Pa mohuar meritat e mëdha patriotike të qeverisë dhe të kryetarit të saj Ismail Qemalit qëndresa ndaj rreziqeve që i kanoseshin vendit nga brenda dhe nga jashtë kërkonte, siç e ka vënë në dukje shoku Enver Hoxha, në radhë të parë vendosjen e lidhjeve të ngushta me masat popullore, mbështetjen e fuqishme dhe konkrete të këto masa për të forcuar pushtetin politik, organizativ, ushtarak dhe pavarësinë⁷, gjë që ata nuk e bënë në shkallën e duhur.

Prëzimi i Qeverisë kombëtare të Vlorës dhe vendosja në fronin e Shqipërisë e princit të huaj gjerman Vidi shënonte thellimin e ndërhyrjes imperialiste në punët e brendshme të Shqipërisë. Fuqitë e Mëdha vepruan edhe në këtë drejtim ashtu si në disa vende të tjera ballkanike, nor eksperimenti shqiptar, siç dihet, dështoi plotësisht. Dhe dështoi jo sepse u vu një princ i krishterë në një vend me shumicën e popullsisë myslimane, megjithëse edhe ky fakt nuk ishte pa rëndësi për Shqipërinë e atëhershme, por kryesisht sepse Vidi ishte i huaj, vegël e Fuqive protektore dhe regjimi i tij — një regjim thellësisht antipopullor. Por tani kundër kontrollit imperialist

7) Enver Hoxha. *Vepra*, vëll. 23, f. 153.

dhe regjimit të Vidit do të ngrihej fshatarësia shqiptare që do të vendoste pushtetin e saj e do të merrte në dorë fatet e vendit. Ajo e mbylli me një akt heroizmi kolektiv periudhën e parë të pavarësisë në luftë kundër invazionit të ri serb.

Pushtimet e reja në prag dhe gjatë Luftës së Parë Botërore i suprimuan, ndonëse përkohësisht, rezultatet e para të jetës së lirë të arritur me aq mund e sakrifica.

* * *

Një nga detyrat themelore që qëndronte para popujve ballkanikë, thoshte V.I. Lenini në kohën e Luftës së Parë Ballkanike, ishte krijimi i shteteve kombëtare të bashkuara. Krijimi i shtetit kombëtar të bashkuar kishte qenë një pikësynim themelor edhe i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare qysh prej fillimit të saj. E konceptuar qysh në vitet '30 të shek. XIX në formën e saj, ende të papërcaktuar qartë, si veçim i krahinave shqiptare për t'u administruar nga njerëzit e vet, ideja e shtrirjes territoriale të shtetit shqiptar u zhvillua e u plotësua me rritjen e lëvizjes e me përsosjen e programit politik. Ajo gjeti formulimin e saj më të plotë me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe pas saj në kërkesën për bashkimin e katër vilajeteve të Shkodrës, Kosovës, Manastirit dhe Janinës me shumicën e popullsisë shqiptare, në një vilajet, provincë apo shtet autonom ose të pavarur kombëtar.

Me Shpalljen e Pavarësisë shteti shqiptar, ashtu siç e konceptonin atë rilindësit dhe Kuvendi i Vlorës ku përfaqësoheshin edhe trevat shqiptare të pushtuara nga ushtritë ballkanike, duhej të përfshinte të gjitha gjymtyrët e kombit për të realizuar kërkesën themelore të bashkimit kombëtar që përputhej me parimin e kombësisë. Por Fuqitë e Mëdha dhe monarkitë ballkanike, siç u pa më lart, nuk e lejuan që të realizohej kjo aspiratë e ligjshme e popullit shqiptar. Ata e njohën shtetin shqiptar vetëm në një territor të përgjysmuar në pjesën pe-

rëndimore të gadishullit. Copëtimi i 1913-ës i shkaktoi popullit shqiptar një traumë shumë të rëndë. Dokumentacioni i kohës dëshmon për atë tronditje të thellë shpirtërore dhe për atë mospajtim masiv të shqiptarëve me këtë padrejtësi të madhe që iu bë vendit të tyre nga imperialistët. Pështjellimin nga kjo padrejtësi e bënte edhe më të dhimbshëm fakti që shqiptarët, pa përmendur të kaluarën e largët, kishin bërë kryengritje të njëpasnjëshme në vitet e fundit kundër zgjedhës osmane dhe kishin vaditur fushat e betejës me gjakun e tyre, kishin pësuar shkatërrime të mëdha nga fuqitë armike dhe kishin dhënë një kontribut me vlerë në dëbimin e Turqisë nga Ballkani. Copëtimi nuk përfilli as historinë, as drejtësinë, as parimin e kombësisë. Me këtë shpjegohet reagimi i fuqishëm jo vetëm i Qeverisë së Vlorës, por edhe i masave të gjera popullore. Dhe ndonëse nuk ishin zgjidhur shumë probleme të Shqipërisë së pavarur, lindën nga poshtë kërkesat për bashkimin e të gjitha trojeve shqiptare në shtetin e pavarur kombëtar. Detyra ishte tepër e vështirë po të kihen parasysh kushtet e brendshme dhe ato ndërkombëtare të vendit.

Lufta për realizimin e saj do t'i vinte shqiptarët përballë armiqsh të shumtë e të fuqishëm siç ishin Fuqitë e Mëdha, që nuk do të lejonin të shkeleshin vendimet e tyre dhe monarkitë fqinje, që nuk do të pranonin t'i lëshonin nga duart trevat pjellore shqiptare me nëntokë të pasur mbi të cilat kishin vendosur pushtetin e vet. Kërkesat për njohjen e të drejtave kombëtare të popullit shqiptar do të ndesheshin edhe me një opinion negativ për shqiptarët të ushqyer nga shtypi i shteteve shoviniste fqinje dhe i Fuqive që qëndronin pas tyre si edhe nga një literaturë pseudoshkencore e financiar pa kursim nga rrethet e interesuara, e cila ishte bërë më virulente dhe më agresive kur u shpall pavarësia. Ata i paraqisnin shqiptarët si fise të egra, pa histori, dhe të ndarë siç ishin në tri fe të ndryshme, pa ndërgjegje kombëtare, si fise që për arsye «humanitare» duhej të përfshiheshin në shtetet fqinje për «të përparuar» e për «t'u qytetëruar».

Delegacioni i Qeverisë së Vlorës në Londër gjatë zhvillimit të punimeve të Konferencës dhe vetë Ismail Qemali, Isa Boletini, Luigj Gurakuqi etj., në verë të 1913-ës bënë çmos që t'i bindnin kancelaritë e Fuqive mbi padrejtësinë që kishin kryer ndaj popullit shqiptar dhe të anulonin vendimet e marra në dëm të tij. Por Fuqitë e Mëdha imperialiste, siç u tha më lart, jo vetëm nuk i morën parasysh kërkesat e drejta shqiptare, por duke u nisur si gjithnjë nga interesat e tyre të ngushta imperialiste lejuan cenimin e mëtejshëm të territorit shqiptar dhe shkeljen brutale të sovranitetit të shtetit të pavarur shqiptar. Në këto rrethana të dëshpëruara, masat popullore të krahinave që ndodheshin nën zgjedhën serbe e malazeze ndoqën rrugën tradicionale të luftës me armë. Ishte një sfidë tepër e guximshme, një sfidë dramatike, e dhimbshme, por edhe heroike, një sfidë e cila edhe pse e kishte perspektivën shumë të errët e të pasigurt u bë qoftë edhe për t'i dëshmuar botës unitetin e kombit shqiptar dhe për të hedhur poshtë gjithë ato trillime që ishin kurdisur kundër tij. Nuk ishte hera e parë që shqiptarët mateshin me armiq të fuqishëm. Gjatë gjithë historisë atyre u është dashur të luftojnë kundër zgjedhës së perandorive. Përvoja më e afërt ishte ajo e Lidhjes së Prizrenit që i detyroi Fuqitë e Mëdha t'i ndryshonin disa herë vendimet e tyre të padrejta kundër Shqipërisë. «Buçitja e armëve, shkruante në atë kohë L. Gurakuqi, arrin më shpejt në veshët e Evropës. Do ta përdorim sa herë do të gjykojmë që veshi i Evropës është i shurdhër, që të na dëgjojë zërin, i cili nuk do të pushojë së kërkuari drejtësi».⁸

Lëvizja e armatosur për çlirim dhe për bashkimin e të gjitha tokave shqiptare në shtetin e pavarur që filloi me kryengritjen e shtatorit 1913 vazhdoi, edhe pasi kjo u shtyp, më 1914 dhe mori përmasa të gjera e forcë të veçantë pas Luftës së Parë Botërore në Kosovë derisa edhe kjo u shtyp më 1925 nga trupat jugosllave.

8) Gaz. *Atdheu*, 15 shtator 1913.

Kjo lëvizje që vazhdoi vite të tëra ishte një dëshmi e faktit se te populli shqiptar bashkësia kombëtare ishte një realitet i pamohueshëm, se ndjenja e njësisë kombëtare ishte rrënjësor thellë në ndërgjegjen popullore.

*
* *
*

Shpallja e Pavarësisë ishte një akt shpëtimtar e larg-pamës me pasoja të rëndësishme për të ardhmen e vendit. 28 Nëntori u ngulit thellë në ndërgjegje dhe në kujtesën e popullit dhe qëndroi aty si një fener i pashuar që ndriçonte rrugën e së ardhmes. Ai u kthye në një pikë-mbështetje të fuqishme morale, në një ide-forcë që mobilizonte, nxiste, inkurajonte shqiptarët në ditët e tyre të errëta, gjatë pushtimeve të huaja që njohu vendi më vonë. Populli shqiptar e bëri 28 Nëntorin festën e vet kombëtare. Dita e Flamurit u bë jo vetëm dita e lirisë, por edhe e bashkimit, ku shprehej vendosmëria për ta mbrojtur pavarësinë ose për ta rifituar atë. Jo rastësisht, oqeveria demokratike popullore e kryesuar nga shoku Enver Hoxha hyri triumfalisht në Tiranën e çliruar më 28 Nëntor 1944. Akti i Vlorës si vepër e vetë shqiptarëve, ashtu si të gjitha ngjarjet e mëdha pasuroi historinë e traditat më të mira të tyre dhe u bë për brezat që erdhën objekt i krenarisë së ligjshme kombëtare.

Shpallja e Pavarësisë pati pasoja të rëndësishme edhe në arenën ndërkombëtare. «... po të mos ishte luftuar me atë furi, ka theksuar shoku Enver Hoxha, dhe po të mos kryhej ai akt në ato kohëra të vështira kur bishat imperialiste po përgatisnin kasaphanën e Luftës së Parë Botërore. do të vështirësohej sigurimi i pavarësisë dhe ndofta tragjedi më të rënda do të kishin pllakosur Atdheun tonë».⁹ Akti i 28 Nëntorit u krye në një moment historik krucial kur aleatët ballkanikë të mbështetur nga disa Fuqi të Mëdha, duke likuiduar sundimin osman në Ball-

9) Enver Hoxha. *Vepra*, vëll. 24, f. 15.

kan kishin vënë në pikëpyetje edhe ekzistencën e Shqipërisë. Me këtë akt, Lëvizja Kombëtare Shqiptare e vuri Evropën dhe Aleancën Ballkanike, siç thoshte Ismail Qemali, «përpara një fakti të kryer», e veçoi përfundimisht Shqipërinë nga Perandoria Osmane dhe shpalli asnjëanësinë në konfliktin ballkanik. Fuqitë e Mëdha edhe pse nuk e njohën Qeverinë e Vlorës si pushtet kombëtar nuk mund t'i injoronin krejtësisht ngjarjet e Shqipërisë. Pavarësia dhe shteti shqiptar ishin të pranishëm në punimet e Konferencës së Londrës, ndonëse jozyrtarisht, jodrejtpërdrejt, si një realitet që u shërbeu Fuqive, sidomos Vjenës dhe Romës, më të interesuarat në çështjen shqiptare, për t'i sanksionuar ato. Më vonë akti i Vlorës dhe njohja e pavarësisë i dhanë popullit shqiptar një argument të fuqishëm për të mbrojtur në arenën ndërkombëtare të drejtat e tij kur këto shkeleshin.

u. u. } Por pavarësia e shpallur në Vlorë më 28 nëntor 1912, me gjithë meritat e saj të mëdha para historisë, nuk ishte as e plotë, as e sigurt. Shteti shqiptar lindi në një zonë ku prirjet imperialiste e shoviniste për ekspansion ishin në rend të ditës. Shqipëria e vogël vazhdoi të mbetej viktima kryesore e këtyre prirjeve edhe në vitet e mëvonshme me pushtimet e huaja gjatë Luftës së Parë Botërore. e pas saj, me kthimin e Shqipërisë në një gjysmë-koloni të Italisë dhe pastaj me pushtimin fashist e nazist të vendit. me rrezikun që iu kanos pavarësisë dhe atentatet kundër saj nga imperialistët anglo-amerikanë dhe armiqtë e tjerë pas çlirimit. Prandaj lufta për sigurimin dhe mbrojtjen e pavarësisë ka qenë, pas 1912-ës një konstante e historisë së re shqiptare.

Ideologët tanë përparimtarë i dhanë idesë së pavarësisë një përmbajtje të caktuar ekonomike-shoqërore dhe e lidhën ngushtë me zhvillimin demokratik të atdheut. E konceptuar në këtë mënyrë, pavarësia merrte një qëndrueshmëri më të madhe, sepse, e mbështetur mbi një rend demokratik. mund t'i përballonte më me sukses rreziqet e brendshme dhe të jashtme.

Konsistenca e pavarësisë kushtëzohet nga klasat që e mbështesin dhe e mbrojnë atë. Shembulli i Shqipërisë

në këtë drejtim është kuptimplotë. Qeveria e Vlorës dhe ato që dolën nga Kongresi i Lushnjës dhe Revolucioni i Qershorit përfaqësonin krahun demokratik të borgjezisë kombëtare dhe shtresat e gjera të fshatarëve, zejtarëve e punëtorëve, të dalluara për patriotizmin e tyre. Ky patriotizëm gjeti shprehjen e vet edhe në politikën e ndjekur nga qeveritë përkatëse, në mbrojtje të interesave më të larta kombëtare, të pavarësisë e sovranitetit të shtetit shqiptar. Nga ana tjetër, qeveritë zogiste të viteve '20-'30, të cilat përfaqësonin shtresat më reaksionare të shoqërisë shqiptare, me politikën e tyre antikombëtare dhe antipopullore, e vunë në rrezik pavarësinë dhe krijuan kushtet për likuidimin e saj.

Pushteti popullor që u ngrit gjatë Luftës Nacional-çlirimtare i udhëhequr nga Partia dhe qeveritë që u formuan gjatë luftës e pas Çlirimit i dhanë një drejtim të ri politik-shoqëror zhvillimit të vendit. Çështjen e lirisë e të pavarësisë e morën në duart e tyre komunistët, klasa punëtore dhe fshatarësia punonjëse. Me çlirimin e vendit, vendosjen e diktaturës së proletariatit dhe ndërtimin socialist pavarësia e Shqipërisë pati një mbështetje të fuqishme si asnjëherë tjetër dhe mori përmbajtje e dimensione të reja. Ajo ishte e plotë, e sigurt, e qëndrueshme, e aftë për t'u bërë ballë me sukses rreziqeve që i kanoseshin, sepse shteti socialist shqiptar që shpreh interesat dhe aspiratat e masave të gjera punonjëse të vendit ka ndjekur e ndjek me vendosmëri e konsekuencë politikën e mbrojtjes dhe të konsolidimit të pavarësisë.

Liria dhe pavarësia e Shqipërisë Socialiste janë fitore historike. Mbrojtja dhe pacenueshmëria e tyre janë detyrë mbi detyrat për çdo shtetas shqiptar. Ato janë kusht i ndërtimit me sukses të socializmit në vendin tonë.

*
* *
*

Shqipëria socialiste ruan si një thesar të vyer kujtimin e atyre ngjarjeve të shënuara dhe të atyre patriotëve që në të gjitha kohët kanë çarë me shpatë në dorë rrugën

e historisë dhe me pishtar — errësirën shekullore, duke çelur shtigje të reja drejt lirisë e përparimit. Historia e sotme nuk mund të kuptohet pa të djeshmen dhe fitoret socialiste, pa djersën e gjakun e derdhur nga brezat e mëparshëm, pa atë trashëgim të pasur moral që farkëtoi virtytet e larta të patriotizmit e të dashurisë së paku-fishme për lirinë e pavarësinë. «E kaluara heroike e popullit tonë, — ka thënë shoku Ramiz Alia, — luftrat e tij për liri e pavarësi janë një burim i madh frymëzimi edhe për të sotmen, për ndërtimin e socializmit dhe për mbrojtjen e Atdheut».¹⁰

Ngjarjet e pavarësisë shqiptare sjellin me vete një përvojë të pasur, një mesazh e një mësim — se pavarësia nuk fitohet pa luftë e se ajo duhet ruajtur si drita e syve.

Duke i pasur ato në qendër të vëmendjes historiografia jonë do të ndihmojë që të zbulohen rrënjët më të thella të së tashmes dhe të lidhet e sotmja me të ardhmen. Një njohje më e mirë e problemeve të pavarësisë nuk është thjesht një pasurim i shkencës historike, por ka edhe një vlerë instruktive, edukuese për ngritjen në një shkallë më të lartë të vetëdijes së re kombëtare socialiste, sepse shqetësimet e djeshme bashkohen me ato të sotmet dhe prandaj ato probleme janë aktuale.

Duke kremtuar 75-vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë ne përulemi me respekt e mirënjohje përpara veprës së lavdishme të të parëve tanë. Historiografia jonë e ndjen se i ka ende borxhe popullit — krijuesit të historisë kombëtare. Historianët tanë do t'i shlyejnë ato me punë të vazhdueshme e këmbëngulëse për të nxjerrë më mirë në dritë vlerat e mëdha të historisë sonë mijëvjeçare.

10) Ramiz Alia. *Lidhja Shqiptare e Prizrenit, faqe e ndritur e historisë sonë të shkruar me gjak*. Tiranë, 1978, f. 31.

SOFOKLI LAZRI

LËVIZJA KOMBËTARE SHQIPTARE DHE REVOLUCIONI POPULLOR

Kur u krijua Partia Komuniste në atë Nëntor të parruar të vitit 1941, përpara popullit shqiptar shtroheshin gati të njëjtat probleme politike që shtroheshin edhe përpara Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në fillim të shekullit. Fitoret e 1912-tës ishin zhdukur. Shqipëria ishte përsëri e pushtuar nga të huajt, e tradhtuar nga parësia e saj dhe e braktisur nga të mëdhenjtë e nga të vegjëlit. Pushtimi italian kishte zhdukur jo vetëm lirinë e pavarësinë politike, por po godiste rëndë edhe zhvillimin ekonomik e kulturor. Me qëllime të dukshme kolonizimi e asimilimi ai ushtronte një presion të madh mbi traditat e mënyrën e jetesës, mbi tërë psikikën kombëtare. Lidhjet e mëparshme ndërkombëtare ishin ndërprerë dhe vendi ishte futur gati në një izolim të plotë.

Pushtimi italian ishte fare i ri, sapo i kishte bërë dy vjetët. Asnjë krahasim nuk mund të bëhej me atë osman që kishte qenë shekullor. Po për nga rrezikshmëria e pasojat ai ia kalonte shumë atij të sulltanëve. Stambolli nga rajatë kërkonte vetëm nizamë e haraçë, ndërsa Roma «hapësira jetike» për të eksportuar milionat e saj të papunë

që prodhonte në masë kapitalizmi. Shqipëria rrezikohej të humbiste tani jo vetëm si shtet, por edhe si komb.

Një e keqe e madhe ishte se pushtimi i ri në një shtresë të caktuar të shoqërisë ringjalli mentalitetet e psikologjitë e vjetra të fatalizmit e të nënshtrimit, të kultivuar nga pushtimi otoman gjatë pesë shekujve të sundimit të tij, por që periudha e shkurtër e pavarësisë kombëtare i kishte goditur e dobësuar mjaft. U aktivizuan përsëri ata për të cilët nuk kishte «as fe e as atdhe», siç thoshin rilindasit, por vetëm çifligje dhe ylefe. Këta ishin ata njerëz për të cilët Shqipëria ishte shumë e vogël për t'u pasuruar dhe donin gjerësitë perandorake për të vënë para e për të bërë karrierë. Këta ishin ata njerëz që më pas u bënë ideologët dhe kuadrot bazë të Ballit Kombëtar, ata që hartuan dhe mbrojtën platformën e tradhtisë kombëtare. Përsëri filluan ta ngrinin zërin ata që parullën e vjetër fataliste se «s'ke ç'i bën dovetit» e kthyen në «s'ke ç'i bën Italisë».

Ndërkaq letrat e Ballkanit ishin përzier. Përsëri filluan të ngriheshin problemet e territoreve, të kufijve, të minoriteteve etj. si në kohën e krizës lindore. Ndërsa në tokë vërshonin lumenjtë e gjakut të popujve, në qiellin e Evropës filluan të duken retë e zeza si ato të Konferencave të Berlinit e të Versajës, të aleancave ballkanike e të mbledhjeve të Ambasadorëve të Londrës.

Ishte e sigurt, sidomos pas hyrjes së Bashkimit Sovjetik në luftë, se fuqitë e «boshtit» do të thyheshin, por për Shqipërinë kjo s'do të thoshte akoma se ajo do të fitonte automatikisht lirinë e pavarësinë e se do të rikthehej në kufijtë e saj. Fqinjët tanë, qeveritë e tyre mbretërore në Londër, të njohura zyrtarisht e të përkrahura nga anglo-amerikanët kishin filluar të bisedonin e të merreshin vesh për ndarjen e Shqipërisë midis tyre pas luftës. Koalicioni anglo-sovjeto-amerikan që përcaktonte fatet e zhvillimit të luftës kundër fuqive të boshtit dhe që do t'i takonte të luante një rol vendimtar në rregullimin e botës pas luftës ishte i mbushur me kontradikta, që rridhnin nga ideologji e strategji politike krejt të ndryshme. Pozitiv

ishte fakti se Bashkimi Sovjetik përfaqësonte atëherë një lloj garancie se ai do të përpqej për të frenuar planet ekspansioniste të Fuqive të Mëdha evropiane dhe do të mbronte me sa të mundej të drejtat e vendeve të vogla. Denoncimi i traktateve grabitqare të Fuqive të Mëdha dhe të diplomacisë së fshehtë nga ana e Leninit e shtonte edhe më shumë besimin në këtë qëndrim.

Por mbetej gjithnjë një faktor shqetësues. Në vendimet që merrnin tri Fuqitë e Mëdha aleate për luftën dhe për të ardhmen e popujve të saj, përveç zërit të tyre, aty asnjë zë tjetër nuk dëgjohej. Prandaj kompromiset e lëshimet që mund të preknin interesat e këtij ose atij vendi nuk përjashtoheshin. Aleatët vetëm në fund të vitit 1942, tre vjet pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia deklaruan se donin ta shihnin pavarësinë e saj të vendosur pas lufte. Ishte ky një akt pozitiv dhe me rëndësi jo të vogël. Por nuk mund të mos mbahej parasysh fakti se kjo njohje u bë jo vetëm me shumë vonesë, por ishte edhe një akt që rridhte nga strategjia e përgjithshme e tyre, që synonte të nxiste e të ngrinte në luftë kundër fashizmit tërë kombet e robëruara të Evropës. Përveç kësaj, në këtë deklaratë, nga ana anglo-amerikane shpallehin disa rezervë lidhur me kufijtë e Shqipërisë, të cilat nuk premonin asgjë të mirë, sepse mund të kërkohej të rishikoheshin pas lufte. Në marrëveshjet aleate që kanë të bëjnë me rregullimin e Evropës pas luftës emri i Shqipërisë rrallë gjendet, sikur mos të kishte qenë një shtet i pavarur e sovran si gjithë të tjerët, sikur ajo të mos luftonte si edhe të tjerët kundër armikut të përbashkët, fashizmit. Edhe kur u themelua Organizata e Kombeve të Bashkuara, ajo nuk u pranua të merrte pjesë si shtet themelues, bile për një kohë të gjatë nuk u pranua as si anëtare. Do të pritej të vinte diskutimi i Traktatit të Paqes me Italinë, që Shqipëria të shënohej midis shteteve fitimtare. Por edhe në këtë konferencë fqinjët e saj u përpoqën të krijonin një çështje shqiptare, ta detyronin konferencën të diskutonte kufijtë e Shqipërisë, që ishte jashtë detyrave e kompetencave të saj.

Në qoftë se ata nuk mundën t'i bënin gjë Shqipërisë ishte se tanimë kishte kaluar koha e konferencave të Ambasadorëve në Londër. Shqipëria tani vinte në këtë Konferencë me luftën e saj të madhe, me një pavarësi e sovranitet të plotë, me një gjendje të brendshme e të jashtme që askush nuk mund ta ndryshonte më.

Këto raporte ndërkombëtare me botën e jashtme e bënin edhe më të turbullt e më të komplikuar gjendjen e brendshme në ditët e formimit të Partisë. Jo vetëm të shiturit, por edhe gjysmëtradhtarët, oportunistët e frikacakët, snobët e kozmopolitët gjenin një ushqim të madh te kjo situatë dhe spekulonin me të, disa për të justifikuar pushtimin fashist, disa për të gjetur padronë të rinj, pas përmbysjes së tij. Përsëri u rishtrua çështja në mënyrë edhe më dramatike se më parë: ç'do të bëhej me Shqipërinë, me popullin, me shtetin e me kombin shqiptar?

Patriotët, trimat e mendjet e kthjellëta nuk i kishin munguar kurrë Shqipërisë, as «në vitet e turbullta e të mbrapshta», ata nuk i mungonin as tani. Dhe ishin pikërisht të tillë burra ata që krijuan Partinë Komuniste në atë kohë kur horizonti politik i brendshëm e i jashtëm i Shqipërisë ishte jashtëzakonisht i errësuar. Ata ishin të gatshëm, siç edhe e provuan, të sakrifikonin çdo gjë, veten e familjen, shtëpinë e katandinë, vetëm që Shqipëria të bëhej e lirë, vetëm që ideali i tyre të triumfonte. Por vetëm sakrifica nuk mjaftonte. Çështja ishte nga duhej filluar lufta, çfarë programi duhej hartuar, cila hallkë duhej kapur për të arritur çlirimin e vendit, lirinë e pavarësinë aq të dëshiruar. Eksperienca e tradita historike ishte një gjë e madhe, por ajo nuk mund as të kopjohej, as të përsëritej në mënyrë mekanike.

Megjithëkëtë te Rilindja, Lëvizja e Re Çlirimtare Shqiptare, e udhëhequr nga Partia Komuniste do të gjenete një burim të madh idesh e përvojash. «Ne komunistët do të mbështeteshim fort në traditat e pasura patriotike dhe luftarake të popullit tonë», — ka shkruar Enver Hoxha në kujtimet e tij të luftës. Ky qëndrim nuk rridhte nga

ndonjë ndjenjë romantike për të kaluarën historike, as nga ndonjë mungesë programi politik të kohës. Kjo rridhte para së gjithash se lëvizja e re në shumë aspekte bile edhe nga më themeloret ishte vazhdim i luftës, sigurisht në kushte të reja e në një shkallë më të lartë, për arritjen e idealeve të paplotësuara të çlirimit e të pavarësisë, të emancipimit kombëtar e kulturor, të sovranitetit të vendit etj.

Nga ana tjetër Lëvizja Kombëtare Shqiptare e shekullit të kaluar dhe e fillimit të këtij shekulli kishte grumbulluar një eksperiencë të madhe luftarake e mbi të gjitha kishte kultivuar një ndjenjë të thellë e të pamposhtshme liridashëse e patriotike. Të mos e merrje parasysh këtë do të thoshte të largoheshe nga realiteti politik i vendit, të shkëputeshe nga populli, nga rrënjët e tij.

Lirinë e pavarësinë shqiptarët e kishin fituar me shumë gjak, me shumë sakrifica. Për shekuj të tërë, kur popujt e tjerë të kontinentit evropian, punonin tokat dhe zhvillonin zejet, atyre u ishte dashur të luftojnë për të mbijetuar. I quajtën të egër, pse donin të rronin të lirë, u thoshin njerëz me bisht, pse nuk pranonin të nënshtroheshin. Për këta njerëz liria e pavarësia nuk ka qenë vetëm dëshirë, nuk ka qenë vetëm aspiratë, shpresë, ëndërr, por edhe boshti rreth të cilit gjatë shekujve është sjellë tërë jeta e tyre, baza mbi të cilën u ngrit mendimi politik i tyre, psikologjia shoqërore e kultura e tyre kombëtare.

Lirinë nuk ua solla unë, e gjeta këtu midis jush, i drejtohet popullit të Krujës dhe të Shqipërisë Skënderbeu sipas përshkrimit të Fan Nolit. Shkrimtari e poeti ynë i madh nuk mund të gjente një mbështetje më të mirë se te Barleti dhe një simbol më përgjithësues se te Gjergj Kastrioti e te historia e tij për të shprehur këtë realitet e këtë filozofi.

Nuk besoj që të ketë aq qartësi politike, një ndjenjë aq të thellë për pavarësinë, një patos aq të zjarrtë patriotik sa ka në këngët popullore të lebërve të Vlorës, kush-tuar Ismail Qemalit e veprës së tij. Në këtë shkallë të lartë të konceptionit poetik e të sintezës politike ata nuk u

ngjitën me një të kërcyer. Kjo nuk mund të arrihej të bëhej për disa muaj sa qëndroi Ismail Qemali në Shqipëri, as mund të ishte rezultat i tronditjeve që u krijuan me luftërat ballkanike, as shpërthim i ndonjë inspiracioni spontan. Kjo shkallë e ngritur e ndërgjegjësimit politik, e vetëdijes kombëtare, e qartësisë së kërkesave të njerëzve të thjeshtë të popullit, ishte rezultat dhe shprehje e një mendimi të gjatë shekullor mbi luftërat e tyre, mbi disfatat e fitoret, por edhe i atij besimi të patundur që krijoi shekulli i ri për çlirimin e përparimin e kombeve.

Ideja e pavarësisë kombëtare si pikënisje e bazë e zhvillimit ekonomik, shoqëror e kulturor të Atdheut që qëndron në bazën e programit politik të rilindasve dhe të veprimtarisë së tyre praktike përfaqëson dhe një nga arritjet e tyre më të shquara. Ajo dëshmon për mprehtësinë e aftësinë e tyre të madhe që aspiratën popullore, ta kthejnë në një filozofi politike e në forcë të madhe lëvizëse të luftës çlirimtare. Gjithashtu ideja e bashkimit që ishte ruajtur e zjarrtë në ndërgjegjen popullore si një trashëgimi politike mjaft e çmuar u përdor nga ata si një nga mjetet themelore për të përballuar fatet historike të kombit. Ky realitet përbënte një bazë të fuqishme ku u mbështet në kohën e vet Partia Komuniste Shqiptare në krijimin e Frontit Nacionalçlirimtar. Ajo e mbante mirë parasysh se populli shqiptar pat luftuar gjithnjë për të qenë i bashkuar, kompakt e pa të çara në radhët e tij. Duke qenë i vogël në numër në raport me armiqtë, i varfër e i këputur në krahasim me ta, në bashkimin e tij ai shikonte edhe të vetmen forcë e të vetmin mjet për të fituar e për të mbijetuar.

Ishte ky imperativ historik që i bënte njerëzit përparimtarë të truallit tonë që mbi bashkimin e popullit të mos vinin asgjë, as fe e as ide, as fis e as soj, as tituj e as grada. Ishte ky frymëzim i madh që i bënte ata të sakrifikonin për çështjen kombëtare pasurinë e katandinë e tyre, karrierën e perspektivën personale.

Ka qenë një sukses i madh i luftës së tyre politike e kulturore qëndrimi i tyre i qartë për të mos identifikuar

fenë me kombin, që ka qenë një koncept dominues, si-
domos në rajonet ballkanike e përgjithësisht lindore. Në
këtë fushë, e përgjithësisht në trajtimin e çështjes nacio-
nale, mund të themi pa frikë se e ekzagjerojmë, ideolo-
gët e Rilindjes sonë Kombëtare kanë qenë nga më të për-
paruarit e kohës së vet. Zgjidhja në mënyrë të drejtë e kë-
saj nyjeje tepër delikate, domethënë e raportit fe-komb,
qe një faktor vendimtar për kapërcimin e ndasive dhe
bashkimin e popullit. Mbi të gjitha ai u hiqte të huajve
shumë mundësi e shumë argumente që ata i shfrytëzonin
aq shpesh për të ndërhyrë në Shqipëri e për të pasur pre-
tendime territoriale ndaj saj.

Duke filluar nga Rilindja, qëndrimi ndaj bashkimit të
popullit, praktikisht u bë vijë demarkacioni që ndante pa-
triotët nga renegatët, parimorët nga oportunistët, militantët
nga indiferentët.

Për ideologët e Lëvizjes së mëparshme Kombëtare
Shqiptare bashkim do të thoshte bashkim rreth një qëlli-
mi dhe objektivi të vetëm politik, siç ishte arritja e lirisë
dhe e pavarësisë kombëtare, do të thoshte forcë ushtara-
ke, bashkim i tërë energjive njerëzore, materiale e intele-
ktuale për realizimin e tyre, do të thoshte më në fund
kusht themelor për mbrojtjen e tyre.

Bashkimin ata e shikonin edhe si faktor të emanci-
pimit të përgjithshëm kombëtar, si mundësi e shprehjes
dhe e evidentimit më të mirë e më të fortë të identitetit
të veçantë e origjinal të popullit shqiptar, si një forcë lë-
vizëse që shtynte përpara drejt progresit e qytetërimit.

Lëvizja për bashkim ishte njëkohësisht edhe një lë-
vizje e fuqishme kulturore për shkrirjen në një të vetme
të kulturave krahinore e të përvetësimeve të jashtme, të
flakjes tej së të huajës së padobishme e të dëmshme, të kthi-
mit të e përbashkëta, të kombëtarja, të gjithëpopullorja.

Vënia e theksit të ky faktor dhe lufta për realizimin
e tij nga ideologët e lëvizjes kombëtare konsiderohej jo
vetëm si një nga kushtet e domosdoshme për njësimin e
kombit, por edhe një nga bazat mbi të cilat do të mbë-
shtetej e do të qëndronte shteti i ardhshëm kombëtar.

Ata e kuptonin plotësisht që të ndarë e të përçarë jo vetëm nga pikëpamja politike, por edhe ajo fetare e kulturore ishte shumë e vështirë të njiheshin nga komuniteti ndërkombëtar e të pranoheshin në gjirin e tij.

Një platformë e tillë që në qendër të saj vinte bashkimin e popullit e që u shndërrua në një mentalitet të përgjithshëm politik, që një nga arsyet që në vitet e mëvonshme Shqipëria nuk u shndërrua ndonjëherë në një terren të përshtatshëm për krijimin e funksionimin e partive politike sipas eksperiencave evropiane.

Por rilindasit, të cilët nuk mund të dilnin jashtë kohës ku jetonin dhe jashtë rrymave ideologjike që ekzistonin, bashkimin e popullit e shikonin në një farë mase e në një mënyrë disi të idealizuar. Ata mendonin se mjaftonte ideali kombëtar dhe ndjenja e përgjithshme patriotike për ta mbajtur të bashkuar popullin, për të çimentuar unitetin e tij.

Në trajtimin e këtij problemi komunistët shqiptarë bënë një hop cilësor përpara. Enver Hoxha si marksist-leninist dhe njohës i madh i historisë që ishte, e kuptonte se konceptet e rilindasve ishin të ngushta. Vetëm ideali kombëtar ishte i pamjaftueshëm për të arritur një unitet të vërtetë kombëtar e popullor, për ta bërë atë të qëndrueshëm e mbi të gjitha për ta shndërruar në një faktor vendimtar të lirisë, pavarësisë, përparimit e qytetërimit të vendit. Ideali kombëtar duhej bashkuar meoemos me idealin shoqëror që ishte socializmi, duhej vendosur pushteti popullor që do të bëhej shprehje e interesave kombëtare e shoqërore të popullit.

Bashkimi i popullit në konceptin politik e ideologjik të Enver Hoxhës duhet të përfaqësonte, jo një moment kalimtar historik, për etapën e luftës për çlirimin kombëtar nga pushtuesit, për shembull, por shndërrimin e tij në një faktor të përhershëm e të qëndrueshëm politik, ideologjik e organizativ, në një faktor që do të bëhej barrikadë për të mos lejuar më askënd, asnjë armik jo vetëm të jashtëm, por edhe të brendshëm që t'i rrëmbente popullit fitoret e tij.

Problemi i rrugëve për arritjen e çlirimit të vendit gjatë gjithë kohërave dhe në të gjitha rajonet e botës ka qenë problem themelor strategjik e taktik i forcave të ndryshme politike. Ai ka qenë çështje bashkimi e ndarjeje, kontradiktash e luftërash të brendshme. Lëvizja çlirimtare shqiptare, përgjithësisht, sidomos në momentet vendimtare, i është drejtuar armëve. Po të mos kishin rrëmbyer armët shqiptarët më 1878, më 1910-1911-1912, më 1920 Shqipëri nuk do të kishte. Ata që kanë qenë për lëshime, për kompromise, tërheqje etj. kanë përfunduar në kampin e armiqve. Kjo ndodhi edhe me Ballin Kombëtar gjatë Luftës së Dytë Botërore. Parullat si ato që «Italia fashiste e Gjermania naziste janë fuqi të mëdha e ne s'kemi ç't'u bëjmë», «pse të vritemi kot kur do të na çlirojnë anglezi e amerikani», «ta mbajmë mirë me gjermanët se do të ikin vetë» etj. nuk përfaqësonin vetëm ideologjinë e përhershme të forcave reaksionare për të justifikuar nënshtrimin ndaj të huajve e gjunjzimitin përpara tyre. Ato shprehin edhe politikën e pajtimit e të kalimit nga një sundues i huaj te një tjetër, platformën e konservimit të privilegjeve dhe të ruajtjes së përfitimeve që nxirrin nga shitja e interesave të larta të atdheut.

Këto përvoja të mëdha historike pozitive e negative Partia Komuniste i mbante mirë parasysh. Që ditën që u krijua ajo e shpalli kryengritjen e armatosur të përgjithshme e popullore si rrugën e vetme të çlirimit. A ishte e ndërgjegjshme për sakrificat që do të nevojiteshin, për vuajtjet që do të shkaktoheshin, për rrënimet që do të bëheshin kur dha kushtimin për këtë kryengritje? Ishte plotësisht. Dhe ishin komunistët të parët ata që dhanë shembullin e këtyre sakrificave, që u burgosën dhe që mbushën kampet e përqendrimit, që iu dogjën shtëpitë e iu persekutuan familjet, që u vranë e u sakatuan. Pjesa dërrmuese e dëshmorëve tanë janë anëtarë të Partisë Komuniste, aktivistët e saj, të rinj komunistë e njerëz të familjeve të tyre. Ishte ideali dhe sakrificat e tyre që u bë detonatori, i cili shpërtheu zjarrin e madh të kryengritjes popullore. Kur ballistët, e në kor të përbashkët

me ta edhe gjithë të frikurit, oportunistët e karrieristët thoshin se edhe pa ne fashizmi do të thyhet, se edhe pa luftën tonë fashistët do të largohen nga vendi, turbullonin shumë mendje. Aq më tepër që politika e të priturit që lirinë Shqipërisë t'ia sillnin të tjerët, propagandohej jo vetëm nga këta, por edhe nga Radio Londra e gazeta «Mundimi» që aeroplanët britanikë na e lëshonin nga qielli në vend që të na hidhnin armë, sugjerohej edhe nga oficerët anglezë që kishin ardhur në Shqipëri për të ndihmuar shqiptarët që të luftonin armikun e përbashkët.

Sigurisht, fashistët italianë e nazistët gjermanë do të thyheshin si në frontin lindor, ashtu edhe në atë perëndimor dhe do të largoheshin me siguri nga vendet e robëruara, ashtu siç u larguan. Por për Shqipërinë kjo nuk ishte gjithçka dhe e mjaftueshme. Largimi i trupave të pushtimit të huaj nga territori shqiptar, megjithëse do të ishte një fitore e madhe, nuk do të thoshte akoma edhe një arritje të lirisë dhe të pavarësisë së plotë.

Në qoftë se populli shqiptar nuk do të çlirohej me forcat e veta, në qoftë se në fund të luftës nuk do të kishte një ushtri të tij të organizuar dhe një pushtet të tij të ngritur, vendin e pushtuesve të vjetër do ta zinin pushtues të tjerë. Çështja ishte që fati i Shqipërisë të vendosej në terrenin e saj dhe jo t'u lihej të vendosnin Fuqitë e Mëdha në konferencat e tyre, le të ishin këto konferenca të paqës apo të sigurimit. Historia e së kaluarës i kishte zhgënjyer disa herë shqiptarët në shpresat e mirëbesimin e tyre në drejtësinë dhe etikën e konferencave ndërkombëtare të pasluftërave.

Kjo ishte pikërisht ajo strategji e re e lëvizjes çlirimtare shqiptare që përcaktoi Partia Komuniste, ajo kthesë historike në përmbajtjen e vetë luftës e të objektivave të saj. Nga eksperiencia e historisë sonë kombëtare. Enver Hoxha nxori mësimin origjinal e gjenial se për të siguruar çlirimin dhe pavarësinë e vendit nevojitej jo vetëm kryengritja e armatosur, por edhe ngritja e pushtetit.

Dhe eksperiencia provoi se po të mos kishte ardhur Lë-

vizja Nacionalçlirimtare pas dëbimit të pushtesve me një pushtet të fortë e të vendosur në gjithë vendin, me një ushtri të organizuar për ta mbrojtur deri në fund këtë pushtet, ndërhyrja e fuqive të huaja, edhe ushtarakisht kishte shumë probabilitet të ndodhte. Ndërhyrja anglo-amerikane që ndodhi në Greqi, fare afër nesh, e dëshmoi plotësisht këtë.

Është një fakt përgjithësisht i provuar se një ndërhyrje me dhunë nga jashtë, ashtu si edhe një presion i madh diplomatik, përveç rasteve të luftërave botërore kur digjen të thatë e të njomë, kërkojnë edhe një situatë të brendshme të turbullt e të paqëndrueshme. Një situatë të këtillë revolucionari ynë popullor me fitoren e tij e bëri të pamundshme.

Për çdo lëvizje revolucionare ose çlirimtare, sidomos për ato të vendeve të vogla shumë preokupuese dhe e komplikuar ka qenë vendosja e një raporti të drejtë midis faktorëve të brendshëm e të jashtëm, raport që lëviz brenda një diapazoni të gjerë simbas situatave dhe koniunkturave ndërkombëtare.

Ndaj Shqipërisë ishin bërë shumë padrejtësi që ajo të mund të mbështetej me besim të plotë te të tjerët për të ardhmen e saj. «Cilido që të jetë qëllimi i fuqive evropiane, thoshte Ismail Qemali, për ne ka ardhur koha të punojmë për vete. Për asgjë në botë Evropa nuk do të bëjë sakrificë për të na ndihmuar». Këtë mendim përsëriste edhe një tjetër intelektual i shquar i Rilindjes, Zef Jubani, kur thoshte se «unë nuk i besoj sinqeritetit të të huajve që të më bëjnë një të mirë, pa pasur një qëllim të dytë.»

Populli shqiptar kishte të drejtë të ishte difident ndaj konferencave ndërkombëtare të pasluftërave evropiane, të cilat sa herë që mblidheshin copëtonin e ndanin territoret e tij të lashta. Shpesh Shqipërisë i është dashur të përballojë frontin e bashkuar të vendeve fqinje të Fuqive të Mëdha që shpërblenin klientët e tyre siç qe për she-mbull rasti i Kongresit të Berlinit më 1878 ose i asaj të Londrës më 1913. Gjithashtu vështirë se mund të ketë

një vend tjetër në Evropë që të ketë njohur një periudhë të tillë të gjatë mosnjohjeje e mospranimi në komunitetin ndërkombëtar si Shqipëria. Njohjen e vetes e të shtetit të saj ajo më shumë ia ka imponuar botës duke e vënë përpara realiteteve të pakthyeshme sesa dëshirës së tyre.

Është e vërtetë se shqiptarët ditën t'i shfrytëzonin kontradiktat e Fuqive të Mëdha rreth Ballkanit e më gjerë, por në qoftë se nuk do të kishin qëndruar më këmbë e me armë në dorë, nuk dihet si do të kishte përfunduar fati i tyre.

Konceptin e harmonisë të Fuqive të Mëdha si domosdoshmëri për ruajtjen e rendit evropian dhe e së drejtës së tyre që rridhte nga ky koncept për t'u diktuar të tjerëve vendimet e tyre shqiptarët nuk e kanë pranuar kurrë. Më 1878 ata preferuan më mirë të luftojnë «me të shtatë krajlët», sesa të pranonin diktatin e tyre.

Ismail Qemali nuk priti vendimin e fuqive për të shpallur pavarësinë. Kuvendi i Vlorës duke e shpallur Shqipërinë shtet më vete u tregoi atyre se fatin e saj ajo e kishte vendosur vetë.

Lëvizja jonë Nacionalçlirimtare e kishte parasysh mirë këtë përvojë dhe ishte e ndërgjegjshme për vështirësitë që do t'i dilnin në fushën e njohjes ndërkombëtare të shtetit dhe të pushtetit të ri që do të lindte revolucioni popullor. Dhe koha provoi se u desh një kohë e gjatë që shumë qeveri evropiane të njihnin realitetin e ri shqiptar, megjithëse flisnin për të drejtën e vetëvendosjes së kombeve, për të drejtat e pamohueshme të popujve për të zgjedhur sistemin shoqëror që dëshironin, për parimin e mosndërrhyrjes në punët e brendshme etj. Por e bindur në parimin marksist të rolit vendimtar të faktorit të brendshëm dhe në përvojën historike të popullit tonë Shqipëria e Re e përballon me shumë sukses kundërshtimin e jashtëm të rrethimit imperialist.

Kurrë historia e Shqipërisë për ne s'ka qenë një çështje e arkivuar. Mjaft nga problemet që kanë qenë të mprehta në marrëdhëniet e Shqipërisë me vendet e tjera në të kaluarën, vazhdojnë të jenë aktuale edhe sot. Disa

tendenca që mund të shpresohet se koha i kishte kapërcyer, përsëri janë të pranishme dhe shfaqen në mënyrë virulente.

Nën pretekstin se ngjall irredentizmin, nacionalizmin, separatizmin, konservatorizmin etj. tërë historinë tonë kombëtare, tërë kulturën tonë, tërë traditat e zakonet shqiptare serbomëdhenjtë kërkojnë t'i shpallin të jashtëligjshme në Kosovë.

Sigurisht, këtë e dinë edhe autorët e fushatës anti-shqiptare në Jugosllavi. Por mohimi i traditave historike e kulturore të shqiptarëve nuk është as lajthitje as vetëm luftë psikologjike. Ajo është shprehje e një politike të caktuar kolonialiste që shqiptarët e «paqytetëruar» duhet t'i qytetërojë ndokush, që trojet ku banojnë sot shqiptarët historikisht kanë qenë të bardha dhe mund të mbushen nga ndokush.

Një kishë bizantine në Pejë ose një legjendë për Knjaz Llazarin që u vra nga turqit në betejën e Fushë Kosovës e ndonjë mit tjetër i këtij lloji është gjithçka që serbomëdhenjtë i kundërvënë historisë mijërvjeçare të shqiptarëve që jetojnë e krijojnë në trojet e tyre të lasha. Por, në qoftë se Kosova për serbët është një vend mitesh mesjetare, të krijuara më shumë nga letërsia e tyre romantiko-nacionaliste e shekullit XIX, për shqiptarët ajo është qendra e lëvizjes së tyre kombëtare, e kryengritjeve të mëdha antiosmane që çuan në çlirimin e vendit dhe në formimin e shtetit të parë të pavarur shqiptar. Realitetet historike e konkrete nuk ndryshohen me mite, por ato nuk ndryshohen as me dhunë.

Lufta që klani shovinist serb i ka shpallur tani autonomisë së Kosovës, dhuna ndaj kulturës e traditave historike të shqiptarëve, nuk shënon një tragjedi vetëm për Kosovën, por edhe një fatkeqësi historike për tërë Jugosllavinë. Ajo shënon një goditje të rëndë ndaj revolucionit nacionalçlirimtar të popujve të Jugosllavisë dhe futjen e saj në periudhën e konflikteve nacionale e shoqërore që aq shtrenjtë ata i kanë paguar.

Jugosllavia e parë që u krijua pas Luftës së Parë

Botërore, për shkak të sundimit shtypës të monarkisë dhe të politikës shoviniste të borgjezisë serbe u shndërrua në një vend të mbushur me kontradikta të rënda shoqërore e nacionale dhe përfundoi në një burg popujsh. Komunistët jugosllavë deshën ta shndërronin atë në një bashkim popujsh, të lirë e të barabartë. Politikës së urrejtjes nacionale të sundimtarëve serbë ata i kundërvënë idealin socialist, barazinë e kombeve, eliminimin e çdo lloj shtypjeje e diskriminimi social e nacional.

Popujt e Jugosllavisë shkuan pas komunistëve e jo Mihajloviçit, luftuan për vëllazërimin e kombeve dhe jo për shovinizmin që përfaqësonte ideologjinë sunduese të monarkisë serbe, luftuan për paqe e miqësi me fqinjët dhe kundër ekspansionit serbomadh të sundimtarëve të deriatëhershëm të Beogradit. Por komunistët jugosllavë nuk ecën në rrugën që premtuan. Ata nuk e zbatuan programin e premtuar për zgjidhjen e çështjes nacionale. Gjendja e sotme është rezultat i gabimeve të shumta politike e ideologjike dhe i paaftësisë së tyre për t'i bërë ballë shovinizmit serbomadh.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore vetë populli serb e pagoi shumë shtrenjtë indokrinimin e tij shovinist. Por me sa duket në Serbi vuajnë akoma nga ai «egoizëm provincial», i cili siç thoshte Marksi, detyron çdo popull të gënjëjë veten me iluzionin se gjoja mund të fitojë lirinë duke sakrifikuar pavarësinë e një populli tjetër.

Urrejtja kombëtare si ideologji e si praktikë politike mund të jetë e egër dhe e papërmbajtur, mund që për një periudhë të influencojë një pjesë të madhe të popullsisë, të përfitojë nga ndonjë koniunkturë ndërkombëtare e caktuar, por ajo është pa të ardhme. E ardhmja i përket lirisë e barazisë kombëtare, çlirimit të popujve nga çdo dhunë, qoftë nacionale ose shoqërore.

Lëvizja Kombëtare Shqiptare kujtesën historike e ngriti shumë lart dhe e konsideronte si një faktor me rëndësi që të shtyn drejt së ardhmes, drejt përparimit e qytetërimit. Edhe lëvizja nacionalçlirimtare i kushtoi asaj një vëmendje të madhe. Historinë e Shqipërisë Par-

tia e nxori në dritë. Ajo ka punuar dhe punon me një interesim e kujdes të posaçëm për zbulimin e vlerave të së kaluarës së lavdishme të popullit tonë. Ajo niset nga premisa se studimi dhe njohja e kësaj historie përbën jo vetëm një bazë të çmueshme të edukimit patriotik, por në të njëjtën kohë është edhe një ndihmë për të ecur drejt së ardhmes në rrugën e sprovuar të lirisë e të pavarësisë së plotë, të sovranitetit kombëtar të pakufizuar, të mbrojtjes deri në fund të fitoreve kombëtare e shoqërore.

Pavarësia është një fitore e çmuar për çdo popull e për çdo komb. Për ata që e kanë fituar me aq mundim, me aq vuajtje e sakrificë, si populli shqiptar, ajo përfaqëson edhe kushtin e bazën themelore të vetë ekzistencës e përparimit të tij. Por pavarësia e çdo vendi ka një rëndësi jo më të vogël edhe ndërkombëtare. Ashtu si vetëm individët e lirë mund të jenë krijues dhe mbrojtës të një shoqërie të lirë, po ashtu vetëm kombet e lira e të pavarura mund të krijojnë një komunitet demokratik ndërkombëtar, vetëm të lira e të pavarura ato mund të kontribuojnë në mbrojtjen dhe përparimin e njerëzimit.

ALFRED UÇI

KULTURA KOMBËTARE NË RRJEDHAT E LUFTËS PËR LIRI E PAVARËSI

Në fillim të shek. XX Shqipëria shkonte e sigurt dhe e përgatitur për të marrë në duart e veta fatet dhe të ardhmen e saj. Shpallja e pavarësisë ishte bërë një domosdoshmëri e ngutshme historike. Se sa i përgatitur vinte populli shqiptar në ditën e 28 Nëntorit e provojnë, veç të tjerash, edhe zhvillimi i tij kulturor e forca e kulturës së tij kombëtare që qëndrojnë në rrënjët e pavarësisë. Prandaj pa zbuluar përmbajtjen dhe rolin e kësaj kulture nuk mund të kuptohen as themelet mbi të cilat u ngrit pavarësia e Shqipërisë.

*
* *

Epoka e Rilindjes Kombëtare, që i parapriu Shpalljes së Pavarësisë ishte epokë e zgjimit kulturor të shqiptarëve. Shtratin e përgjithshëm ideologjik të këtij zgjimi e përbënte ai koncept i përparuar për kulturën, që përpunuan rilindasit. Për ta kultura ishte, para së gjithash,

një vizion i ri për botën, një mënyre e re e konceptimit të jetës, të historisë dhe të perspektivave të saj. Ajo ishte një lëvizje e fuqishme intelektuale që rivlerësoi gjithë vlerat, që e pasuroi botën shpirtërore të shqiptarëve me frymën e saj kritike, që rrëzoi idhuj dhe mite të vjetër dhe formuloi kërkesa për vlera të reja kulturore. Kultura e Rilindjes Kombëtare ishte një ideal i ri shoqëror, politik, moral, që bartte me vete projektin e madh të krijimit të një realiteti të ri, *projektin e Shqipërisë së pavarur e të lirë*.

Ideologët e Rilindjes Kombëtare e kuptonin rëndësinë e dijeve për kulturën. Ata ishin partizanë të flaktë të iluminizmit dhe besonin në forcën e dijeve. Thelbin e këtij koncepti iluminist për kulturën e shprehu N. Frashëri me moton e tij të fashme: «*Dhe drit' e diturisë, përpara do na shpjerë*». Por kultura për ideologët e Rilindjes Kombëtare nuk ishte vetëm një depozitë dijesh, ajo ishte në radhë të parë aftësi për qendrim aktive krijuese në histori, në jetë. Akti dhe veprimi më i rëndësishëm i popullit tonë si forcë kulturore, për rilindasit, ishte vetë lufta e tij për liri e pavarësi, qëndresa e tij e pamposhtur, kundërshtimi i shtypjes dhe i robërisë.

Shpirti i gjallë i kulturës së re ishte *ideja e shqiptarizmit*, që përfaqësonte aktin më kryesor të emancipimit të kulturës shqiptare. Ideja e shqiptarizmit ishte vatra nga shpërndaheshin gjithë erërat e reja ideologjike të kulturës së Rilindjes Kombëtare. Lufta për kulturë u bë, para së gjithash, luftë për kulturë kombëtare, për një sistem dijesh, vlerash dhe veprimesh që çimentonin unitetin e jetës materiale e shpirtërore të kombit shqiptar. Ajo i ruanin atij vetëqënien e origjinalitetin. Kultura është gjithmonë shprehje e vetëdijes së njeriut e të popujve. Pa kulturën kombëtare të Rilindjes, shqiptarët e shek. XIX nuk do të kishin mundësi ta dallonin veten, si komb të formuar, nga gjithë të tjerët, të kuptonin gjendjen dhe rreziqet që u kanoseshin, të kuptonin ku të mbështeteshin e përse të luftonin.

Kultura e Rilindjes Kombëtare ishte një zbulim i madh. Ajo zbuloi botën shqiptare me gjithë madhësitë

dhe tragjizmin e historisë së saj, ajo zbuloi një të kaluar sa të lavdishme e heroike aq edhe të dhimbshme e të përvuajtur, ajo zbuloi ekzistencën në mjerim dhe prapambetje të popullit, por edhe aftësitë e një populli që qëndronte i pamposhtur, i papërkulur përballë rrebesheve dhe fortunave më të rënda të historisë; ajo zbuloi jetën, traditat, zakonet, psikologjinë e një populli liridashës, luftëtar e punëtor, trim e guximtar që ruante shpresën dhe besimin në një të ardhme të ndritur. Kultura kombëtare e Rilindjes zbuloi shqiptarin dhe u dha një emër të përbashkët, emrin e Shqipërisë, trojeve ku nga kohët parahistorike kishin jetuar brez pas brezi gjyshërit e stërgjyshërit. Kjo kulturë ishte faktor zgjimi i vetëdijes kombëtare, i përgjegjesisë sociale për fatet e kombit, ajo i dha një kuptim krejt të ri jetës së shqiptarit, i kultivoi krenarinë kombëtare, i dhuroi dinjitetin e përkatësisë kombëtare, së cilës Naimi i këndoi: «*Ti Shqipëri më ep nderë, më ep emrin shqipëtar!*». Kultura Kombëtare e Rilindjes solli sihariqin e madh të daljes në arenën e historisë botërore të një kombi të ri, të kombit shqiptar dhe shprehu para botës aspiratat dhe idealet e tij për liri dhe pavarësi.

Nën regjimin otoman kultura jonë kombëtare ndeshëj në çdo hap me pasojat e robërisë dhe me atmosferën mbytëse të obskurantizmit mesjetar. Duke i zgjuar ndjenjat kombëtare shqiptarit, kultura e Rilindjes e bënte atë t'i rëndohej edhe më shtypja, t'i bëhej më e padurueshme robëria, të ndiente thellë zymtësinë e palirisë. Kultura e Rilindjes zgjoi interesimin e shqiptarëve për historinë e kulturës, për traditat e tyre kulturore. Ajo sillte emancipimin e popullit nga fanatizmi, intoleranca e ndasitë fetare, duke fituar karakter laik mbifetar. Ideja e shqiptarizmit u bë ai bosht kulturor rreth të cilit mund të bashkoheshin shqiptarët pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare. Konceptit të kulturave fetare iu kundërvu koncepti i qytetërimit.

Një akt tjetër i madh emancipimi i kulturës së Rilindjes sonë Kombëtare ishte shkëputja që ajo sillte nga ndikimet e atyre «antikulturave» që synonin për role

dhe hegjemoni zonale apo botërore dhe që përbënin një kërcënim të madh për kulturën dhe për vetë ekzistencën e kombit tonë. Kultura e Rilindjes Kombëtare guxoi të ngrihej kundër «shkëlqimit» të rremë të këtyre kulturave, duke iu bërë një sfidë të madhe. Kjo ishte një luftë e vështirë, sepse ndikimet e këtyre kulturave ishin ende të fuqishme në shtresa të caktuara të prapambetura të popullsisë, madje ajo ishte e vështirë sepse bëhej edhe brenda vetes së secilit shqiptar, që nuk ishte i çliruar ende prej këtyre ndikimeve. Kultura e re e Rilindjes kishte vitalitet t'u kundërqëndronte forcave kulturore reaksionare, sepse i kishte rrënjët thellë në tabanin kombëtar, në popull. Me karakterin e saj kombëtar kultura jonë e Rilindjes i mbyllte portat për korrentet ideologjike shkombëtarizuese dhe në të njëjtën kohë ajo shënoi një hapje, më të madhen hapje që kishte parë kultura jonë deri atëherë, ndaj erërave të kulturës përparimtare botërore që mund ta pasuronin. Koha e Rilindjes u bë kohë kur kombi ynë vendosi e hyri në lidhje intensive me kulturën përparimtare botërore, kur përfitoi më shumë se çdo herë tjetër nga thesaret e saj, nga ajo e Perëndimit, por edhe e Lindjes, nga antikiteti dhe nga ajo e Rilindjes evropiane, nga klasicizmi, iluminizmi e romantizmi.

Përmes përpjekjesh e një lufte të vështirë e të gjatë, plot sakrifica, nga fundi i shek. XIX kultura e re kombëtare s'ishte më aspiratë, por përbënte një realitet, i cili kishte provuar katërcipërisht identitetin e përveçëm kulturor të popullit shqiptar, por edhe vitalitetin, forcën krijuese kulturore të tij. Në këtë kohë përfundonin veprën e tyre kulturore prijësit e Rilindjes Kombëtare dhe largoheshin nga skena historike njeri pas tjetrit — Abdyli, Naimi, Samiu, Pashko Vasa, Vretoja, De Rada etj., por ata largoheshin kur fara që patën mbjellë kishte lëshuar rrënjë të thella, madje kur ishte afruar koha e të korrurave. Një brez i ri mendimtarësh e veprimtarësh shoqërorë merrnin në duar veprën kulturore të rilindasve dhe e shpinin më tej — Luigj Gurakuqi, Shahin Kolonja, Petro Nini Luarasi, Andon Zako Çajupi, Ndre Mjeda, Sotir Peci,

Mihal Gramenoja etj. e midis tyre shquhej Ismail Qemali, simbol i lidhjes dhe i vazhdimësisë në lëvizjen çlirimtare.

Tiparet themelore, që karakterizonin kulturën shqiptare të epokës së Rilindjes Kombëtare, qëndruan në themel edhe të lëvizjes për kulturë kombëtare në fillim të shekullit XX. Megjithëkëtë, në kapërcyellin e shekujve XIX-XX kishin ndodhur ndryshime historike që e kishin futur lëvizjen kombëtare për kulturë në një fazë të re, më të lartë, në kuadrin e së cilës spikatën edhe tipare dhe vlera të reja, të cilat e rritën forcën vepruese të kësaj kulture dhe kontributin e saj në luftën për pavarësi kombëtare.

Në këtë kohë lëvizja për kulturë u fuqizua. Vatra e saj u zhvendos nga kolonitë shqiptare të mërgimit, brenda vendit. Spikati edhe karakteri mbarëkombëtar i lëvizjes kulturore, e cila tashmë nuk ishte bërë çështje e një rrethi të ngushtë intelektualësh, por ishte çështje e masave të gjera të popullit. Kur qeveria xhonturke vendosi që të përdorej në shkollat shqipe alfabeti arab, vetëm në një qytet, në Korçë, merrnin pjesë në një miting proteste 15 000 veta!

Lëvizja për kulturë kombëtare u mpleks përherë e më tepër me luftën politike të popullit për liri e pavarësi. *Gërshetimi i shumanshëm i veprimtarisë kulturore arsimore me veprimtarinë politike* përbën një nga veçoritë më qenësore të kësaj faze të lëvizjes për çlirimin kombëtar, së cilës i përshtaten plotësisht fjalët e shokut Enver Hoxha se «pushka dhe abetarja kanë qenë kurdoherë dy binjake në duart e popullit shqiptar, në të njëjtat llogore të luftës së tij për liri, pavarësi, tokë, të drejta e përparim»¹.

Nga gjithë pjesët përbërëse të kulturës kombëtare në këtë fazë mori përparësi dhe zhvillim më të madh *kultura politike*, e cila u bë bërthama kryesore që u dha tonin e frymën e saj gjithë komponenteve të tjera të saj. Kjo vecori ishte pasojë e përparësisë që morën problemet politike, ushtarake e diplomatike. Nuk duhet menduar

1) Enver Hoxha, *Raporte e fjalime 1972-1973*, f. 429.

se idetë iluministe të rilindasve në këtë fazë u shuan, por aspekti iluminist i kulturës u ngushtua dhe u përforcua aspekti i saj politik. Ky politizim i kulturës u shpreh në pasurimin e vlerave të kulturës politike me vepra të tilla siç qenë libri i S. Frashërit «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të jetë», një testament i vërtetë politik i rilindasve dhe një platformë që frymëzoi gjithë luftën politike kulturore për liri e pavarësi të shqiptarëve në fillim të shek. XX. Të kësaj kohe e rëndësie kanë qenë platformat politiko-kulturore të shqiptarëve në revolucionin xhonturk, vendimet e Kongreseve të Manastirit dhe programet memorandume të kryengritësve shqiptarë². Këto dokumente provojnë qartë se kërkesat kulturore kombëtare u nënshtroheshin tashmë programeve politike të autonomisë dhe pavarësisë së Shqipërisë.

Politizimi i kulturës u shpreh edhe në lidhjen e ngushtë të veprimtarisë së vatrave kulturore me aktivitetet politike. Shoqatat e Stambollit, e Rumanisë, e Egjiptit në shek. XIX kishin më tepër karakter kulturor, kurse shoqatat kulturore, klubet që u krijuan në vitet e para të shek. XX në Shqipëri kryenin një veprimtari jo vetëm kulturore, por edhe drejtpërdrejt politike. Mjaf-ton të kujtojmë klubet, që u krijuan gjatë revolucionit xhonturk, të cilat ishin sa organizma kulturorë aq edhe politikë. Ato vepronin në lidhje të ngushta me komitetet e fshehta të kryengritësve dhe funksiononin si forma të një partie ose të një organizmi politik. Klubet dhe shoqëritë kulturore, krahas përpjekjeve për përhapjen e shkrimit dhe të shkollave shqipe, zhvillonin edhe një aktivitet të shumanshëm politik për organizimin e lëvizjes çlirimtare dhe bashkimin politik të popullit, për krijimin e një qendre drejtuese politike e kulturore të kësaj lëvizjeje në

2) Memorandumi i kryengritjes shqiptare drejtuar Shefqet Turgut Pashës në Prizren (maj 1910), Memorandumi i Gërçes i kryengritësve të Malësisë së Mbishkodrës (qershor 1911), kërkesat e përfaqësuesve të Shqipërisë së Jugut mbledhur në Kazanë e Vlorës (ura e Shushicës, korrik 1911), programi i Kuvendit të Junikut (qershor 1912), Memorandumi i Sinjës (1912).

shkallë kombëtare. Këto synime u konkretizuan në veprimtarinë e klubit «Bashkimi» të Manastirit, në Kongreset e Manastirit (1908, 1910), të Elbasanit (1909), të shoqërisë qendrore shkollore «Përparimi» (1909) në Korçë etj. Pavarësisht nga masat represive që ndërmori qeveria gjatë kryengritjeve shqiptare të viteve 1910-1912, vrulli i lëvizjes kulturore e arsimore erdhi duke u rritur e pleksur me luftën e armatosur për liri. I bën nder inteligjencies shqiptare, që përfaqësuesit e shquar të kulturës së kësaj kohe — mësues, gazetarë, shkrimtarë etj., — u gjendën në radhët e çetave dhe të formacioneve kryengritëse si Çerçiz Topulli e Dervish Hima, Petro Nini Luarasi e Mihal Grameno, Themistokli Gërmenji dhe Hil Mosi, Risto Siliqi e Luigj Gurakuqi etj.

Në rritjen e ngarkesës politike të kulturës në fillim të shek. XX, një rol të veçantë luajti shtypi, sidomos, publicistika, jo vetëm me numrin e madh të botimeve brenda e jashtë vendit, por edhe me përmbajtjen e tyre kryesisht politike³. Po të krahasojmë organin «Drita — Dituria» të Stambollit (ku mbizotëronin materiale didaktike kulturore) me disa gazeta si «Drita» (1903-1910) të Shahin Kolonjës, «Kombi» e «Dielli» (ShBA) ose «Liria» (Manastir) etj. do të vinim re se në këto të fundit mbizotëroi publicistika politike.

Politizimi përfshiu edhe letërsinë artistike. Mendimi vnë shkencor nuk ka dhënë një përcaktim të plotë e të drejtë të vlerave të letërsisë sonë të kësaj periudhe. Ajo meriton të rivlerësohet për të njohur vlerat e qëndrueshme të saj. Politizimi më i thellë i poezisë së kësaj kohe

3) Në vitet 1908-1912 në Shqipëri dhe jashtë botoheshin me ndërprerje rreth 50 organe shtypi: «Bashkimi i Kombit» (1908-1910) dhe «Drita» (1911-1912) në Manastir, «Korça» (1908-1910) dhe «Lidhja ortodokse» (1909-1910) në Korçë, «Zgjimi i Shqipërisë» (1908-1910) në Janinë, «Tomorri» në Elbasan, «Shkupi» në Shkup. — Jashtë Shqipërisë botoheshin organe të tilla si «Shqiptarët» (1909-1911) në Stamboll, «Liria» në Selanik, «Liria e Shqipërisë» (1911-1915) në Sofje, «Shkupi» në Kajro, «Shqypja e Shqypnisë» (1909-1915) në Sofje, «Dielli» (1909-1910) dhe «Flamuri» në ShBA, etj.

nuk ishte kufizim i saj, por përbënte një angazhim më të madh e më të drejtpërdrejtë social të saj në betejat e luftërave politike të kohës. Këtë frymë kryengritëse bartnin vjershat e Çajupit, Mjedës, Asdrenit. Le të kujtojmë marshin e Asdrenit: «Jo, s'duam tjetër, nukë,/ veç armë e ca bukë» ose këngën e pavdekshme «Për mëmëdhenë», të M. Gramenos, që bartën mesazhe të fuqishme të frymës liridashëse të popullit shqiptar.

Forcimi i karakterit politik të kulturës kombëtare në fillim të shek. XX luajti një rol shumë të madh për fatet e të ardhmen e lëvizjes së çlirimit kombëtar. Me tendenciozitetin e saj të veçantë politik kultura kombëtare ndihmoi për një kuptim të ri të problemeve të jetës politike të kombit, për një qëndrim të ri të masave të gjera ndaj politikës, sidomos, ndikoi në formulimin e një *politike shqiptare*, si veprimtari që shprehte dhe mbronte interesat kombëtare, që afirmonte ekzistencën dhe të drejtat e kombit shqiptar, që sillte emancipimin politik e kulturor të popullit. Me frymën e saj politike militante kjo kulturë zgjeroi aktivizimin e shqiptarëve në jetën politike, forcoi ndërgjegjen patriotike, i aftësoi si forcë vetëqeverisëse. Ajo i bindi shqiptarët se ata s'kishin nga e prisnin shpëtimin e tyre veç nga vetvetja. Duke njohur interesin kombëtar dhe duke vendosur në themel të saj politikën shqiptare, kjo kulturë e përgatiti popullin për ditën e lumtur të 28 nëntorit 1912.



Shpallja e Pavarësisë ishte realizim i aspiratave dhe i ëndrrave shekullore të popullit, ishte kurorëzim i luftërave dhe i përpjekjeve të pandërprera të shqiptarëve për çlirim kombëtar e shoqëror. Atë shoku Ramiz Alia e ka quajtur akt madhor, që çeli një etapë të re në historinë e popullit tonë¹. Në themelet e pavarësisë janë vendosur

4) Ramiz Alia — *Fjalime e biseda*, Tiranë, 1986, f. 492.

edhe ato vlera, që krijoi kultura përparimtare e Rilindjes Kombëtare dhe ai kontribut i shquar, që ajo solli në çështjen e çlirimit kombëtar. Por Shpallja e Pavarësisë krijoi një situatë të re shoqërore e historike për fatet e të ardhmen e kulturës kombëtare.

Po të lëmë mënjanë hollësitë kronologjike të ngjarjeve, po të përpiqemi të përftojmë një përfytyrim tërësor e sintetik të zhvillimit kulturor *gjatë pavarësisë*, atëherë do të na duhej të pranonim se *kultura dhe zhvillimi kulturor u gjendën në një situatë tepër paradoksale*. Pavarësia kombëtare nuk është vetëm një pikësynim i luftës për kulturë kombëtare, ajo përbën në *parim* edhe kushtet më të përshtatshme për lulëzimin e saj. Zgjedha e huaj dhe e gjatë osmane kishte qenë faktori kryesor, që kishte penguar zhvillimin e lirë kulturor të popullit shqiptar, që kishte ndrydhur forcat e tij krijuese kulturore, që kishte mbështetur proceset asimiluese shkombëtarizuese, që gjymtonin origjinalitetin e kulturës kombëtare dhe që e mbanin atë në gjendje ilegaliteti. Shkëlqimi i vlerave të kulturës së Rilindjes Kombëtare nuk e mohon aspak karakterin e disfavorshëm të rrethanave në të cilat ndodhej kultura, kur mungonte pavarësia; ajo provon vetëm stërmundimet e sakrificat e panumërta që u deshën për krijimin e saj si dhe aftësitë dhe potencialin e madh krijues kulturor të popullit shqiptar. Prandaj pavarësinë shqiptarët e vlerësuan si të vetmen mundësi për të hequr nga rruga e përparimit shoqëror e kulturor gjithë pengesat që krijonte pushtimi i huaj. Ata kishin shumë shpresa se në kushtet e pavarësisë vendi do të përparonte e begatohej dhe kultura e tij do të lulëzonte. Por nuk ndodhi kështu. Në histori nuk realizohen automatikisht mundësitë reale për progres dhe njerëzit nuk arrijnë t'i përdorin ato sipas dëshirave të tyre.

Gjatë periudhës së pavarësisë populli ynë nuk mundi të dalë nga prapambetja kulturore; shumë nga ëndrrat që kishin pasur patriotët për zhvillimin kulturor të vendit mbetën të porealizuara. Mjaft intelektualë e patriotë, të mëkruar me idealet e Rilindjes, pësuan një zhgënjim të madh, duke u ndodhur në një realitet social që s'bënte

asgjë për t'i zgjuar e aktualizuar energjitë krijuese e talentet e popullit. Prandaj nuk mund të mos lindin pyetjet: Përse u ndodhën kultura dhe zhvillimi kulturor i vendit tonë në këtë situatë paradoksale? Përse në kushtet e pavarësisë nuk u kapërcye prapambetja kulturore?

Sigurisht, këtu kanë ndikuar shumë rrethana e faktorë historikë negativë. Midis tyre nuk mund të mos përmendim ata faktorë që e rrezikuan pavarësinë menjëherë pas shpalljes së saj ose që e nëpërkëmbën atë kur ende s'kish arritur të konsolidohej e të përdorte mundësitë për zhvillimin kulturor që potencialisht i përmbante. Rrethana të disfavorshme të kësaj natyre pati shumë gjatë gjithë periudhës së pavarësisë.

Kur u shpall pavarësia Ismail Qemali dhe patriotët demokratë nuk i nënçmuan mundësitë e reja në të mirë të zhvillimit kulturor të popullit. Nuk ishte aspak e rastit që dikasteri i arsimit në Qeverinë e I. Qemalit iu besua L. Gurakuqit, njërit prej përfaqësuesve më të shquar të kulturës shqiptare dhe të forcave shoqërore përparimtare. Madje, Qeveria e I. Qemalit nuk bëri pak për atë kohë që ekzistoi. Ajo vendosi t'i mbyllë shkollat e huaja, që kishin shërbyer si vatra të propagandës antikombëtare; më 1913 sollli nga jashtë një shtypshkronjë në të cilën botoheshin dokumentet zyrtare dhe gazeta qeveritare «Përlindja e Shqypnies»; në vitet 1912-1913 në zonat ku shtrinte autoritetin e vet kjo qeveri u çelën 64 shkolla; më 1913 rifilloi punën shkolla normale e Elbasanit, që përgatiste mësues; u shtua numri i gazetave dhe i botimeve. Por, sidoqoftë, e angazhuar me problemet e ngutshme të sigurimit të pavarësisë dhe të integritetit territorial, Qeveria e I. Qemalit nuk pati mundësi të shumta për t'iu përkushtuar ndërtimit kulturor. Pushtetin e saj ajo e shtriu vetëm në një territor të kufizuar. Shumica e trojeve shqiptare u gjendën për një kohë të gjatë të pushtuara nga ushtritë e Fuqive të Mëdha dhe të shteteve fqinje; vendi ishte bërë fushë përleshjesh të armatosura; luftërat ballkanike dhe Lufta e Parë Botërore sollën shkatërrime e mjerime kolosale. Në një situatë vërtet tra-

gjike u ndodhën sidomos ata shqiptarë (duke përfshirë këtu edhe kulturën e tyre), trojet e të cilëve u shkëputën padrejtësisht nga trangu amë dhe mbetën jashtë kufijve të shtetit kombëtar.

Vitet e mbrapshta të kësaj kohe e keqësuan edhe më gjendjen kulturore të vendit. Madje edhe qeveritë, që dolën nga Kongresi i Lushnjës dhe Revolucioni i Qershorit, nuk patën kohë e mundësi për të bërë gjera të rëndësishme në fushën e kulturës. Tepër e mbrapshtë për fatet e kulturës u tregua edhe koha e sundimit zogollian, sepse klasa feudale, që trashëgoi gjithë bagazhin antikulturor mesjetar dhe obskurantist klerikal, si dhe ajo pjesë e borgjezisë që i kishte lidhur interesat e saj me fuqitë e huaja, ndoqën një politikë antikombëtare, s'ishin të shqetësuar për zhvillimin e kulturës kombëtare, madje, prapambetjen kulturore e konsideronin një komoditet për të sunduar më me lehtësi e për ta mbajtur popullin nën zgjedhën e tyre. Ka mbetur proverbiale frika, që shprehte i ashtuquajtur ministër i arsimit i Qeverisë së Zogut, Fejzi Alizoti për «superproduksionin intelektual» në një kohë kur mbi 85% e popullsisë ishte analfabete. Regjimi zogollian qëndroi si pengesë ndaj zhvillimit kulturor të vendit. Ja përsë Shqipëria trashëgoi nga periudha e parvarësisë një prapambetje të theksuar kulturore.

Megjithëkëtë, kultura nuk mbeti në vend, nuk u shuan aspiratat për kulturë dhe nuk reshti gurra krijuese kulturore e popullit, nuk u ndërpre në përpjekjet për konsolidimin e pasurimin e kulturës kombëtare. Por *i gjithë zhvillimi kulturor i viteve 20-30 ishte tepër kontradiktor, u realizua përmes zigzagesh, luhatjesh, kthesash, arritjesh dhe humbjesh.* Gjallërimi i jetës kulturore në periudhën nga Kongresi i Lushnjës dhe deri në disfatën e Revolucionit Demokratik të 1924, u zëvendësua shpejt nga reaksioni kundërrevolucionar, që asgjësoi të drejtat e liritë demokratike më elementare, që vendosi regjimin e egër të hurit e të litarit. Vitet '30 u përcollën nga një rigjallërim i jetës shpirtërore e kulturore të vendit, që u shpreh në disa drejtime, ndonëse me karakter thëllësisht kontradiktor. Këtë e shohim në çdo fushë të kulturës.

Lufta për zhvillimin e arsimit kombëtar mori një farë hovi, sidomos, pas rimëkëmbjes së shtetit kombëtar dhe në sajë të dëshirave të arsimitarëve përparimtarë dhe njerëzve arsime-dashës. Idetë për një shkollë demokratike, laike kombëtare u përkrahën nga tri kongreset e arsimit, që u mbajtën përkatësisht në vitet 1920, 1922, 1924. Deri në fund të vitit shkollor 1938-1939 në Shqipëri numëroheshin gjithsej 643 shkolla fillore. Në vitet '20—30 u shtua numri i shkollave të mesme (siç ishin liceu dhe normalja për vajza në Korçë, gjimnazi në Gjirokastër, Tiranë, Shkodër, shkolla tregtare e Vlorës etj.), por ato i ndiqte një numër tepër i vogël nxënësish. Mësuesit përparimtarë zhvilluan një luftë këmbëngulëse për ta shkëputur shkollën nga institucionet fetare, për të mbyllur shkollat e huaja, për të vendosur arsimin e detyrueshëm fillor. Por realizimet në këto drejtime pengoheshin nga politika reaksionare e regjimit. Shumë shkolla mbylleshin ngaqë nuk gjenin përkrahjen e autoriteteve shtetërore; mësuesit paguheshin me vonesë, ishin vendosur taksa të rënda për ndjekjen e shkollave; shkollat e fshatrave i ndërtonin dhe i mbanin vetë fshatarët, që ishin në gjendje të mjeruar. Qeveria rivendosi lidhjen e institucioneve fetare me shkollën dhe riçeli shkollat e huaja. Prandaj përparimet tepër të kufizuara në arsimin kombëtar ishin para së gjithash fryte të etjes së popullit për arsim dhe i luftës këmbëngulëse të arsimitarëve patriotë kundër pengesave që ngrinte qeveria.

Në periudhën e pavarësisë u shtua numri i gazetave, revistave dhe tirazhi i tyre. Vetëm gjatë viteve 1921-1924, brenda e jashtë vendit dolën 30 gazeta dhe revista periodike. Në një varg qytetesh u hapën shtypshkronja: në Korçë, në Shkodër, në Tiranë, në Elbasan, në Durrës, në Vlorë, e në Gjirokastër. U rritën botimet, ndonëse tirazhi i tyre ishte i vogël, — kurrë më shumë se 1000 kopje. Zoëu i mbylli të gjitha organet e shtypit demokratik dhe vetëm në vitet 1934-1937, si rrjedhim i forcimit të qendrës popullore, u botuan në afate të shkurtra revista të reja përparimtare, si «Flaga» (Korçë, 1934), «A.B.C.» (Tiranë, 1935), «Rilindja» (Korçë 1934-1936), «Bota e re»

(Korçë 1936-1937) etj., që luajtën një rol të shquar në historinë e kulturës sonë kombëtare të kësaj periudhe⁵.

Gjatë pavarësisë u bënë përpjekje edhe për zhvillimin e studimeve shkencore në disa fusha, sidomos, në gjuhësi, histori, etnografi, folkloristikë etj., ku u dalluan studiues si A. Xhuvani, N. Mjeda, K. Cipo, E. Çabej, J. Rrota, I. M. Qafëzezi etj. Në këtë kohë u botuan vepra të shquara si «Kanuni i Lekë Dukagjinit» (1933) prej Sh. Gjeçovit. «Syntaksa shqipe» (1934) e A. Xhuvanit, «Për gjenezën e literaturës shqipe» (1939) e E. Çabejt, seria e «Visareve të Kombit» etj. Megjithëkëtë në këtë periudhë ra në sy moskokëçarja e plotë e regjimit për krijimin e institucioneve shkencore, për përgatitjen e studiuesve të kualifikuar dhe për zhvillimin e studimeve kërkimore-shkencore, të cilat mbetën kryesisht çështje interesimi vetjak dhe amatorësh.

Letërsia është fusha e veprimtarisë kulturore, që shënoi arritjet më të rëndësishme në vitet 1912-1939. Në atë kohë u zhvilluan prirje të reja në letërsi, që lidheshin me forcimin dhe gjallërimin e përmbajtjes sociale, e frymës kritike ndaj realitetit politik e shoqëror të kohës, e prirjeve realiste. Sidomos në krijimtarinë e F.S. Nolit e Migjenit u shprehën pakënaqësia e masave popullore ndaj zgjedhës klasore të bejlerëve dhe aspiratat e tyre për drejtësi shoqërore, u fshikulluan forcat e vjetra shoqërore. Erdhën duke u zgjeruar disi edhe llojet e gjinitë e artit. Krijues si Z. Kolombi, A. Kushi, A. Buza, N. Zajmi, S. Kaceli, Th. Agalliu sollën vepra, që mbetën në fondin e artë të pikturës sonë. Vepra e V. Mios dhe e O. Paskalit e ngriti pikturën e skulpturën tonë në nivelet e artit përparimtar botëror. Nisma pati edhe në fushën e muzikës dhe të teatrit, ndonëse ato mbetën në caqe kryesisht amatoreske. Një kontribut të pashlyshëm dhanë

5) Kontribut të madh dhanë edhe organet që botoheshin jashtë vendit si «Liria kombëtare» (Gjenevë 1925-1935), «Republika» (Boston 1930-1932), «Populli», «Sazani» (Lion 1936-1939), «Vullnetari i lirisë» (Spanjë) etj.

në muzikë T. Tashko, K. Antoniu, M. Kraja, J. Truja etj. Në mungesë të një prodhimitarie të gjerë artistike origjinale, një rëndësi të madhe kulturore patën edhe përkthimet që i sollën kulturës shqiptare emrat e Shekspir-it, Molierit, Gëtes e Shilerit, Balzakut, Ibsenit e Tolstoit, Çehovit e Gorkit etj.

Një fakt tjetër të rëndësishëm, që flet për karakterin tepër kontradiktor të zhvillimeve kulturore në kushtet e pavarësisë, ne e shohim në *thellimin e diferencimit social-klasor brenda kulturës kombëtare*. Lufta midis drejtimit demokratik revolucionar, nga njëra anë, dhe drejtimit reaksionar, nga ana tjetër, përbën strumbullarin e gjithë zhvillimit kulturor të viteve 20-30. Shenjat e para të këtij procesi ishin shfaqur qysh para Shpalljes së Pavarësisë, kur brenda kulturës shqiptare kishte zënë të dukej dallimi i dy krahëve — atij popullor, që mbështeste kërkesat më radikale të lëvizjes për çlirim kombëtar, deri në shkëputje e formimin e shtetit të pavarur kombëtar dhe të krahut të moderuar dhe reaksionar, që mbështeste platformën e kompromisit ose nënshtrimit brenda Perandorisë Osmane. Gjatë shek. XIX ky diferencim ishte më pak i ndijshëm, sepse gjithë platforma kulturore e Rilindjes frymëzohej nga ideja e unitetit kombëtar. Por përbërja socialklasore heterogjene e kombit borgjez, tashmë të formuar, nuk mund të mos linte gjurmë edhe në sferën e jetës shpirtërore dhe të kulturës së tij. Ky fakt u bë i dukshëm qysh në dekadën e parë të shek. XX. Menjëherë pas revolucionit xhonturk u manifestua qartë përveçimi i krahut të «opingës» nga krahu i «oxhaqeve» dhe i programeve të tyre të ndryshme kulturore.

Pas Shpalljes së Pavarësisë ky diferencim u thellua edhe më tej dhe u kushtëzua nga një shpërndarje e re e forcave socialklasore dhe e qëndrimeve të tyre në sferën e kulturës. Deri në Kongresin e Lushnjës vatra e polemikave ishte çështja e pavarësisë, për të cilën kishte pikëpamje të kundërta e të ndryshme, që u shprehën edhe në gjithë ngjarjet politike të ngatërruara të kohës. Në vitet 20, sidomos gjatë Revolucionit të Qershorit, u da-

llua qartë krahu demokratik antifeudal i kulturës, nga ai krahu që mbronte interesat e çifligarëve. Në vitet '30, ndonëse duket sikur mbizotëron diversiteti e pluralizmi ideologjik e kulturor, në të vërtetë thellohet kontrasti midis dy kraheve themelorë, që ishte shprehje e kontrastit të interesave të të shtypurve dhe shtypësve, të forcave përparimtare dhe forcave reaksionare.

Ky kontrast u manifestua gati në të gjitha fushat e kulturës. Në arsim vihen re prirja për ta vënë shkollën në shërbim të plotë të regjimit reaksionar dhe prirja për ta shndërruar në vatër të edukimit qytetar patriotik, demokratik e revolucionar të brezit të ri. Edhe shtypi e periodiku u diferencuan në organe që mbanin qëndrim kritik ndaj regjimit dhe në organe që mbështesnin dhe i thurnin lavde atij. Jeta letrare në tërësi u bë më e diferencuar në rrafsh socialklasor, në përmbajtje dhe në stile. Megjithëkëtë, letërsia artistike, duke pasqyruar proceset e reja shoqërore e historike, diferencohet në *reaksionare* dhe *përparimtare*, anakronike e novatore, realiste e formaliste, elitaro-aristokratike dhe demokratike, eksperimentale dhe e angazhuar etj. Pati edhe letrarë që filluan në njërin drejtim e me kohë kaluan në një drejtim tjetër; pati që ecën përpara, por pati edhe të atillë që bënë prapa. Sidoqoftë Asdreni, Fan Noli, Bulka, Migjeni etj., përbëjnë një rrugë plot arritje, që dëshmoi për një progres, i cili iu kundërqëndroi platformave ideoestetike reaksionare, formaliste e konservatore. Madje edhe në sferën e përkthimeve u duk kontrasti ideologjik: nga njëra anë, letërsia e verdhë komerciale dhe, nga ana tjetër, letërsia demokratike e revolucionare.

Kultura nuk është vetëm një tërësi vlerash, as vetëm një cak i arritur, por është edhe një mekanizëm zhvillimi, sepse, nga njëra anë, paraqitet si kujtesë që përthith arritjet historike të kombit, dhe si shprehje e shkallës së zhvillimit të përgjithshëm shoqëror, por nga ana tjetër, bart me vete edhe përfytyrimin për të ardhmen dhe është thirrje drejt saj. Në këtë kuptim, kur flasim për zhvillimin kulturor në kohën e pavarësisë, sidomos në vitet '30,

nuk mund të mos konstatojmë një fakt tjetër të rëndësishëm se në vatrën e shqetësimeve të tij qëndroi problemi i idealit shoqëror, i së ardhmes, i perspektivave të vendit. Rëndësia që mori ky problem ishte e lidhur me pakënaqësinë e masave të gjera për gjendjen e shoqërisë shqiptare, me pakënaqësinë e tyre ndaj realitetit shoqëror bashkëkohor. Në këto rrethana regjimi i Zogut ndiente nevojën për të pasur një «fasadë» apo «dekor» kulturor, ndonëse ai mbështeste vetëm një variant krijimtarie, vetëm atë që punonte për një kulturë oborrtare, apologjike, gjumëndjellëse dhe konformiste. Këtë domethënie kishte gjithë propaganda kulturore e ideologjike, që i thurte hymne «monarkisë së ndritur» dhe që kërkonte nënshtrim të verbër ndaj realitetit të shëmtuar. Me këtë realitet pajtoheshin edhe ata që, prapa parullës demagogjike të «shqiptarizms», idealizonin jetën patriarkale, flirtonin me historinë kombëtare duke fshehur gjendjen e mjeruar të masave, prapambetjen e përgjithshme dhe duke përligjur paaftësinë e regjimit për të sjellë përparim e kulturë. Nuk ngriheshin në nivelin e një kritike të vërtetë edhe ithtarët e amalgamës eklektike të «neoshqiptarizms» me imitim të modeleve të botës «okcidentale». Përkrahësit e fashizmit jo vetëm nuk i servirnin ndonjë rrugëdalje e perspektivë të vërtetë progresi shoqërisë shqiptare, por, për më tepër, ishin angazhuar në veprën më antikulturore — përgatitnin katastrofën e 7 prillit të vitit 1939. E gjithë kultura zyrtare që ngjizej mbi këtë platformë ideologjike, nuk mund të kishte vitalitet e rrënjë të thella në tabanin kombëtar, nuk i hapte shoqërisë shqiptare asnjë perspektivë, përkundrazi, e zhyste në gjendje amullie, letargjie sociale, të cilën e zbuloi me mprehtësi Migjeni, kur vajtonte: «Kudo valojnë/ flamujt e një melankolie të trishtueshme...». Përvoja historike provoi se regjimi antipopullor i Zogut, duke u nisur nga interesat e ngushta klasore të feudalëve e të borgjezisë reaksionare, nuk ishte i interesuar jo vetëm për të kapërcyer prapambetjen, por as për të mbrojtur interesat kombëtare, pavarësinë e lirinë e Atdheut. Prapambetja

ekonomike e kulturore po vepronte si erozion dhe po e gërryente tabanin e pavarësisë.

Në këtë situatë pati forca shoqërore, të cilat, të zhgënjyera nga realiteti i prapambetur dhe nga ngadhnjimi i padrejtësisë sociale, shikonin prapa, rronin me nostalgjinë e idealeve iluministe e romantike të së kaluarës. Por kthimet prapa historia nuk i ka qejf, sado të sigjerta të jenë shpresat e dëshirat subjektive për to; përpara nuk mund të ecej duke vështuar prapa, duke u joshur siç thoshte Migjeni, nga «ëndrra të vjetra». Dhe prandaj në vitet 30 fitoi domethënie të madhe pasqyrimi në sferën e kulturës i aktivizimit të forcave të reja shoqërore, i demokratëve revolucionarë e i komunistëve, që bartnin edhe aspirata të reja kulturore. Mbi këtë truall shoqëror në vitet 30 hodhën shtat filiza të një kulture të re thellësisht demokratike, revolucionare e kombëtare, një kulturë që shprehu interesat e masave popullore dhe që mbështeti luftën e tyre kundër regjimit zogist dhe politikës së tij antikombëtare, që e lidhi luftën antif feudale të popullit me synimet për krijimin e një rendi demokratik, për përparim e drejtësi shoqërore. Në piedestalin e kësaj kulture qëndrojnë, sidomos vlera të tilla të qëndrueshme si ato, që spikatën në krijimtarinë letrare të Fan Nolit ose të Migjenit, në publicistikën e Halim Xhelos e të Nonda Bulkës, në revistat «Bota e re» dhe «A.B.C.» etj. Sado të brishtë që patën qenë në fillim këta filiza, ata fituan një vend nderi në historinë e kulturës shqiptare, jo vetëm ngaqë u krijuan në kushte tepër të mundimshme të palirisë, por edhe ngaqë ngjallnin shpresa për të ardhmen, bartnin mall për këngë të reja, madje epike dhe paralajmëronin stuhi revolucionare. Ky krahu demokratik i kulturës kombëtare të viteve 30 u shqua për frymën e tij kritike; ai shprehu mllëfin e grumbulluar kundër botës së padrejtë, u tregua i papajtuësëm me lloj-lloj mite e iluzione joshëse, maska e paragjykime të verbra që prodhonte e përhapte kultura zyrtare; ai zbuloi gjendjen e rëndë të prapambetur të vendit e në mjerim të masave dhe formuloi ideale të reja shoqërore, që i frymëzonin ato në luftë për

liri. Brenda këtij krahu të kulturës Migjeni shprehte një shqetësim mbarëpopullor, kur thoshte: «S'duam me humbë/ Në lojë të përgjakun të historisë njerëzore», «s'duam shekujt të tallen më me ne», «s'duam të jemi një thumb ngulur në trutë e njerzimit». Kjo kulturë u mbylli portën «veriu acar», erërave ideologjike reaktionare, që të mos hynin «me na fik dritën, me na ngri shpirtin». Me vlerat dhe mesazhin e saj kjo kulturë çeli ato shtigje, nëpër të cilat forcat e shëndosha të kombit, në kohët tragjike të humbjes së pavarësisë dhe të Luftës së Dytë Botërore, u inkuadruan në Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare, në revolucionin popullor, të frymëzuar e të udhëhequr nga idealet komuniste të Partisë sonë.

Fitorja e revolucionit popullor shënoi fillimin e një epoke të re të historisë kombëtare, kur jo vetëm fati i pavarësisë, por edhe i zhvillimit kulturor u lidhën pazgjidhmërisht me luftën e masave për likuidimin e rendit shfrytëzues e për ndërtimin e shoqërisë socialiste. Nga ai çast e deri në ditët tona transformimet shoqërore socialiste ia ndryshuan pamjen Atdheut; revolucionin kulturor zhduku prapambetjen e trashëguar nga e kaluara, e shndërroi kulturën nga privilegj të një pakice në pronë të masave të gjera të popullit. Me ndërtimin e socializmit u krijua një kulturë e re e pasur socialiste, demokratike e kombëtare. Kultura e re socialiste është bërë një nga shprehjet më të rëndësishme të emancipimit shpirtëror të popullit, e lulëzimit të forcave, energjive e talenteve krijuese të tij, e përparimit të kombit tonë socialist. Ajo përthith gjithë vlerat pozitive të trashëgimisë kulturore kombëtare të së kaluarës, me mesazhin e saj komunist, me vlerat e shquara që përmbledh luan një rol të madh në forcimin e pavarësisë dhe mbrojtjen e lirisë, në përparimin e pandalur të Atdheut në rrugën e socializmit.

ARBEN PUTO

PAVARËSIA E SHQIPËRISË NË KUADRIN E PROCESIT ÇLIRIMTAR NË BALLKAN

Pavarësia e Shqipërisë përveç rëndësisë në vetvete si kurorëzim i përpjekjeve të kombit shqiptar, është edhe një element i ri i situatës në Ballkan. Nëntori i 1912-s mbyll epokën e sundimit osman në Gadishull. Pas grekëve, rumunëve, sllavëve të jugut (serbë e bullgarë), edhe shqiptarët dolën në një jetë shtetërore më vete, duke realizuar kështu një aspiratë të tyre kombëtare, por edhe duke iu përgjigjur një ideali ballkanik për ta kthyer Gadishullin tonë në një rajon shtetesh të lira. Me këtë ngjarje u përcaktua në vija të përgjithshme fizionomia politike e Ballkanit të shekullit XX që do të plotësohej përfundimisht pas Luftës I.

Sigurisht Nëntori i 1912-s mund të quhet një vepër «e pasosur» në shumë anë. Po të kihen parasysh vështirësitë, provat e rënda, peripecitë e shumta që u desh të përballonte vendi, jo vetëm në atë moment historik të dhënë, por edhe në tërë dhjetëvjeçarin vijues (gjatë Luftës I, madje edhe më pas) mund të flitet për një kalvar të vërtetë të Pavarësisë. Një pikëpyetje do të rëndonte mbi

fatin e saj edhe për shumë kohë. Pengesat ishin të karakterit të dyfishtë: të brendshëm dhe ndërkombëtar. Megjithatë Nëntori i 1912-s u konfirmua gjatë viteve si një zhvillim që nuk mund të kishte asnjë kthim prapa, si një etapë e pashmangshme jo vetëm për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, por edhe më gjerë, për procesin çlirimtar në Ballkan.

Siç e vë në dukje sh. Enver Hoxha «lufta e popullit tonë (për pavarësi) zë një vend me rëndësi në «imbrogliion» e çështjes së Orientit dhe jo vetëm nga një pikëpamje e ngushtë shqiptare», por edhe në shkallë ballkanike, madje edhe në nivelin e politikës së Fuqive të Mëdha imperia-
liste të Evropës.¹

*
* *
*

1. Çështja shqiptare është pjesë e çështjes kombëtare që dominon historinë e Ballkanit gjatë gjithë shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX. Pavarësisht nga veçoritë e saj specifike, ajo ka një emërues të përbashkët me çështjen kombëtare në të gjitha vendet e Gadishullit: ajo është shkak dhe pasojë e krizës së Perandorisë Osmane. Kriza e Perandorisë Osmane identifikohet me Krizën Lindore që ka zënë një vend aq të rëndësishëm si në diplomacinë aktive të kohës, ashtu edhe për pasojë në historinë e diplomacisë. Fillimisht Kriza Lindore ka qenë një koncept më i gjerë që ka përfshirë jo vetëm vendet e Ballkanit, por edhe zotërimet e tjera të Turqisë. Lindja e Afërt, Ngushticat dhe përgjithësisht pellgu i Mesdheut Lindor kanë pasur dikur një rol të dorës së parë si në jetën e brendshme të Perandorisë, ashtu edhe në nivelin e politikës së Fuqive të Mëdha evropiane. Për disa dhjetëvjeçarë këto dy probleme të mëdha ndërthuren dhe bashkëjetojnë, por gradualisht, sidomos prej mesit të

1) Enver Hoxha, *Vepra*, vëll. 23, f. 128.

shek. XIX, qendra e gravitetit nga krahinat periferike spostohet në Ballkan, që përfaqëson prezencën e Turqisë në Evropë. Atëherë çështja lindore del në trajtën e saj moderne: thelbin e çështjes lindore e përbën tanimë problemi i së ardhmes së popujve të Ballkanit që ndodhen nën Turqinë. Ky problem shtrohet për të gjithë popujt e Gadishullit, pa marrë parasysh ndryshimet në kohë. Këtë e tregon vetë zhvillimi i ngjarjeve: pas shpërthimit të parë lëvizjet kryengritëse në Gadishull ndjekin njëra-tjetrën, si në një reaksion zinxhir. Shekulli XIX është shekulli i rënies së pëershpejtuar të Perandorisë Osmane. Përpara se t'i ekspozohet aksionit gërryes të forcave të jashtme, ajo i nënshtrohet një procesi të thellë dezintegrimit brenda kufijve të saj. Ballkani i shekullit të kaluar zien nga idetë e çlirimit kombëtar. Është koha kur parimi i kombësisë njih një shtrirje në shkallë evropiane. Në Perëndim janë lëvizjet për unifikimin e Italisë e të Gjermanisë. Kësaj i përgjigjet në Lindje zgjimi i përgjithshëm i popujve nën Turqinë. Entitetet kombëtare synojnë të ngrihen në nivelin e entiteteve politike. Kombet e shtypura hidhen në luftë për të krijuar shtetet e tyre kombëtare.

Krijimi i shteteve të para në Ballkan është padyshim një faktor i ri në zhvillimin e situatës në gjithë rajonin. Faktor i ri novator, por edhe kontradiktor. Nga njëra anë, fakti i krijimit të secilit prej tyre duhet të konsiderohet si një arritje jo vetëm për kombin përkatës, por edhe në kuadrin e gjithë procesit çlirimtar në Ballkan. Nga ana tjetër, këto shtete, sapo dalin në skenën politike, nuk udhëhiqen më nga idealet që frymëzonin lëvizjet kombëtare përkatëse. Kjo nuk mund të mos çonte në prishjen e atij solidariteti ndërballkanik, e asaj atmosfere miqësie e ndihme reciproke që rrethoi lëvizjet e para kryengritëse, sidomos atë greke. Si rezultat, ajo që duhej të mbetej si një nga faqet më të ndritura të historisë së Gadishullit i la vendin një gjendjeje konfliktesh të gjata e të vazhdueshme me pasoja aq të kobshme për interesat e vërteta të gjithë popujve të kësaj zone.

2. Është e qartë se lëvizja shqiptare nuk mund të trajtohet ndryshe, veçse duke u vendosur në kontekstin gjeografik e historik të Ballkanit. Çdo përpjekje për ta ndarë atë, për ta shkëputur prej këtij kuadri të natyrshëm, nuk ka të bëjë me objektivitetin shkencor. Janë të njohura trajtimet e historisë shqiptare nga pozita nihiliste, trajtime që jo rrallë kanë pasur pretendime dhe janë veshur me petkun e «shkencës albanologjike». Pa hyrë në analizën e gjithë repertorit të gjerë të propagandës anti-shqiptare, le të kufizohemi të përmendim tezën që shërben si platformë e kësaj propagande, që nuk njeh asnjë qytetërim origjinal shqiptar: popullsitë shqiptare janë përshkruar si një element i huaj në Ballkan, që nuk ngjizet me historinë ballkanike, si një fenomen që gjoja përfaqëson shkallën më të ulët të jetës shoqërore dhe si i tillë, edhe në qoftë se e ka pasur një rol në historinë e Gadishullit, ky ka qenë ai i bartësit dhe përçuesit të influencave e interesave të jashtme.

Vetëm një injorim i plotë i fakteve mund të çojë në të tilla pohime. Historia e shek. XIX në Ballkan flet jo vetëm për kontradikta midis ballkanasve, por edhe për një bashkësi të thellë interesash që ka gjetur shprehje si në sferën e ideve, ashtu edhe në veprimtari konkrete. Nuk do të ndalemi në lëvizjet kryengritëse të gjysmës së parë të shek. XIX, gjatë të cilave shqiptarët shumë shpesh kanë hyrë me fqinjët në marrëdhënie bashkëpunimi dhe ndihme reciproke. Kjo është ndoshta një fazë tepër e hershme, që mund të quhej faza romantike e lëvizjes çlirimtare në Ballkan. Në këndvështrimin tonë, rëndësi të veçantë marrin kontaktet e vendosura pas krijimit këtu të shteteve.

Kronika e këtyre kontakteve nxjerr në shesh fare qartë se Shqipëria dhe shqiptarët qysh herët tërhiqnin vëmendjen pikërisht si një forcë potenciale që mund të jepte kontributin e vet në luftën çlirimtare kundër Perandorisë Osmane. Kështu 10 vjet përpara Kongresit të Berlinit traktati i fshehtë greko-serb i shkurtit 1868 parashikonte shprehimisht pjesëmarrjen e Shqipërisë në

projektet për një luftë të ardhshme kundër Turqisë. Ndo-nëse kjo orvatje e parë për krijimin e një aleance ballka-nike përmbante qysh atëhere elementin eksploziv të pre-tendimeve territoriale (që preknin edhe tokat shqiptare) fakti është kuptimplotë në vetvete, sepse çdo perspektivë e një rregullimi të ri në Ballkan jo vetëm që nuk e për-jashtonte çështjen shqiptare, por e përfshinte si pjesë për-bërëse.²

Në kohën e Kongresit të Berlinit tensioni është në rritje edhe në marrëdhëniet ndërballkanike. E megjithatë aspiratat e shqiptarëve dhe lëvizja e tyre kanë peshën e vet në ngjarjet e Krizës Lindore. Nuk është e rastit që qeveria greke menjëherë pas fillimit të luftës ruso-turke në korrik 1877 dërgon emisarët e saj për të zhvilluar bise-dime të fshehta me personalitete shqiptare (Abdyl Frashëri etj.), bisedime që kanë për qëllim bashkëpunimin dypa-lësh në luftën çlirimtare.³ Pavarësisht nga përfundimi i pafrytshëm i këtyre bisedimeve (për shkak të këmbë-nguljes së Athinës për ta integruar Shqipërinë e ardhshme në njëllëj monarkie dualiste me hegjemoni greke), për-sëri edhe këtu fakti ka domethënien e vet si një provë e njohjes së rolit të lëvizjes shqiptare në kuadrin e procesit çlirimtar në Ballkan. Është koha kur çështja shqip-tare fillon t'i imponohet vëmendjes së diplomacisë evropiane si një nga elementet e situatës në lëvizje në zonën e Evropës Juglindore. Sidoqoftë asnjë histori e kësaj pe-riudhe nuk është shkruar dhe as mund të shkruhet pa re-flektuar në një masë ose në një tjetër faktorin shqiptar: janë bërë interpretime të shumëllojshme, janë bërë shtre-mbërime keqdashëse ose janë dhënë gjykime simpliste, por në çdo rast faktori shqiptar ka dalë midis rreshtave. Lidhja Shqiptare e Prizrenit është një ngjarje tepër e

2) L. S. Stavrianos, *Balkan Federation. A History of the Move-ment toward Balkan Unity in modern times*, Northampton Mass, 1944, p. 97.

3) Kristo Frashëri, *Abdyl Frashëri*, Tiranë 1984.

madhe që të mund të nënvleftësohet e aq më pak të lihet në heshtje.

Në fund të fundit, cili ka qenë bilanci i Krizës Lindore të nesërmen e Kongresit të Berlinit? Padyshim një dobësim i përgjithshëm i Perandorisë Osmane, një tërheqje e ndjeshme e sundimit turk në Gadishull me tkurrjen e mëtejshme të kufijve të Perandorisë, por edhe me zbehjen e pushtetit qendror në trevat shqiptare. Tri dekadat që shkojnë deri në Shpalljen e Pavarësisë shënohen nga një shkallëzim i fuqishëm i lëvizjes sonë kombëtare. Situata në Shqipëri ndjek po ato tendenca themelore sikurse situata e përgjithshme në Ballkan. Ballkani që kapërcen pragun e shek. XX është Ballkani jo vetëm i shteteve, por edhe i gjithë popujve, kombeve e kombësive, që edhe pse me radhë të shpërndara, ecin të gjitha drejt objektivit final që është çlirimi nga zgjedha osmane. Objektivisht, pra, kemi një kauzë të përgjithshme ballkanike si sintezë, rezultante e programeve të lëvizjeve të veçanta kombëtare.

3. Vizioni panballkanik i gjendjes dhe perspektivës së Gadishullit është një tipar i njohur i mendimit politik që paraprin dhe shoqëron procesin e zgjimit të kombeve në rajon. Rigas Fereros, paralajmëtari dhe frymëzuesi i pasionuar i kryengritjes greke, që shumë vjet përpara shpërthimit të saj, nga fundi i shek. XVIII, me himnin e tij të famshëm «Thurios» u lëshonte kushtrimin e luftës çlirimtare gjithë popujve të Perandorisë pa asnjë dallim, as kombësie, as feje, as ngjyre e as race. I lirë siç ishte nga paragjykimet shoviniste, ai i përfytyronte popujt e Gadishullit si një vëllazëri të vetme. Aty kishin sigurisht vendin e tyre të natyrshëm edhe shqiptarët, të cilët Rigasi i kishte njohur e kishte jetuar me ta që në fëmëni në vendlindjen e tij Veleshtino, ku kishte mjaft prej tyre.⁴

4) Bile shqiptarët e Veleshtinos e kanë quajtur të tyre. Shih A. Daskalakis. *Rhigas Velestinlis. La Revolution française et les préludes de l'indépendance hellénique*, Paris 1937, pp. 23-29.

Mendimtarët revolucionarë të shek. XIX si Markoviçi në Serbi, Karavellovi, Levski dhe Botevi në Bullgari ishin kundër çdo nacionalizmi të ngushtë dhe ekskluzivist dhe bindjet e tyre republikane i çonin deri te ideja utopike e një federate ballkanike. Pavarësisht nga iluzionet e tepruara federaliste, ajo që tërheq vëmendjen është se përtëritjen e shoqërisë ballkanike ata e konceptonin si një proces çlirimtar unik. Luftën për çlirimin e kombit të vet ata e lidhnin me atë të popujve fqinjë. Ajo që i karakterizonte më mirë këta kampionë të lirisë ballkanike ishte hendeku që i ndante nga politika zyrtare e shteteve përkatëse. Ata s'kishin asgjë të përbashkët as me «Naçertanien» serbe as me «Megali-idenë» greke. Njëri prej tyre shkruante në pragun e shpërthimit të krizës lindore më 1875 se «qeveritë e këtyre shteteve gjithë kohën nuk kanë bërë gjë tjetër veçse kanë imituar moton famëkeqe të Meternikut: *divide et impera*,⁵ një aluzion i qartë ky për grindjet midis tyre për ndarjen e plaçkës pas disfatës turke.

Idetë e solidaritetit ndërballkanik kanë gjetur jehonë të gjerë në gjirin e Rilindjes sonë. Shoku Enver Hoxha e ka quajtur këtë si një nga tiparet e saj më thelbësore. Ai është shprehur me këto fjalë kuptimplote: «Një orientim me rëndësi të madhe i njerëzve të Rilindjes, që vërteton madhështinë, diapazonin e gjerë dhe përmbajtjen e thellë revolucionare të lëvizjes sonë kombëtare, ishte synimi për ta lidhur luftën e popullit tonë me luftën çlirimtare të popujve fqinj kundër armikut të përbashkët, ishte internacionalizmi i tyre».⁶

Figurat më të shquara të Rilindjes sonë, edhe pse kanë qenë të angazhuara në një veprimtari të vendosur e të gjatë në mbrojtje të të drejtave të kombit shqiptar të kërcënuara nga synimet e qarqeve drejtuese të shteteve fqinje, prapë kanë qenë të lira nga çdo lloj paragjykimi, janë ngritur përmbi meritë kombëtare dhe u kanë drej-

5) Sipas L.S.Stavrianos, vep. për., p. 118.

6) Enver Hoxha, *Vepra*, vëll. 24, f. 12.

tuar mesazhe të zjarra miqësie e vëllazërie gjithë ballkanasve. Rilindasi ynë i madh Naim Frashëri tregonte një frymë të lartë internacionaliste kur shkruante: «Ne me sllavët e me grekët, me të gjithë fqinjët tanë/ Duam të rrojmë nga herë në harmoni, si vëllezër/ Veç e drejta e secilit gjithnjë të respektohet./ Sot tiranin e pret vdekja, pra nuk duhet të luftojmë/ Si armiq me njeri tjetrin; miq të jemi në një mendje/. . . Poshtë pra, trazirat, grindjet, rroftë e qoftë vëllazëria».⁷

Personaliteti më i shquar që del në skenën politike shqiptare prej fundit të shekullit të kaluar është Ismail Qemali. Ai është protagonist kryesor i ngjarjeve që kurorëzohen me Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë dhe me krijimin e Shtetit të ri shqiptar. Është interesante të ndiqet rruga që ka përshkuar ai në veprimtarinë e tij të gjatë politike dhe, bashkë me të, evolucioni i pikëpamjeve të tij lidhur me çështjen kombëtare në Ballkan. Dihet se karrierën e tij ai e nisi duke zënë poste të rëndësishme në aparatën burokratike të Perandorisë herë në qendër e herë në krahinat periferike. Në fillimet e veprimtarisë së tij ai nuk i përket rrymës radikale që është për shembjen e Perandorisë Osmane. Mirëpo I. Qemali kishte pikëpamje të avancuara për kohën e tij. Që në debutimet e tij si burrë shteti ai u bashkua me krahun liberal reformist që doli në vitet 70 në jetën politike të Turqisë. Ishin pikërisht këto bindje liberale, reformiste që zgjuan tek ai pikëpyetje dhe dilema lidhur me të ardhmen e Perandorisë. Jo vetëm nga «Kujtimet» e tij,⁸ por edhe nga veprimtaria praktike gjatë dy dekadave të fundit të shek. XIX del qartë se ai ka pasur një vizion plurinacional dhe, pra, panballkanik në trajtimin e krizës së brendshme të Perandorisë në kuptimin që ishte dhe shprehej, një kohë, për transformimin e kësaj mbretërie autokratike, të ngritur mbi bazën e shtypjes më të vrazhdë kombëtare, në një bashkësi shumëkombëshe që duhej të realizonte

7) Naim Frashëri, *Vepra të zgjedhura*, vëll. I, f. 486-487.

8) *The Memoirs of Ismail Kemal Bey*, London, 1920.

bashkëjetesën paqësore dhe barazinë e popujve dhe kom-
bësive të ndryshme. Pavarësisht nga mungesa e çdo për-
fytirimi të qartë mbi format konstitucionale në të cilat
do të mund të derdhej kjo ide «unioniste», e cila në fund
të fundit ishte utopike dhe antihistorike, një gjë mund
të thuhet me siguri se I. Qemali e shtronte problemin jo
nga pozita partikulariste, por pikërisht si problem i së
ardhmes së gjithë Ballkanit, i ndërtimit të marrëdhënieve
ndërballkanike mbi baza të drejta e të qëndrueshme. Si-
gurisht vetë përvoja e drejtpërdrejtë do ta shtynte edhe
atë vetë të kuptonte se kjo ishte një ëndërr e porealizue-
shme. Porse kjo metodë tërësore e shikimit të proble-
meve e ndihmoi atë të njohë e të kuptojë më mirë jetën,
problemet, aspiratat e popujve e kombeve të rajonit, i
dha atij mundësinë të vendosë lidhje dhe kontakte të llo-
jeve e niveleve të ndryshme, gjë që e bën I. Qemalin një
nga figurat më të shquara jo vetëm të lëvizjes shqiptare,
por edhe në shkallë ballkanike. Ai nuk e konceptoi asnjë-
herë pavarësinë e Shqipërisë dhe krijimin e Shtetit shqip-
tar në funksion antibalkanik si instrument i politikës së
kësaj apo asaj Fuqie të madhe kundër shteteve fqinje.
Premisë të paqes dhe sigurisë në Ballkan ai quante ka-
përcimin e tendencave hegjemoniste dhe të xhelozive
kombëtare, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin konstruktiv
midis shteteve të reja sovraane.

4. Kjo frymë nuk ishte e një individi, ajo ishte e
gjithë lëvizjes së Pavarësisë. Edhe pse nuk u bashkuan
me Aleancën ballkanike të 1912-s për shkak të ujdive
të pjesëtarëve të saj për copëtimin e tokave shqiptare,
qarqet më të ndriçuara të lëvizjes nuk e ndanë asnjëherë
fatin e vendit nga ai i vendeve fqinje. Të marrim Qeve-
rinë e Përkohshme të Vlorës. Memorandumi i paraqitur
prej saj në fillim të janarit 1913 në Konferencën e amba-
sadorëve dallohet pikërisht për atë që çlirimin e popujve
të Ballkanit e quan si një proces unik, si një vepër të për-
bashkët, në të cilën gjithë popujt, pra edhe shqiptarët,
kanë dhënë kontributin e tyre. «Kombi shqiptar, — thu-
het në memorandum, — është i bindur se aleatët ballka-

nikë do të kenë parasysh pikëpamjen se veprimi i për-
bashkët i ndërmarrë prej tyre (është fjala për Luftën
ballkanike — A.P.) deri diku është vazhdim i kryengritje-
ve të fundit të Shqipërisë dhe se sukseset e tyre të djeshme
mund të konsiderohen me plot të drejtë si frytet e
veprës së çlirimit në të cilën shqiptarët, si sot, ashtu edhe
në të kaluarën, me anë të kryengritjeve të vazhdueshme...
janë shquar për trimëri». ⁹ Kjo i jepte të drejtë Shqipërisë
së pavarur të zinte vendin e merituar në Ballkanin e ri
me të drejta të plota përkrah shteteve të tjera të rajonit
pas çlirimit nga zgjedha osmane. Për këtë, në memoran-
dumin e Qeverisë së Vlorës deklarohet se «populli shqip-
tar... ka vetëm një qëllim: të ketë me fqinjët e tij ma-
rrëdhënie sa të përzemërta aq edhe të qëndrueshme». ¹⁰
Në përgjithësi memorandumi shqiptar, shquhet për tonin
krejt distensiv, për moderacionin e tij dhe për vullnetin
e mirë të qeverisë shqiptare për t'i zgjidhur problemet
me shtetet fqinje jo në rrugën e konfrontimit, por në atë
të mirëkuptimit e të drejtësisë. Në gjithë tekstin e doku-
mentit nuk gjendet asnjë fjalë, asnjë shprehje fyese apo
armiqësore as në adresë të sllavëve, as në adresë të gre-
këve, përkundrazi, atë e përshkon një ndjenjë respekti
si për luftën e tyre çlirimtare, ashtu edhe për të drejtat
e tyre.

Në këtë vështrim interes paraqitin edhe deklaratat
e I. Qemalit, kur ai tashmë është në krye të qeverisë së
Vlorës. Ato janë shprehje e po asaj linje. Në një intervistë
dhënë shtypit të Londrës në prill 1913 ai thoshte: «Neve
na vjen keq për një gjë; që sukcesi i një lufte që kishte
për qëllim çlirimin e gjithë popujve të Ballkanit, i prishi
aq shumë fqinjët tanë, sa që ata tani duket se mendojnë
se kanë të drejtë t'i shtypin shqiptarët të cilët edhe këta
nuk kanë më pak të drejtë të jetojnë, sepse janë banorët
më të lashtë të Gadishullit dhe qenë të parët që luftuan

9) *Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj* (28
nëntor 1912 — 22 janar 1914), Tiranë, 1963, dok. nr. 135.

10) *Po aty*.

kundër turqve për lirinë e tyre kombëtare» (këtu sigurisht është fjala për kryengritjet e mëdha të verës 1912 në prag të shpërthimit të Luftës Ballkanike). Shihet pra, se I. Qemali shpreh keqardhjen për qëndrimin e qarqeve drejtuese të monarkive të Ballkanit kundrejt çështjes shqiptare, por kjo nuk e pengon atë të njohë funksionin objektivisht përparimtar çlirimtar të Luftës ballkanike, ta trajtojë atë, pra, pikërisht në kuadrin e procesit çlirimtar në ballkan. I. Qemali del me të vërtetë si zëdhënës i një kauze ballkanike dhe jo thjesht ngushtësisht nacionale, kur thotë: «Ne do ta mbrojmë çështjen tonë dhe do ta bëjmë këtë jo vetëm në interes të popullit tonë, por edhe në dobi të atyre vendeve që na u bënë kundërshtarë, në vend që të bëheshin miqtë tanë». Këto fjalë janë një model urtësie politike: ato kanë pa dyshim një notë kritike, por ato janë njëkohësisht edhe një thirrje drejtuar gjithë ballkanasve me vullnet të mirë për t'u angazhuar në një veprimtari konstruktive për ta çuar deri në krye procesin çlirimtar në Ballkan, i cili kurrsesi nuk mund të quhej i përfunduar pa zgjidhjen e çështjes shqiptare.

5. Në kohën e luftërave ballkanike në qëndrimin e shteteve të Gadishullit kundrejt çështjes shqiptare, vihet re një ndryshim në krahasim me periudhën e krizës lindore të çerekut të fundit të shekullit XIX. Atëherë, në Kongresin e Berlinit si dhe të nesërmen e tij gjatë trajtimit të problemeve që dolën në vazhdim dhe zbatim të vendimeve të Fuqive, me gjithë peshën që patën në zhvillimin e ngjarjeve ato që aso kohe u quajtën «vështirësitë shqiptare», qarqet drejtuese të shteteve fqinje nuk përcaktuan asnjë pozitë zyrtare lidhur me çështjen shqiptare, madje nuk e morën në konsideratë si një çështje më vete, që shtrohej në fakt veçan dhe anash marrëdhënieve të tyre me Perandorinë Osmane. Në traktativa apo akte zyrtare, ata nuk donin të njihnin veçse një kundërpalë: atë turke, edhe kur bëhej fjalë për pretendimet e tyre mbi toka shqiptare.

30 vjet më vonë, më 1912-1913, situata ka evoluar si në pikëpamje të objektivave të Lëvizjes Kombëtare Shqip-

tare, ashtu edhe në planin e politikës evropiane. Të dy faktorët shtrojnë tanimë si alternativë të vetme pavarësinë e Shqipërisë. Kuptohet se në këto rrethana shtetet ballkanike detyroheshin të përcaktonin qëndrimin e tyre kundrejt çështjes shqiptare si të tillë.

Vetë qarqet drejtuese të këtyre vendeve tregonin një interesim të shtuar për rrjedhën e ngjarjeve në Shqipëri. Ato ndiqnin nga afër sidomos kryengritjet e njëpasnjëshme në Shqipërinë veriore, që ishin në fakt preludi i Luftës Ballkanike. Nuk është e rastit që në veri mbërrinin njëri pas tjetrit emisarë të qeverive serbe e malazeze, ndërsa pas Shpalljes së Pavarësisë bëheshin sondazhe «eksplorative» pranë I. Qemalit dhe Qeverisë së Përkohshme. Mund të mendohej se kjo do të shënonte një kthesë dhe se qeveritë e vendeve fqinje nuk do të mbyllnin më sytë përpara realitetit të lëvizjes çlirimtare shqiptare. Situata ishte e pjekur edhe për një ndërgjegje ballkanike, e cila duhej të ngrihej sadopak mbi një konception tepër të ngushtë e egoist të interesave kombëtare. Në të vërtetë, në vitin e pavarësisë së Shqipërisë monarkitë e Ballkanit, ndërsa vazhdonin orvatjet për instrumentalizimin e përpjekjeve të shqiptarëve në luftën kundër Turqisë, dilnin me platformën më të plotë anti-shqiptare përpara diplomacisë evropiane.

Kjo ishte edhe përmbajtja e memorandumeve të paraqitura nga qeveritë serbe e greke në fillim të janarit 1913 në Konferencën e ambasadorëve. Asnjëherë propaganda antishqiptare nuk ka qenë aq intensive dhe aq virulente sa në kohën kur merret në shqyrtim pavarësia e Shqipërisë dhe dy aktet e lartpërmendura janë një shprehje e koncentruar e kësaj propagande. Pikërisht atëherë doli dhe u hodh në qarkullim të gjerë një literaturë e tërë që përpunonte dhe zhvillonte tezat dhe «argumentet» e njohura që atakonin historinë e shqiptarëve, identitetin e tyre, që i bënin ata muhaxhirë në tokat e tyre, gati si një popullsi nomade, që duhej t'i nënshtrohej «misionit qytetërues» të shteteve fqinje.

Koniunktura të caktuara kanë bërë që jehona e kë-

tyre «argumenteve» të ndihet edhe sot e kësaj dite, porse asgjë nuk është e re, e as origjinale, të gjitha çfarë shkruhen e thuhet janë përsëritje, kopjime, «ribotime», ato e zënë fillin që prej asaj kohe kur në rend të ditës është shtruar konkretisht çështja e pavarësisë shqiptare. Frazeologjia patjetër i është përshtatur kohës, aty-këtu mund të vihet re edhe ndonjë tërheqje anësore. Përvoja e këtyre 75 vjetëve ka nxjerrë në shesh se tezat e mësipërme, edhe në trajtat e tyre më të stërholluara e bashkëkohore, tingëllojnë më shumë se kurrë false e anakronike, aq më tepër që ato u kundërvihen ecurive historikisht të domosdoshme. Del pyetja përse ky qëndrim negativ i qarqeve drejtuese të shteteve fqinje kur vjen momenti i shqyrtimit të çështjes shqiptare si çështja kombëtare e fundit në Ballkan e pjekur po ashtu për zgjidhje? Cilat kanë qenë arsyet që i kanë shtyrë ato të shkëputin çështjen shqiptare nga çështja kombëtare në Ballkan, nga kuadri i lëvizjes çlirimtare në Gadishull? Është e qartë se prapa këtyre orvatjeve qëndron çështja territoriale.

Çështja territoriale ka qenë shkaku kryesor që ka helmuar marrëdhëniet ndërballkanike. Ajo ka ndodhur sepse problemi është trajtuar jo në bazë të parimit të shfaqjes së vullnetit të lirë dhe të vetëvendosjes së kombeve, por thjesht nga pozita ekspansioniste e hegjemoniste. Sa më afër fundit të Perandorisë Osmane, aq më tepër ngatërrohet çështja e ndarjes së territoreve që ajo do të lerë pas. Pas shpërthimit të luftës ballkanike dy janë pikat kryesore ku përqëndrohen synimet për zgjerimin territorial të monarkive të Ballkanit: Maqedonia dhe Shqipëria. Por analogjia midis tyre është relative. Maqedonia e kohës për të cilën po flasim ishte veçanërisht e përzier e heterogjene nga pikëpamja etnike. Prandaj mund të pritej që ajo të ishte një sferë veçanërisht e kontestueshme. Kurse krahinat shqiptare ishin të banuara nga një popullsi që tanimë njihej si komb më vete. E megjithatë pretendimet mbi këto krahina nuk shkaktuan më pak konflikte midis ballkanasve dhe diskutime e kontradikta midis Fuqive.

Fillimisht parashikohej copëtimi i plotë i tokave shqiptare dhe ky ishte një nga objektivat kryesorë të Aleatëve të Ballkanit para se të nisnin luftën kundër Turqisë në vjeshtë 1912. Të ndodhur përballë variantit të pavarësisë së Shqipërisë, ato qenë të shtrënguar t'i ridimensiononin kërkesat e tyre, por gjithsesi përpiqeshin të nxirrnin sa më shumë përfitime. Për këtë duhej të shërbenite platforma e paraqitur në Konferencën e Londrës, një platformë që e pranonte pavarësinë e Shqipërisë jo si përfundim logjik i ciklit historik në Ballkan, por vetëm si «një lëshim» që u bëhej konsideratave gjeopolitike të Fucive në rajon, si një «sakrificë» e fitimtarëve. Të ashtuquajturat «të drejta historike» apo arsyetimet e ndryshme «etnografike, ekonomike, strategjike, kulturore» etj., të zhvilluara gjatë e gjerë të gjitha në një frymë denigruese antishqiptare, kishin për qëllim të përligjinin kërkesat e tepruara territoriale, ta reduktonin deri në minimum hapësirën jetike të Shqipërisë së ardhshme. Sipas shprehjes së një diplomati të kohës ajo ruante shpresën e vjetër që ajo (Shqipëria) të binte vetiu «si një pemë e arrirë» në një koniunkturë më të përshtatshme.

Nga ana e saj, edhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare ka përcaktuar qëndrimin e saj për sa i përket çështjes territoriale. Ajo u ndodh përballë këtij problemi për herë të parë në periudhën e krizës lindore të çerekut të fundit të shek. XIX. Në këtë drejtim veprimtaria e Lidhjes së Prizrenit nuk u kufizua me anën deklarative, ajo u shpreh edhe në një varg aksionesh për mbrojtjen e tokave të banuara nga popullsia shqiptare. Pas shpalljes së Pavarësisë kur shtrohet çështja e kufijve të Shtetit shqiptar me shtetet fqinje, ky qëndrim është formuluar në memorandumin e lartpërmendur të Qeverisë së Vlorës paraqitur Konferencës së ambasadorëve. Pa dyshim problemi territorial ka qenë një nga aspektet më të rëndësishme të programit të Lëvizjes sonë, porse në çdo kohë, e aq më tepër më 1912-1913 ai është shtruar në terma kryesisht difensive. Teprime mund të ketë pasur dhe ato janë shprehje e interesave të ngushta klasore që shkojnë tej ca-

geve të objektivave nacionale. Veçse nuk janë ato që karakterizojnë programin territorial të Lëvizjes sonë kombëtare. «Shqipëria e madhe» është një fikSION që është shpikur shumë kohë më vonë, dhe që në mënyrë paradoksale është përdorur për qëllime propagandistike antishqiptare. Po të vendosemi drejt në kohë, nuk mund të mos konkludojmë se thelbi i këtij programi ka qenë që të përballohej euforia pushtuese e Aleatëve të Ballkanit pas fitores në luftë, të shpëtoheshin tokat historikisht dhe etnikisht shqiptare dhe të sigurohej kështu një bazë territoriale e domosdoshme për mbijetesën e shqiptarëve si komb dhe për organizimin e tyre në shtet më vete.

6. Historia e Ballkanit gjatë shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX paraqet dy anë: njera, e brendshme, është rënia e vazhdueshme e Perandorisë Osmane dhe zgjimi i kombeve; tjetra, e jashtme, përfaqësohet nga ndërhyrja gjithnjë e më e madhe e Fuqive të Mëdha imperialiste. Kjo ndërhyrje shënon fazën e fundit në historinë e marrëdhënieve midis Perandorisë Osmane dhe fuqive evropiane. Dikur ishin turqit që hynë në Evropë, kapërcyen Ngushticat, zunë Ballkanin dhe u futën deri në Evropën Qendrore. Dy shekuj më vonë kemi kthesën në kah të kundërt: Traktati i Karlovacit i vitit 1699 shënon fundin e avancatës turke dhe fillimin e kundërofensivës evropiane. Perandoria Osmane është vazhdimisht në tërheqje. Kjo tërheqje nxjerr një problem: në Lindje krijohet një zbrazëti politike. Si të mbushet kjo zbrazëti — ia një ndër problemet më të mëdha që i është dashur diplomacisë evropiane të përballojë për një kohë të gjatë, gati pa ndërprerje, deri në mbarim të Luftës I Botërore. Ky ka qenë edhe thelbi i çështjes lindore nga pikëpamja e politikës së Fuqive të Mëdha në çdo etapë dhe në çdo formë që ajo është shtruar para tyre. Rënia e Perandorisë Osmane nxjerr në pah çështjen kombëtare në Ballkan, por Evropa priret ta shikojë atë nën prizmin e ndarjes së sferave të influencës dhe të ruajtjes së «ekuilibrit të forcave».

Lidhur me këtë është me vend që të vendoset një

raport i drejtë midis çështjes kombëtare në Ballkan dhe ndërhyrjes evropiane. Me fjalë të tjera duhet të sqarohet cili ka qenë roli i faktorëve jashtëballkanikë në zhvillimin e situatës në Gadishull, në procesin çlirimtar që shkon paralelisht me rënien e Perandorisë turke. Përgjigjja që mund të jepet varet nga pikënisja metodologjike. Është një rrymë e tërë në historiografinë borgjeze që absolutizon rolin e të mëdhenjve dhe minimizon atë të të vegjëlve, zhvillimin dhe fatin e lëvizjeve popullore të brendshme e kushtëzon me vullnetin dhe interesat e Fuqive. Është një fakt i njohur se jo vetëm politikanët, burrat e shtetit, por edhe studiues të shumtë e kanë trajtuar çështjen lindore në tërësi kryesisht si problem të diplomacisë. Proceset e brendshme të Perandorisë, lëvizjet e kombeve të shtypura të Ballkanit nuk janë vlerësuar gjithnjë sipas rëndësisë së tyre reale, madje janë paraqitur si pasojë e nxitjeve nga jashtë. Interpretime të tilla nënvleftësuese mund të jenë më të përhapura për lëvizjen shqiptare, por ato nuk janë të vetme. Kështu lëvizjet e sllavëve të jugut që i përkasin pikërisht periudhës së shekullit XIX kanë ardhur duke u zhvilluar si një rilindje e vërtetë kombëtare, e megjithatë edhe sot mund të dëgjohet jehona e disa zërave se ato kanë qenë pjellë e politikës hegjemoniste të Rusisë, në një shkallë të konsiderueshme vepër e agjitorëve e misionarëve të idesë pansllaviste. Kjo shpjegohet edhe me faktin se deri vonë sllavët e jugut kanë qenë po ashtu ndër popujt «e harruar» të Evropës. Deri aty nga vitet 30 të shek. XIX hartat etnografike të Ballkanit nuk tregoheshin aspak më të vëmendshme kundrejt popullsive sllave dhe e përshkruanin Gadishullin Ballkanik si të banuar kryesisht prej turqve e grekëve (sigurisht të nisur nga kriteret e përkatësisë fetare).¹¹ Sot asnjë historiografi serioze, e aq më pak marksiste, nuk mund të pajtohet me mendimin se lëvizjet e vërteta popullore çlirimtare mund të krijohen nga hiçi e të mani-

11) L. S. Stavrianos, *The Balkans since 1453*, New York 1961, p. 230.

pulohen tërësisht sipas shijeve apo skemave të politikaneve e diplomatëve. Kjo vlen për të gjitha lëvizjet kombëtare në Ballkan, pa përjashtuar as atë shqiptare.

Faktori i ndërhyrjes evropiane në Ballkan, pikërisht për të mbushur zbrazëtirën e lënë pas nga Perandoria Osmane, nuk mund të mohohet. Por nuk është i vetmi. Dinamika e zhvillimit të situatës në Gadishull përcaktohet nga gërshetimi dhe bashkëveprimi i dy faktorëve: evropian dhe lokal. Ka padyshim një ndërvarësi midis tyre, por faktori lokal, ballkanik ka peshën kryesore. Është ai motori i ngjarjeve, është ai që ushtron presion të vazhdueshëm mbi diplomacinë evropiane, duke e detyruar këtë t'i kthehet e t'i rikthehet çështjes lindore.

Dihet se pamundësia për t'u marrë vesh lidhur me fatin e zotërimeve të Turqisë në Ballkan ka qenë një ndër shkaqet që çuan në lindjen e «koncertit të Fuqive», i cili veçanërisht në Kongresin e Parisit të vitit 1856, pas Luftës së Krimesë, nuk gjeti rrugëdalje tjetër veç përmirimit të integritetit të Perandorisë Osmane. Kontradiktat ndër imperialiste duhej të përcaktonin imobilizimin në situatën ballkanike. Mirëpo kjo nuk mund të ishte veçse një *modus vivendi*, një marrëveshje e përkohshme që e shtynte problemin vazhdimisht për më tutje. Ngjarjet në Ballkan, procesi çlirimtar kudo në zhvillim e në ngjijtje i shpërthenin kornizat e vjetruara të statukuosë. Dy krizat e mëdha të çështjes lindore: ajo e çerekut të fundit të shek. XIX dhe ajo e viteve 1912-1913 e kanë origjinën të veprimet e ballkanasve, nuk janë iniciativa të diplomacisë evropiane. Është e pranuar përgjithësisht se kryengritja e përgjithshme shqiptare e verës 1912 dhe shpërthimi i Luftës I Ballkanike që pasoi në vjeshtë, i zuri në befasi Fuqitë. Kjo nuk i pengoi ata të ndërhynin me tërë peshën e tyre kur erdhi çasti i marrjes së vendimeve. Mirëpo, procesi çlirimtar në Ballkan ka logjikën e vet të brendshme, ka forcat e tij lëvizëse, ai lind dhe zhvillohet në truallin ballkanik; ai pëson ndikimet e jashtme, por nuk është thjesht një refleks i tyre. Asnjë lëvizje kombëtare e Gadishullit nuk mund të quhet instrument i politikës së kësaj apo asaj Fuqie edhe

pse në këtë drejtim nuk kanë munguar përpjekjet nga ana e tyre. I njëjti arsye' im vlen edhe për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Pavarësia e Shqipërisë doli si një nyjë tepër e ngatërruar e kontradiktave midis Fuqive dhe kjo bëri që padrejtësitë më të mëdha të binin në fund të fundit mbi kurriz të shqiptarëve. Në këto kushte është jo vetëm e pasaktë, por edhe cinike të pohohet se Shteti i pavarur shqiptar ishte produkt i diplomacisë evropiane.

*
* *
*

Historia e 75 vjetëve të kaluar ka provuar tanimë qartë se Pavarësia e Shqipërisë ka qenë një plotësim i natyrshëm i procesit çlirimtar në Ballkan dhe njëkohësisht një element stabiliteti dhe paqeje në Gadishull. Vlera dhe rëndësia e pavarësisë shqiptare për gjithë këtë rajon ka dalë në pah jo vetëm në situata paqësore, por sidomos në periudha tensionesh e konfliktesh: kur është kërcënuar ose është goditur pavarësia e Shqipërisë dhe është vënë në pikëpyetje gjithë ekuilibri ballkanik, janë rrezikuar gjithë popujt e tjerë fqinjë. Kjo ndodhi si gjatë Luftës I, ashtu edhe gjatë Luftës II Botërore. Mësimi kryesor që duhet të nxjerrim nga historia është, pra, se konsolidimi i pavarësisë së Shqipërisë është një premisë e domosdoshme në dy drejtime: edhe për përparimin e shoqërisë së re shqiptare, edhe për zhvillimin normal të marrëdhënieve ndërballkanike. Shqipëria e sotme socialiste, e pavarur jo vetëm në formë, por edhe në përmbajtje, është garancia më e mirë. Me politikën e saj parimore ajo ngre një barierë të fuqishme kundër ndërhyrjeve dhe intrigave të jashtme në këtë pjesë të Gadishullit. Asnjë e keqe nuk mund t'u vijë popujve fqinjë nga ana e Shqipërisë socialiste.

Duke e ngritur në një shkallë më të lartë traditën e vyer internacionaliste të Lëvizjes sonë kombëtare, RPS e Shqipërisë u kushton vëmendje të posaçme marrëdhënieve me vendet fqinje. Shoku Ramiz Alia në raportin

e Kongresit të 9-të tha se zhvillimi i marrëdhënieve me këto vende «përbën një nga përparësitë e politikës sonë të jashtme». ¹² E kaluara ka lënë trashëgim këtu mjaft probleme. «Historia, — thekson sh. Ramiz, — popujt e Ballkanit i ka përzier shumë, ndoshta më shumë se kudo në botë. Minoritete etnike të secilit popull ndodhen brenda kufijve shtetërorë të tjetrit. Ndjeshmëria ndaj trajtimit të tyre ka qenë dhe mbetet e madhe. Nga ky trajtim janë varur shumë edhe marrëdhëniet e mira ose të këqia ndërmjet shteteve të Gadishullit tonë. Me këto ndjenja kanë luajtur edhe Fuqitë e Mëdha për t'i futur në grindje ata e për t'i vënë njerin kundër tjetrit, për të ndërhyrë në punët e brendshme e për të ndikuar në punët e jashtme të tyre». ¹³ Forcat përparimtare të Ballkanit janë në gjendje t'i përballojnë këto probleme, t'i kapërcejnë «paragjykimet e vjetra, mentalitetet që u përkasin epokave të kaluara, grindjet dhe mëritë e mëparshme». ¹⁴ Këto forca do të kenë gjithmonë mbështetjen pa rezerva të Shqipërisë socialiste.

12) Ramiz Alia, *Raport në Kongresin IX të PPSH, Tiranë, 1986, f. 181.*

13) *Po aty, f. 182-183.*

14) *Po aty.*

**HEKURAN MARA
VENIAMIN TOÇI**

MENDIMI EKONOMIK SHQIPTAR NË PERIU DHËN E PAVARËSISË

Përgatitja, Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe lufta e bërë për arritjen dhe mbrojtjen e saj reale, kanë qenë një proces historik me përmbajtje politiko-shoqërore komplekse. Si një komponent i rëndësishëm i kësaj përmbajtjeje përfshihet edhe aspekti ekonomik i saj, sepse fitimi i pavarësisë politike nuk mund të mos shtronte edhe çështjen e zhvillimit të ekonomisë së vendit dhe të sigurimit të pavarësisë ekonomike të tij. Me të pasur «duartë e këmbëtë zgjidhur» nga zinxhirët e pushtuesit të huaj osman, «sytë e mendja e shqiptarëve duhen kthyer nga ekonomia»¹, shkruante Sami Frashëri qysh në fund të shekullit të kaluar.

75 vjetët që na ndajnë nga dita e madhe e 28 Nëntorit 1912, si provë e domosdoshme e kohës janë të mjaftueshme për të dhënë një vlerësim objektiv edhe për mendimin politiko-shoqëror lidhur me çështjen e pavarë-

1) Sami Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë*, Tiranë, 1962, f. 63.

sisë ekonomike të vendit, mendim ky i shprehur nga patriotët demokratë shqiptarë të periudhës së Rilindjes dhe të dhjetëvjeçarëve të parë të shekullit XX.

*
* * *

— Për zhvillimin e ekonomisë dhe pavarësinë ekonomike të vendit ekziston pa dyshim edhe një mendim ekonomik shqiptar, në të cilin është pasqyruar koncepti i tij për këtë problem. Pa njohjen dhe vlerësimin e paanshëm të këtij mendimi, edhe Pavarësia e Shqipërisë si dukuri komplekse nuk do të ishte e plotë. Duke u mbështetur në burimet që disponojmë gjer më sot, në këtë referat do të përpiqemi të paraqesim një pasqyrë sintetike dhe të vemë në dukje disa anë të veçanta të atyre vlerave të krijuara nga ky mendim për çështjen e zhvillimit të ekonomisë e të pavarësisë ekonomike të vendit, të cilat e kanë përballuar provën e kohës dhe janë bërë tashmë pronë e historisë, duke u rrënjosur kështu thellë në këtë kujtesë kolektive të kombit e të popullit shqiptar.

— Rrethanat historike të njohura u mpleksën në mënyrë të atillë që lufta për pavarësinë e vendit ka qenë kurdoherë pjesë e pandarë e luftës që ka bërë populli shqiptar për ruajtjen e identitetit të tij kombëtar; e përpjekjeve që ka ndërmarrë dhe e aspiratave që ka pasur ky popull për emancipim material, shoqëror e shpirtëror, për një jetë më të mirë e të begatë. Në këtë luftë ai s'ë ka ndarë asnjëherë çështjen e unitetit kombëtar nga ajo e unitetit ekonomik, përparimin ekonomik nga përparimi shoqëror, arritjen e pavarësisë politike nga ajo ekonomike. Këto tipare thelbësore për pavarësinë i gjejmë të mishëruara në mendimin politiko-shoqëror të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, si dhe gjatë tërë periudhës para dhe pas Shpalljes së Pavarësisë.

Pikëpamjet e shprehura nga rilindasit për zhvillimin e ekonomisë së vendit mbështeteshin fort në gjendjen

reale të saj dhe në parashikimin e paralajmërimit e atij ndryshimi të dëshiruar që ajo duhet të pësonte medoemos në të ardhmen. Ata nuk u pajtuan në asnjë rast me çfarëdo ideje vegjetimi e aq më tepër fataliteti për gjendjen ku e kishte katandisur ekonominë e vendit pushtuesi i huaj, por luftuan gjithnjë si përkrahës të flaktë e të vendosur të zhvillimit të saj. Çdo lëkundje apo mëdyshje në këtë drejtim do të ishte sipas tyre me pasoja të shumanshme e tepër të rrezikshme për fatet e kombit e të ardhmen e tij, sepse do ta dënonte vendin e popullin me prapambetje të rënduar e të zgjatur.

I tërë mendimi politiko-shoqëror i rilindasve u doli përpara prirjeve reale të zhvillimit kapitalist të ekonomisë, që edhe pse ende nuk ishin shfaqur e nuk vepronin në përmasa të mëdha, ata kishin bindjen e thellë se këto prirje përmbanin gjëra të reja e përparimtare, se ato u përgjigjeshin në përgjithësi interesave të klasës që përfaqësonin. Ata i vlerësuan drejt këto prirje, treguan drejtimet e mundshme për realizimin e tyre, mjetet që duheshin për arritjen e qëllimit, si dhe zbuluan forcat shoqërore që ishin të interesuara për perspektivën e re historike që çelej para tyre.

Prirjeve

Periodha pas Shpalljes së Pavarësisë e gjer në fund të viteve 30-të të shekullit tonë, është ajo kur në shoqërinë shqiptare sundon rendi çifligaro-borgjez dhe në ekonominë e vendit mpleksen e bashkejtajnë marrëdhëniet feudale me ato borgjeze, kapitaliste. Në këtë periudhë edhe mendimi për zhvillimin e ekonomisë dhe pavarësinë ekonomike paraqet një rëndësi më të madhe jo vetëm në rrafshin e arsytimit teorik, por edhe në atë të masave praktike që duheshin zbatuar. Në të njëjtën kohë ai merr edhe karakter më të theksuar klasor, sepse në të përplasen si interesat e borgjezisë në zhvillim, ashtu edhe ato të feudalizmit në shtthurje, por që koha kishte shtruar si imperativ, zhdukjen e tij nga skena historike.

Sipas pikëpamjeve që u shfaqën lidhur me rrugët që duheshin ndjekur për zhdukjen e mbeturinave të feudalizmit, për zhvillimin e kapitalizmit, si dhe për sigurimin

e pavarësisë ekonomike të vendit, edhe në mendimin ekonomik shqiptar të kësaj kohe u ballafaquan rryma të tilla, të cilat shprehnin e mbronin interesat klasore të forcave shoqërore që përfaqësonin.

*
* *

— Duke i parë problemet ekonomike në funksion të pavarësisë, duke bërë propozime konkrete dhe duke milituar për realizimin e tyre, rilindasit, hapën në historiografinë shqiptare të kohës epokën e studimeve social-ekonomike, të cilat kanë ushtruar një ndikim të ndjeshëm në zhvillimin e mendimit politik-shoqëror shqiptar përparimtar të kohës.

— Edhe pse nuk mundën të pasqyronin në tërësi problemet e zhvillimit të ekonomisë e të pavarësisë ekonomike dhe të përpunonin një politikë ekonomike të gjerë e të plotë lidhur me zgjidhjen e tyre, mendimet më me interes, më me peshë dhe më koherente për këto probleme, i gjejmë të shprehura në veprat e figurave më të shquara të periudhës së Rilindjes, si Zef Jubani, Pashko Vasa, Sami Frashëri e të pasardhësve të tyre.

— Pë hyrë në analizën e hollësishme të fakteve të paraqitura dhe mendimeve të shprehura nga rilindasit lidhur me gjendjen e ekonomisë shqiptare në gjysmën e dytë të shek. XIX, në përgjithësi mund të themi se ata me të drejtë e vënë theksin në faktin që ekonomia e kësaj kohe ishte e njëanshme nga pikëpamja e strukturës, me bujqësi primitive e me industri në shkallën e «foshnjërisë» dhe e prapambetur nga niveli i zhvillimit. Mbi pasuritë e vendit dhe forcat e natyrës, mbi çdo gjë që prodhohej e hynte në qarkullim ekonomik, kishin shtrirë duart pushtuesi osman, çifligarët dhe tregtarët vendas. Kudo sundonte shtypja, shfrytëzimi, mjerimi e vuajtja e përditshme e popullit. Prandaj ndryshimi i domosdoshëm, rrënjësor e sa më i shpejtë i kësaj gjendjeje ishte edhe

3 për rilindasit problemi i parë e më i ngutshëm i vendit, ishte rruga magjistrale për ta nxjerrë atë nga prapambetja, një objektiv i pashmangshëm që duhej arritur në kuadrin e luftës për pavarësi. Rilindasit si njerëz të ditur e me horizont të gjerë arritën të tregojnë jo vetëm gjendjen e prapambetur të ekonomisë shqiptare dhe shkaqet e kësaj gjendjeje, por edhe mundësitë që ekzistonin në vend dhe rrugët që duheshin ndjekur për të dalë prej saj.

— Mendimtarët e Rilindjes e kuptonin dhe e kishin të qartë se për zhvillimin e ekonomisë së vendit, për arritjen e pavarësisë dhe konsolidimin e saj të shumanshëm do të konkurronin faktorë të ndryshëm. Sipas tyre këta faktorë fillonin nga organizimi i fortë e ngritja e një administrate shtetërore të përshtatshme për nevojat dhe karakterin e popullsisë, në forcimin e rendit publik e të respektit për autoritetet zyrtare për të ardhur pastaj tek sigurimi i pronës dhe i lirisë së personit, tek zhvillimi i bujqësisë e i blegtorisë në përmasa më të mëdha se ato ekzistuese, tek zhvillimi i shpejtë e pa pengesa i tregtisë dhe i industrisë në mënyrë të atillë, që t'i krijonte vendit burime të reja materiale e financiare, të brendshme e të jashtme. Tërë këta e faktorë të tjerë që përmendin rilindasit, janë elemente interesante e që duhen vënë në dukje për të karakterizuar përmbajtjen dhe thellësinë e mendimeve të tyre me karakter ekonomiko-shoqëror, duke i vlerësuar këto gjithnjë në funksion të pavarësisë. Në këtë mënyrë edhe zhvillimi i ekonomisë konceptohet si një zhvillim kompleks shumëdegësh dhe jolinear, por i integruar, mbi bazën e burimeve e të pasurive të vendit.

— Hedhja e vështrimit përtej asaj që duhet të ndodhte pas Shpalljes së Pavarësisë lidhur me zhvillimin e ekonomisë, i çonte rilindasit medoemos edhe tek problemi: a i kishte Shqipëria burimet njerëzore, aftësitë dhe mjetet e nevojshme për të siguruar zhvillimin ekonomik? Përgjigjja për këtë problem dhe zgjidhja e tij kishte rëndësi të madhe si për pavarësinë politike, ashtu edhe për atë ekonomike, prandaj edhe merrte një mprehtësi të veçantë.

Karakteristikë dalluese e të gjithë mendimtarëve të Rilindjes lidhur me qëndrimin ndaj këtij problemi është vlerësimi i lartë që ata i bëjnë, në radhë të parë faktorit njeri jo vetëm nga pikëpamja numerike, por edhe cilësore, duke vënë në dukje karakteristika, cilësi e virtyte të tilla të popullit shqiptar të trashëguara brez pas brezi dhe të sprovuara ndër shekuj, si traditat dhe dashuria për punën, aftësia dhe shpirti krijues etj. Duke bërë fjalë për të gjitha këto karakteristika të popullit shqiptar, Sami Frashëri shkruan: «Në punëra e mjeshtëri shqiptari s'është më pak i zoti se në luftë e në dituri: punon dhenë pa lodhje, hap vija të thella, mund të bëjë punëra të mëdha e të vyera. Është hekurpunonjës i shquar, bën thika, gërshërë, armë etj. Një herë ta shohë një pushkë të dalë nga fabrikat e Evropës e të bërë me makina të mbaruara është i zoti atë çast ta bëjë pa të shquar me dorë e me vegla të meta...

Me një fjalë: shqiptarët janë trima, të mençëm, punëtorë, të zot për çdo punë».²

Ndërsa Zef Jubani, i cili shpreh gjithashtu besimin se populli shqiptar i ka të gjitha mundësitë për të hyrë në rrugën e qytetërimit duke u mbështetur në fuqinë shpirtërore e materiale të tij, shkruan se është i gabuar dhe i papranueshëm mendimi i ndonjë shqiptari që kujton se shpëtimi e qytetërimi i Shqipërisë do të vijë nga kombet e huaja. Ai shkruan açik e prerë: «Unë nuk kam besim në sinqeritetin e të huajvet, se mund të bajnë një të mirë, pa një qëllim të dytë».³

Besimi i patundur se populli shqiptar do ta fitonte vetë lirinë duke mos e pritur nga të tjerët dhe besimi po aq i patundur në mundësitë njerëzore e materiale që kishte vendi për të zhvilluar ekonominë e vet, përbëjnë dy anë të të njëjtit parim themelor, të cilin rilindasit e përsëritin me forcë dhe i përmbahen me vazhdimësi. Ky parim përfaqëson në atë kohë, mbi të gjitha një ideo-

2) *Po aty*, f. 78.

3) Zef Jubani, *Vepra të zgjedhura*.

logji optimiste, që kultivonte e rrënjoste në masat punonjëse besimin se vetëm ato mund t'i zgjidhin problemet e tyre, mund ta fitonin pavarësinë politike dhe ekonomike të vendit.

Ky nuk ishte një pohim i llogaritur për efekte e motive retorike apo i hedhur rastësisht në qarkullim. Ai ishte i menduar thellë e i peshuar mirë, ishte produkt i natyrshëm i luftërave për liri e pavarësi që kishte bërë populli shqiptar, i atyre pësimeve shekullore që ishin luajtur në kurriz të tij nga të huajt, ishte përfundim i njohjes së synimeve të politikës që ndiqnin ndaj Shqipërisë shtetet borgjeze të Evropës, të mëdha e të vogla për të vendosur sundimin e vet politik dhe ekonomik. Këtë aftësi shekullore e këtë forcë përgjithësimi të popullit shqiptar, shoku Enver Hoxha e ka cilësuar me këto fjalë lapidare: «Populli ynë nuk e ka ndarë kurrë dyfekun me gjalmë nga libri, shpatën nga pena, trimërinë nga dituria, luftën nga puna».⁴

Rilindasit kanë genë më shumë partizanë të një politike ekonomike proteksioniste sesa të një politike të dyerve të hapura. Edhe pse një qëndrim të tillë nuk e gjejmë të shprehur në mënyrë të prerë, koncepti që ata kanë për problemet e zhvillimit të ekonomisë shqiptare në kuadrin e pavarësisë, thirrja që Sami Frashëri u drejton shqiptarëve për të mos e lënë «ekonominë e vendit në duart e të huajve», si dhe dëshira e tij dhe e figurave të tjera të shquara të Rilindjes për të prodhuar në vend gjërat e ndryshme që ka nevojë populli etj., të gjitha këto flasin për mosbesim ndaj politikës së dyerve të hapura.

Politika e proteksionizmit e përkrahur nga rilindasit, u përgjigjej detyrave themelore në kushtet e dhëna historike që ishin fitimi i pavarësisë dhe mbrojtja e interesave të popullit, të çifligarëve të lidhur me tregun dhe të borgjezisë vendase në lindje e në zhvillim. Kjo politikë tek Zef Jubani ka si strumbullar zhvillimin e

4) Enver Hoxha, *Raporte e fjalime, 1972-1973*, Tiranë 1973, f. 429.

○ tregtisë së jashtme të lidhur ngushtë edhe me zhvillimin e degëve të tjera të ekonomisë. Tek Pashko Vasa rolin e strumbullarit për realizimin e saj e luan zhvillimi i bujqësisë i shoqëruar me zhvillimin e tregtisë dhe të industrisë. Tek Sami Frashëri politika e protekcionizmit merr një trajtë më të plotë e më të argumentuar, sepse strumbullari i saj krahas zhvillimit të bujqësisë, industrisë, transportit dhe tregtisë pasurohet edhe me elemente të reja përbërëse, siç janë krijimi i një sistemi financiar, bankar e monetar të pavarur, krijimi i ~~buxhetit të shtetit~~, të kreditit, të qarkullimit monetar e të sigurimit të parasë etj. Të gjitha këto çështje nga pikëpamja se si i trajton dhe i zgjidh Sami Frashëri, përfaqësonin elemente të domosdoshme dhe të qenësishme për pavarësinë ekonomike, si dhe për realizimin e attributeve të vërteta të pavarësisë politike e të sovranitetit të shtetit të ardhshëm kombëtar shqiptar.

Njohja e realitetit politik dhe ekonomiko-shoqëror prej nga niseshin rilindasit në formulimin e pikëpamjeve të tyre lidhur me çështjen e pavarësisë, i dhanë mendimit të tyre disa tipare në vija të përgjithshme të përbashkëta. Me anën tjetër, shkalla e pasqyrimit të këtij realiteti dhe argumentet që paraqiten për shndërrimin e tij në të ardhmen, mbajnë vulën e personalitetit, të njohurive dhe shqetësimeve kryesore të secilit, të evolucionit që bëhet tek ata për mbrojtjen e interesave të klasës që përfaqësojnë. Me këtë shpjegohet edhe kontributi që ka sjellë e vendi që zë secili prej tyre në krijimin e mendimit ekonomik shqiptar në periudhën e përgatitjes së pavarësisë.

— Përshkrimi i gjendjes ekonomiko-shoqërore dhe i rrugëve të zhvillimit të ekonomisë, të para kurdoherë me syrin e pavarësisë politike dhe ekonomike të vendit, përbën një subjekt të përbashkët për të gjithë mendimtarët e Rilindjes. Në veprën e Sami Frashërit ky subjekt jo vetëm që trajtohet në mënyrë më ballësore, më të plotë e më të thellë, por edhe mendimet e shprehura prej tij paraqisin një interes të veçantë, sidomos në rrafshin e

politikës ekonomike që duhej ndjekur nga shteti i pavarur shqiptar, dhe të masave praktike që duheshin marrë për zbatim.

Prandaj në historinë e mendimit politiko-shoqëror shqiptar Sami Frashëri ka hyrë e do të mbetet si një ditjetar i madh, me të cilin edhe mendimi ekonomik shqiptar gjatë periudhës së Rilindjes arriti një shkallë të dukshme zhvillimi.

Në tërësinë e problemeve të pavarësisë ekonomike të rrahura nga mendimi politiko-shoqëror gjatë periudhës së Rilindjes një kontribut më vete përbëjnë edhe pikëpamjet e shprehura në shtypin e kohës. Për përhapjen e pikëpamjeve të drejta në zgjidhjen e detyrave historike në interes të popullit dhe të klasës që përfaqësonin, milituan publicistë përparimtarë si Mihal Grameno, Petro Nini Luarasi, Jani Vreto, Sali Nivica, Aleksandër Stavre Drenova, Andon Zako Çajupi, Luigj Gurakuqi etj. Në artikujt e tyre vazhdon të përpunohet e të zhvillohet më tej mendimi ekonomik i trashëguar nga figurat kryesore të Rilindjes, si dhe zgjidhja e detyrave me karakter ekonomik të shtruara prej tyre.

Midis problemeve ekonomike që janë trajtuar në shtypin e kohës duke ecur në gjurmët e traditës së krijuar nga mendimi ekonomik i rilindasve më të shquar, një vend të rëndësishëm vazhdojnë të zenë probleme të tilla jetike për fatet e pavarësisë e të vendit, si zhvillimi i industrisë, i bujqësisë, i transportit e tregtisë, krijimi i bankave e shoqërive aksionare, qëndrimi ndaj kapitalit të huaj dhe shumë probleme të tjera. Për të gjitha këto çështje që shtrohen për t'u zgjidhur në prag të pavarësisë, mendimi ekonomik paraqitet gjithnjë e më shumë me fizionomi më të qartë; ai fillon të dalë më në pah si mendim më vete, me koncepte, nocione e terminologji më të saktë nga pikëpamja teorike e praktike. Në këtë kuptim ai shënon edhe një hap të ri cilësor përpara në krahasim me të kaluarën.

Pas Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare, në kapërcyell të saj dhe në vitet që e përcollën, çështja e pavarësisë ekonomike si komponent i pavarësisë politike merr përmasa më të gjera e mprehtësi më të madhe. Aspiratat e rilindasve dhe të demokratëve revolucionarë të kohës që ecnin me besnikëri në gjurmët e tyre si, Fan Noli, Bajram Curri, Luigj Gurakuqi, Avni Rustemi etj. për një Shqipëri me të vërtetë të lirë, të pavarur e sovrane po bënë për vete gjithnjë e më shumë masat punonjëse të vendit, politikën dhe veprimtarinë e shtetit të porsalindur shqiptar.

Por dihet se që në hapat e parë pas Shpalljes së Pavarësisë, as masave punonjëse dhe as shtetit të ri shqiptar nuk u buzëqeshi aspak fati, sepse kur ata filluan të angazhohen në luftën e punën për përparimin e ekonomisë kombëtare dhe mbrojtjen e interesave të atdheut nga synimet e kapitalit të huaj, mbi kokën e tyre ranë rrebeshe të reja që duheshin përballuar me vendosmëri e trimëri. Posa shpërtheu e gjersa mbaroi Lufta e Parë Botërore, Shqipëria u pushtua nga fuqi imperialiste e fqinje dhe trualli i saj u bë shesh betejash i ushtrive të huaja ndërluftuese, duke krijuar kështu një rrezik të madh e imediat për ekzistencën e pavarësisë së sapofituruar dhe shtetit e ri të porsalindur.

Kur pushtuesit e huaj u dëbuan dhe shteti shqiptar u rimëkëmb, para vendit u shtrua përsëri si detyrë e ngutshme numër një, forcimi i pavarësisë politike dhe përparimi i ekonomisë kombëtare si rrugë magjistrale për të arritur edhe në pavarësinë ekonomike. Në kontekstin e zgjidhjes së kësaj detyre luftoi e u zhvillua edhe mendimi ekonomik shqiptar në periudhën që shtrihet gjër në fund të viteve 30-të.

Është një fakt i njohur se ndërkohë që vendi dhe populli po i përvisheshin punës paqësore për rimëkëmbjen e ekonomisë e nxjerrjen e saj nga prapambetja, në drejtim të Shqipërisë ishte sulur me projektet e veta

konkrete kapitali i huaj monopolist italian, francez, anglez dhe amerikan. Ai përpiquej të siguronte të drejtën e koncesioneve për kërkimin e shfrytëzimin e pasurive natyrore, të vajgurit e të mineraleve të dobishme, të pyjeve, të tokave bujqësore, të tregtisë e të transportit, të tregut, të monedhës e të kreditit etj. Projektet për marrjen e këtyre koncesioneve, që synonin zotërimin e këtyre të ekonomisë shqiptare, u bënë një element shumë i rëndësishëm i «politikës shqiptare» të fuqive imperialiste. Marrja apo mosmarrja e tyre ka përcaktuar në një shkallë të madhe edhe qëndrimin që kanë mbajtur fuqitë imperialiste ndaj Shqipërisë, ndaj shtetit dhe qeverisë shqiptare. Problemi i koncesioneve ekonomike të mirëfillta për fuqitë e huaja kapitaliste, e kishte kapërtëyer si në një rrjetë merimange tërë jetën politike, ekonomike e shoqërore të Shqipërisë në atë kohë,⁵ duke e kërcënuar atë me kriza qeveritare të herëpashershme dhe me turbullira të brendshme që nxiteshin nga forcat e jashtme të interesuara. Në këto kushte, sikurse shkruante në atë kohë një gazetë e huaj e njohur, jeta shqiptare ishte e «qullur në mënyrë të dukshme me vajguri».⁶ Sulmi i kapitalit të huaj në drejtim të Shqipërisë për marrjen e koncesioneve, që do t'i jepnin atij mundësinë të shtrohej këmbëkryq në sofrën shqiptare, përkoj me kohën kur edhe lëvizja demokratike shqiptare ishte në zhvillim dhe ecte në ngritje, drejt apogjeut të saj.

Në parlamentin shqiptar të asaj kohe, në gjirin e të cilit ishte krijuar një opozitë e fortë demokratike, në rrethet demokratike e në shtypin përparimtar të vendit,

5) Gazeta «Drita» e Gjirokastrës, në kryeartikullin e saj me titull «Rreth zgjedhjeve», shkruante: «Politika petroliane, dorë për dorë me interesat që i imponojnë Shqipërisë një mbret me anën e feudalëve po vepron energjikisht... Populli duhet të mos votojë feudalët, që i kanë pirë gjakun dhe që sot përpiqen të na udhëheqin atje ku i drejton politikë e mbreto-vajgurit». Nr. 149, dt. 6.12.1923.

6) «New-York Herald Tribune». Citohet sipas gazetës «Liria Kombëtare», nr. 42, dt. 12.1.1927.

Qarqet demokratike të borgjezisë kombëtare, ndonëse brenda caqeve të kufizuara stabilitetin financiar e të monedhës së vendit e konceptonin të kushtëzuar e të lidhur ngushtë me zhvillimin e pavarur të vetë ekonomisë shqiptare, ata nuk munguan të pohonin se pa zhvillimin e ekonomisë nuk mund të arrihej as shëndoshja e gjendjes financiare të vendit. Kështu Fan S. Noli në një prej debatet e tjerë merret pasi të jenë krijuar burime pasurije të brendshme». ¹⁶ Rreth kësaj çështjeje tërheq vemendjen edhe një artikull i gazetës «Ora e maleve», që polemizonte me holandezin Hunger, në atë kohë këshilltar financiar pranë qeverisë shqiptare, për mënyrat dhe rrugët e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë. Ndërsa Hungeri thoshte se duheshin ndrequr më parë financat, artikulli i gazetës në fjalë, përkundrazi, thoshte se më parë duhej ndrequr ekonomia e mbi këtë bazë të ndreqeshin financat. «Zverdhimi i fytyrës nuk shkon pa u shëndoshë lëngata e përmbrendshme që e shkakton». ¹⁷ Fan S. Noli e Luigj Gurakuqi kërkuan dhënien e një huaje e të një ndihme financiare për Shqipërinë nga ana e Lidhjes së Kombeve. Por ata u zhgënjyen shumë shpejt dhe stigmatizuan premtimet boshe të kësaj organizate, sepse një ndihmë e tillë nuk u realizua.

Në mendimin dhe qëndrimin e tyre ndaj problemeve ekonomike e financiare të vendit, të sovranitetit, të lirisë e të pavarësisë së tij qarqet demokratike shqiptare kanë pasur edhe lëkundje e nuk kanë qenë kurdoherë konsekuente. Kjo ka lidhje të ngushtë me pozitën e tyre klasore, me heterogjenitetin dhe me interesat e klasës që kanë përfaqësuar, me kufizimin e tyre botëkuptimor e politik. Këto qarqe si jashtë parlamentit dhe në gjirin e tij, dhe pastaj kur erdhën në fuqi me Revolucionin demokratiko-borgjez të Qershorit 1924, duke qenë mbrojtëse të lirisë e të pavarësisë ekonomike e politike të atdheut,

16) Gaz. «Shqiptari i Amerikës», dt. 28.10.1922.

17) Gaz. «Ora e maleve», dt. 23.1.1924.

kundërshtuan, diku me forcë e diku me më pak forcë, ndërhyrjen e fuqive dhe të monopoleve të huaja në punët e brendshme të Shqipërisë. Ato kundërshtuan, sidomos dhënien e koncesioneve kapitalit të huaj, në dëm të interesave kombëtare. Megjithëse ishin për përkrahjen e kapitalit kombëtar, ato nuk u shprehën kategorikisht kundër hyrjes së kapitalit të huaj në Shqipëri. Në këtë rast ato kërkuan që koncesionet, sikurse thoshte shprehimisht në shkrimet dhe në ligjëratat e tij Luigj Gurakuqi, të «jepeshin në qark të ligjës e të arësyes». Është shumë domethënë fakti se gjatë periudhës kur lëvizja demokratike ishte në ngritje dhe kur ajo erdhi në pushtet e përfaqësuar nga qeveria e Fan S. Nolit, nuk u dha asnjë koncesion për monopolet e huaja kapitaliste dhe nuk u ratifikua traktati i tregtisë dhe i lundrimit ndërmjet Shqipërisë e Italisë, i përfunduar nga qeveria shqiptare e Ahmet Zogut dhe ajo italiane e Musolinit, më 20 janar 1924.

Nga gjysma e dytë e viteve 20 e sidomos në fillim e gjatë viteve 30 të shekullit tonë, mendimi politiko-shoqëror përparimtar shqiptar dhe veprimtaria që e shoqëroi atë njohu maja të reja, më të larta. Me krijimin e grupeve komuniste në disa qytete të Shqipërisë, filluan të propagandoheshin e të përhapeshin në masat punonjëse të popullit idetë komuniste, idetë e Revolucionit të madh socialist të Tetorit, të bolshevizmit në Shqipëri, gjë që nxiti e frymëzoi organizimin e zhvillimin e lëvizjes punëtore, të grevave, protestave, demonstratave e të kryengritjeve të armatosura të popullit punonjës. Idetë e komunizmit shkencor, idetë e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit në këtë kohë ishin bërë e po bëheshin një aspiratë e zjarrtë e klasës punëtore dhe e masave të tjera punonjëse, një program frymëzues e udhërrëfyes për sigurimin e pavarësisë politike dhe arritjen edhe të pavarësisë ekonomike.

Edhe pse në mendimin ekonomik shqiptar për pavarësinë ekonomike ka pasur luftë pikëpamjesh që shprehin interesa të ndryshme klasore, edhe pse në të nuk mungojnë boshllëqe, të meta, lëkundje dhe inkosekuenca të karakterit teorik e praktik, prania dhe zhvillimi i tij në periudhën e Pavarësisë, ishte një hap i rëndësishëm në rrjedhën e gjatë që do të përshkonte procesi historik, gjersa pavarësia e vërtetë e Shqipërisë të arrihej në kushtet e reja që krijoi fitorja e revolucionit, vendosja e pushtetit popullor dhe futja e vendit në rrugën e zhvillimit socialist.

Meritat historike të të gjithë atyre që kontribuan për krijimin e një mendimi ekonomik shqiptar lidhur me pavarësinë, ne i çmojmë dhe i përfshijmë në thesarin e kulturës së popullit tonë, jo në bazë të asaj që ata nuk dhanë në krahasim me kërkesat dhe detyrat e sotme, por në bazë të asaj që ata kanë dhënë në krahasim me kërkesat dhe detyrat që shtronte koha e tyre.

Megjithëse qysh nga koha kur u shprehën mendimet e para për pavarësinë ekonomike të vendit ka kaluar më tepër se një shekull, ato ruajnë vlerën e tyre edhe sot e kësaj dite, dhe kanë një tingëllim aktual të fuqishëm. E themi këtë sepse në konceptin e përgjithshëm të tyre ne gjejmë të shkrirë e të identifikuar në një të vetme çështjen kombëtare me çështjen sociale të popullit shqiptar, pavarësinë politike me pavarësinë ekonomike, domosdoshmërinë e zhvillimit të ekonomisë me mundësitë reale të brendshme materiale e njerëzore të vendit.

Sot tërë idetë e dëshirat e patriotëve demokratë revolucionarë janë bërë një realitet i gjallë, i prekshëm, në përmasa shumë më të mëdha e më të thella, me një themel e përmbytje botëkuptimore, politike, ekonomike e klasore krejtësisht të re. Partia e Punës e Shqipërisë, që është trashëgimtarja e mishëruesja më e denjë e traditave patriotike, demokratike e revolucionare të popullit tonë, ka

meritën e madhe historike se parashikimet e kërkesat më të guximshme të së kaluarës, i ka vënë në jetë me besnikëri e vazhdimësi të palëkundur.

Në epokën e socializmit Shqipëria, nën udhëheqjen e Partisë me Enver Hoxhën në krye, e ndryshoi kryekëput pamjen e saj të dikurshme të prapambetur, të mjerruar e të skamur dhe është bërë një vend plotësisht i lirë, sovran e i pavarur nga pikëpamja politike dhe ekonomike që ecën kurdoherë përpara, në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore, duke iu përmbajtur parimit të madh revolucionar të mbështetjes në forcat e veta.

KRISTAQ PRIFTI

UNITETI KOMBËTAR DHE PAVARËSIA

1. Lufta për bashkimin e popullit shqiptar, të formuar si një bashkësi etnike gjatë shekujve të historisë së tij, në një territor të përcaktuar, bashkësi e mbështetur, krahas njësisë gjuhësore e kulturore, edhe në atë ekonomiko-shoqërore dhe themelimi mbi këtë bazë i shtetit kombëtar shqiptar, përbëjnë një nga aspektet më të rëndësishme të Rilindjes.

Rruga e popullit shqiptar drejt bashkimit kombëtar dhe formimit të një shteti të pavarur pati pa dyshim veçoritë e veta, në krahasim me vendet e tjera të Ballkanit dhe të Evropës, të kushtëzuara nga rrethanat historike, ekonomiko-shoqërore dhe nga ato politike, të brendshme e të jashtme. Megjithatë, shoqëria shqiptare në fillimin e shek. XIX, krahas ndryshimeve, kishte mjaft gjëra të përbashkëta me shtetet ballkanike fqinje dhe arriti të krijonte, ndonëse me vështirësi e ritme të ngadalshme, që ishin karakteristike për vendet nën sundimin osman, të gjitha premiset, të cilat çuan në formimin e kombit shqiptar dhe në lindjen e lëvizjes për çlirimin e bashkimin kombëtar.

E trajtuar si një domosdoshmëri objektive, nga rea-

lizimi i së cilës do të varej sukcesi i luftës për çlirimin nga sundimi osman e për ruajtjen e tërësisë territoriale të atdheut, ideja e unitetit politik dhe luftarak të popullit shqiptar u përpunua nga iluministët tanë të shquar gjatë gjithë Rilindjes, u vu në qendër të kësaj epoke dhe u bë pjesë e pandarë e platformës politike të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Mendimet e para për bashkimin e gjithë shqiptarëve pa dallim feje e krahine u dhanë nga pionierët e Rilindjes sonë, Naum Veqilharxhi, Kostandin Kristoforidhi, Zef Jubani, Jeronim de Rada, Thimi Mitkoja etj. Ato u pasuruan më tej në zjarrin e kryengritjeve popullore që mbushën epokën e Rilindjes, e sidomos në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-1881), u pasqyruan në mënyrë më të plotë dhe konsekuente në një literaturë të tërë politike dhe artistike, në dhjetëra memorandume e protesta që iu dërguan Portës së Lartë e Fuqive të Mëdha gjatë gjithë Rilindjes deri në Shpalljen e Pavarësisë e në vitet e para të ekzistencës së shtetit shqiptar.

Çështjen e bashkimit kombëtar rilindësit e shtrojnë jo vetëm me pasionin e zjarrtë të atdhetarit, por edhe si dijetarë të shquar. Konceptet e tyre për kombin shqiptar dhe për rolin e unitetit kombëtar, të mbështetura në argumente historike, etnike, gjuhësore, gjeografike dhe ekonomike, ishin të drejta dhe i përgjigjeshin realitetit shqiptar, të cilin ata e njihnin aq mirë. Evokimi i epokës së Skënderbeut shërbente si shembull i shkëlqyer i forcës që u jepte shqiptarëve bashkimi përpara armiqve. Pashko Vasa shkruante më 1879 se sukcesi i qëndresës, që shqiptarët u bënë pushtuesve osmanë në shek. XV, i kishte rrënjët në bashkimin e tyre rreth një ideje patriotike, «se pikërisht në atë kohë u lidh bashkimi shqiptar i kryesuar nga Skënderbeu».¹ Naim Frashëri u përcillte shqiptarëve «amanetin» e Skënderbeut me vargjet «... po të ini të bashkuar,/ është e bërë Shqipëria».²

1) P Wasa, *La vérité sur l'Albanie et les Albanais*. Paris, 1879, f. 40-41.

2) N. H. Frashëri, *Historia e Skënderbeut*, Tiranë, 1953, f. 341.

Si dëshmi të unitetit të shqiptarëve rilindësit përdorën gjuhën e përbashkët shqipe, e cila përbën tiparin më thelbësor të kombit, pikën qendrore që bashkonte gjithë shqiptarët pa dallim krahine, feje e klase shoqërore. Thimi Mitkoja i konsideronte shqiptarët vëllezër e të bashkuar, sepse flisnin të njëjtën gjuhë, gjuhën e bukur shqipe, sepse kishin të njëjtin atdhe, Shqipërinë. Po këtë ide mbronin Samiu dhe rilindësit e tjerë kur shkruanin se pa gjuhë shqipe nuk mund të ketë shqiptarë dhe Shqipëri, se nga ruajtja dhe lëvrimi i saj varet jo vetëm bashkimi i shqiptarëve, por edhe jeta apo shuarja e kombit shqiptar. Mbi gjuhën e përbashkët shqipe, të cilën e vlerësonte si «pronën më të madhe e më të plotë të afrimit», kërkonte të hidhte themelet e bashkimit të shqiptarëve edhe Jani Vreto.³ Gjuhën shqipe, vendosjen e një alfabeti të njëjtë, që nisi me miratimin e alfabetit të Stambollit më 1879 e u krye me vendimet e Kongresit të Manastirit të 1908-ës, lëvrimin e gjuhës në literaturë dhe përhapjen e shkollave amtare, rilindësit nuk i shikonin thjesht si çështje kulture, por edhe në rrafshin politik, si mjete të fuqishme propagandistike e veprime patriotike që do të ndihmonin për unitetin e kombit shqiptar.

Përvoja e luftës shekullore të popullit shqiptar dhe ajo e epokës së Rilindjes tregoi se uniteti kombëtar nuk mund të arrihej pa një organizim të shëndoshë. Nevoja e organizimit u bë edhe më e ngutshme për shkak të gjendjes së rëndë dhe tepër të rrezikshme që u krijua për Shqipërinë me shpërthimin e luftës ruso-turke të 1877-1878-ës dhe me nënshkrimin e Traktatit të Shën Stefanit dhe atij të Berlinit më 1878, të cilat parashikonin copëtimin e trojeve shqiptare midis monarkive ballkanike, synonin të zhduknin nga harta e Ballkanit kombin shqiptar. Në këto rrethana, kur ekzistonin edhe premiset e brendshme për vendosjen e një uniteti politik e luftarak të popullit shqiptar, me përpjekjet e atdhetarëve rilindës, të kryesuar nga Abdyl Frashëri, Omer Prizreni, Sulejman Vokshi, Zi-

3) «Bashkimi», Shkodër, nr. 6, 6 shkurt 1910.

ja Prishtina, Pashko Vasa etj., u themelua, më 10 qershor të vitit 1878, Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Lindi kështu ajo organizatë politike-ushtarake mbarëshqiptare, e cila kreu detyrën historike që shtronte koha, krijoi një bashkim të vërtetë të popullit shqiptar, të mbështetur në luftën e përbashkët të të gjitha forcave patriotike të vendit për çlirimin kombëtar të shqiptarëve dhe ruajtjen e tërësisë së trojeve të tyre. Bashkimi në Lidhje i të gjithë shqiptarëve, gegë e toskë, myslimanë e të krishterë, përforcohej edhe me një strukturë të qartë organizative. Komiteti Qendror, që e kishte selinë në Prizren, nëpërmjet një rrjete të tërë degësh e komitetesh, të krijuara në qytetet e ndryshme të vendit, mbante lidhje me të gjitha viset e Shqipërisë, bashkërendonte veprimtarinë e popullit shqiptar drejt një qëllimi të vetëm.

Kombi shqiptar, ashtu si edhe bashkimi e kompaktësia me të cilën veproi në vitet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-1881), nuk mund të lindnin papritur e as të krijoheshin artificialisht. Ato i kishin rrënjët në ndërgjegjen e përbashkët kombëtare të popullit, të formuar prej kohësh në valën e kryengritjeve kundërosmane, ndërgjegje që në vitet e Krizës Lindore të 1875-1881-it, «në çastet kur rrezikohej ekzistenca e Shqipërisë»,⁴ shpërtheu si vullkan që vlonte prej shekujsh e nxori në sipërfaqe lavën e zjarrtë. Ky shpërthim i revoltës së një kombi unik, të cilit po i mohoheshin vetëqenia dhe të drejtat politike, i ishte nxjerrë në ankand pasuria më e çmuar, trualli amtari, ndihet i fuqishëm në protestat e shumta që, në emër të atdheut, «tanimë të bashkuar nga ideja kombëtare», në emër «të interesave të mbarë Shqipërisë»,⁵ iu dërguan, në të njëjtën kohë, Kongresit të Berlinit e Portës së Lartë nga qendra të ndryshme të vendit. Kjo ndihej gjithashtu në krismat e armëve të popullit kryengritës, i cili mbrohej me forca të përbashkëta kundër sunduesve os-

4) *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912*, Përgatitur nga St. Pollo - S. Pulaha. Tiranë, 1978, dok. 40, 34.

5) *Po aty*, dok. 63, 65.

manë dhe pushtuesve të rinj ballkanas. Lufta e forcave të Lidhjes për mbrojtjen e Plavës, të Gucisë, Hotit, Grudës dhe Ulqinit, si edhe gjithë veprimtaria e saj diplomatike për paprekshmërinë e kufijve të Veriut e të Jugut, që zgjati 3 vjet të tëra (1878-1881), u shndërrua në një çështje të përgjithshme kombëtare. «Pikërisht pse ideja e unitetit u përgjigjej interesave më të larta të atdheut dhe përfaqësonte aspiratat e masave më të gjera, — thekson shoku Ramiz Alia, — pse përfaqësonte armën më të fuqishme e më të sigurt që populli shqiptar mund t'u kundërvinte armiqve, shpërthyen ato akte të mëdha solidariteti dhe ai heroizëm masiv që deri atëhere nuk kishte njohur Shqipëria».⁶

Atdhetarët rilindës, duke kundërshtuar vendimet e Kongresit të Berlinit (1878) për copëtimin e trojeve amtare midis monarkive ballkanase, luftuan njëherazi për afirmimin kombëtar të shqiptarëve në Evropë. Për këtë, ata vunë përballë opinionit evropian provën më të fuqishme, unitetin e shqiptarëve, argumentuan me të dhëna bindëse se populli shqiptar përbën një komb krejt të veçantë e të bashkuar, «një komb të njësuar për nga raca (nënkupto: nga origjina), gjuha, traditat, historia dhe për nga gjithë elementët që përbëjnë identitetin kombëtar», «komb që ka vullnetin e tij të përbashkët».⁷ Këtë ide ua shprehu Abdyl Frashëri përfaqësuesve të qeverisë franceze në Paris, në pranverën e vitit 1879, kur theksoi se «para lakmive të egra të fqinjëve të tyre dhe rreziqeve që u kërcënohen, shqiptarët janë të bashkuar të gjithë me një betim solemn që me përpjekje të përbashkëta të ruajnë... atdheun, kombësinë dhe gjuhën e tyre».⁸

Faktin që shqiptarët ishin një komb i bashkuar, që kërkonte të respektohej edhe ndaj tij parimi i kombësisë, e gjejmë edhe në mendimet e atyre personaliteteve

6) Ramiz Alia, *Lidhja Shqiptare e Prizrenit, faqe e ndritur e historisë sonë e shkruar me gjak*. Tiranë, 1978, f. 25-26.

7) *Akte të Rilindjes...*, dok. 12, 42.

8) *Po aty*, dok. 43.

evropiane që e njihnin më mirë dhe nga afër gjendjen në Shqipëri. Po përmendim relacionin e kryekonsullit austriak në Shkodër Lippih (Lippich), dërguar Vjenës më 3 prill 1880, në të cilin e quante «kreyt të gabuar e në kundërshtim me të vërtetën» pretendimin e italianit Sonino, që kishte shpallur se shqiptarët «janë një grumbull fisesh të palidhura me njëri-tjetrin», «Në ç'radhë e vë Soninoja popullsinë e Shkodrës, të Lezhës, Tiranës, Ulqinit, Gjakovës, Pejës, Tetovës, Dibërës, Elbasanit, Kavajës e qyteteve të tjera? Edhe këta kanë të njëjtën kombësi. Jo vetëm Soninoja, por askush tjetër s'do të mund të mohojë kombësinë e shqiptarëve»⁹, shkruante Lippih në relacionin e tij.

Mendimi për unitetin kombëtar të popullit shqiptar u përpunua më tej në veprimtarinë krijuese të rilindësve, që veprouan në fundin e shek. XIX e në fillimin e shek. XX, e sidomos të ideologut të shquar Sami Frashërit, i cili i dha atij një kuptim më të gjerë e më të plotë. Përgjithësimi i përvojës së veprimtarisë trevjeçare të Lidhjes së Prizrenit për bashkimin e vendit e çoi atë në përfundimin se «Shqipëria duhet të jetë një dhe e pandarë», se «të gjithë shqiptarët duan të quhen vëllezër dhe djemtë e një mëmëdheu të dashur».¹⁰ Në traktatin politik «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të bëhet?» (1899) Samiu e trajton bashkimin kombëtar të shqiptarëve si mendimtar revolucionar, — me bindjen se ai mund të arrihej vetëm me anë të organizimit dhe të luftës politike e të armatosur. Shqiptarët, theksonte ai, s'kanë nevojë të bëjnë gjë tjetër veçse «të bashkohen të gjithë sa janë dhe të kërkojnë të drejtat e tyre nga Turqia dhe Evropa. Turqia... do t'u japë ato që kërkojnë me hir a me pahir». Në qoftë se shqiptarët do të arrinin të vendosnin një lidhje të fortë e do të bashkoheshin të gjithë si një njeri i vetëm, arsyetonte Samiu, atëherë nuk do të gjendej

9) Xh. Belegu, *Lidhja e Prizrenit e veprimet e saj (1878-1881)*. Tiranë, 1939, f. 88.

10) *Arkivi Qendror i RPS të Shqipërisë* (më tej AQSh), Fondi 51, dos. 4. S. Frashëri i shkruan J. de Radës, më 20 shkurt 1881.

forcë që të guxonte t'u kundërvihet Shqipërisë dhe shqiptarëve.¹¹

Ideja e bashkimit të të gjithë shqiptarëve myslimanë e të krishterë, gegë e toskë, zotëron në vendimet dhe veprimtarinë e Lidhjes së Pejës (1899-1900) e sidomos në thirrjen «Rruga e shpëtimit është në Besa-Besën!», që përbën aktin e saj kryesor programatik. Duke ecur në rruqën e çelur nga Lidhja e Prizrenit, atdhetarët rilindës luftuan që «bashkimi i krijuar nga Lidhja e Pejës të përfshinte gjithë shqiptarët, gegë e toskë, myslimanë e të krishterë», të ngrihej mbi dasitë fetare e krahinore, për t'u provuar armiqve se shqiptarët janë një komb unik, zotër të atdheut të vet dhe të aftë për ta vetëqeverisur atë. «Ajo që do ta shpëtojë kombin e atdheun tonë, — theksohej në këtë Thirrje, — është bashkimi, një Besëlidhje e përgjithshme, një Besa-Besë».¹²

Të bashkuar e në një front unik në shkallë kombëtare dolën shqiptarët përballë sunduesve osmanë gjatë kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912. Dëshmi e unitetit dhe e bashkërendimit të veprimeve të tyre ishte si angazhimi pothuajse i të gjitha viseve të Shqipërisë në luftën e armatosur popullore që u zhvillua në një kohë, në prill-gusht 1912, në mbarë vendin, ashtu edhe kërkesat e njëjta programatike, që u shprehën në vendimet e Kuvendit të Përgjithshëm Shqiptar të Junikut, të majit 1912 dhe në ato të memorandumit të Sinjës (Berat) të 23 korriku 1912 që doli nga mbledhja e përfaqësuesve të Shqipërisë së Jugut. Atdhetarët rilindës, me të drejtë, shihnin në to «bashkimin e vullnetin e tërë shqiptarëve», pa dallim feje e krahine, për ta futur vendin në rrugën e qytetërimit. «Ne, — thuhej në një nga thirrjet që kryengritësit u drejtonin shteteve evropiane, — shkojmë drejt luftës dhe vdekjes për këtë ideal të shenjtë, pa dallim fe-

11) S. Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet?* Bukuresht, 1899. Tiranë, 1962, f. 66.

12) AQS. Fondi 12, dos. 1. *Rruga e shpëtimit është në Besa-Besën.*

je; një fe shumë e lartë, që i kalon të gjitha, na vëllazëron, na frymëzon, na nxit, na udhëheq: ringjallja e atdheut tonë, bashkimi dhe liria».¹³

2. Bashkimi kombëtar i popullit shqiptar nuk mund të kuptohej pa unitetin territorial, një nga komponentët më të domosdoshëm për ekzistencën e kombit, pa themelin mbi të cilin shqiptarët do të ngrinin shtetin e pavarur dhe do t'i siguronin kombit të tyre një zhvillim të plotë dhe unitar. Ky bashkim do të arrihej duke kapërcyer ndarjen e trojeve shqiptare në katër vilajete, të vendosur nga Porta e Lartë, si edhe dallimet krahinore midis Gegërisë e Toskërisë e trevave të tjera më të vogla, të trashëguara nga thellësitë e shekujve e që mbaheshin gjallë nga pushtuesit dhe nga pashallarët e bajraktarët vendas për të penguar unitetin politik të shqiptarëve, për t'i copëtuar e për t'i nënshtruar ata. Në këtë ndarje administrative rilindësit shikonin vazhdimin e parimit të lashtë të pushtuesve «përçaj e sundo!», të cilit, sikurse shprehej Pashko Vasa, «tanimë i ka kaluar koha, sepse rryma e shek. XIX i shtyn popujt drejt bashkimit».¹⁴

Lufta për njësimin e tokave shqiptare u ndërthur në mendimin politik të rilindësve me përpunimin e një koncepti të drejtë mbi këto territore. Në argumentimin e përkatësisë kombëtare të trojeve shqiptare ata mbështeteshin në radhë të parë në të dhënat etnike, në faktin që shqiptarët përbënin shumicën e popullsisë në këto toka dhe banonin atje në mënyrë kompakte. Abdyl Frashëri, ndonëse mbronte me argumente të gjithanshme historike, etnike, gjuhësore, ekonomike dhe ushtarake-strategjike tërësinë e Shqipërisë, e vinte theksin në gjuhën shqipe, që ishte tipari i përbashkët dhe një nga më kryesorët e kombit. «Gjuha e banorëve të Shqipërisë, — shkruante Abdyli, — është shqipja, dhe banorët e saj janë shqiptarë qysh prej kohëve të lashta».¹⁵ Ky kon-

13) *Akte të Rilindjes...*, dok. 154.

14) P. Vasa, *vep. e përm.*, f. 96.

15) «Basiret», Istanbul, nr. 2416, 7/19 prill 1878.

cept i rilindësve për Shqipërinë, si atdheu i përbashkët i shqiptarëve, i një popullsie që fliste të njëjtën gjuhë, pavarësisht nga dallimet fetare e ndarja administrative në katër vilajete, ishte një koncept i drejtë, shkencor, i cili që vënë në themel të formimit të shteteve kombëtare në Ballkan e në tërë Evropën. Këtë parim mbronte F. Engelsi, kur shkruante se «kufijtë e vërtetë natyrorë janë ata që përcaktohen nga gjuha dhe simpatia e përbashkët».¹⁶

Për Rilindjen Kombëtare Shqiptare, si dhe për historiografinë tonë të sotme, janë krejtësisht të huaja synimet që u atribuohen nga disa studiues të sotëm të tipit të Dimitrije Bogdanoviçit, i cili, duke i dhënë tezës mbi origjinën ilire të shqiptarëve një interpretim krejt të falsifikuar e subjektiv, përpiket të bindë opinionin publik se, sipas kësaj teze, konsiderohen si shqiptare të gjitha territoret e banuara dikur nga ilirët, ku në shek. XIX jetonin popuj të tjerë. Ai shikon në pikëpamjen për origjinën ilire të shqiptarëve përpjekjen, e imagjinuar prej tij, për ta kthyer Ballkanin, madje edhe Evropën, shumë shekuj prapa, në periudhën e dyndjeve të fiseve sllave, në shek. VI.¹⁷ Si dijetarë, rilindësit i referoheshin edhe historisë, sillnin të dhëna për të drejtat historike të shqiptarëve mbi trojet amtare, për të mbrojtur paprekshmërinë e tyre, por duke i shtrirë këto të drejta vetëm në ato territore, në të cilat banonin në shek. XIX, si pasardhës të ilirëve, si një popull autokton e jo i vendosur si rrjedhojë e «dyndjeve të mëvonshme të fiseve shqiptare dhe e shpërnguljes së popullsive sllave», sikurse pohohet në historiografinë e vjetër dhe të sotme jugosllave. Jo për shkak të ndonjë ekskluziviteti kombëtar, por për hir të kushteve, në të cilat i vendosi historia, shqiptarët, sikurse shprehej edhe Abdyl Frashëri, nuk kishin ushqyer asnjëherë aspirata pushtuese ndaj popujve të tjerë.¹⁸

16) K.Marks-F.Engels. *Veprat*, vëll. 13, 1959, f. 281.

17) D. Bogdanović, *Knjiga o Kosovu*, Beograd, 1985, f. 16.

18) «Basiret», Istanbul, nr. 2416, 7/19 prill 1878.

Ndonëse ishin të ndërgjegjshëm që e ardhmja e Shqipërisë garantohej me formimin e një shteti të pavarur, përballë rrezikut të copëtimit, «të zhdukjes së ekzistencës kombëtare dhe politike të vendit»,¹⁹ i cili u qëndronte mbi krye shqiptarëve si «shpata e Damokleut», atdhetarët rilindës veçuan si një detyrë tepër të ngutshme dhe imperative bashkimin e viseve shqiptare, kërkuan nga Porta e Lartë «që vendi i quajtur Shqipëri të bashkohej në një tërësi dhe të formonte një vilajet të vetëm».²⁰ Ata e shikonin këtë si një kërkesë minimale, të përkohshme, si një qëndrim taktik të imponuar nga politika e Portës së Lartë dhe e Fuqive të Mëdha që kundërshtonin autonominë e Shqipërisë. Në këtë çështje ushtroi ndikimin e vet edhe bindja e udhëheqësve të lëvizjes sonë kombëtare për ta përdorur bashkimin e trojeve shqiptare në një vilajet, si një shkallëz, si një fazë tranzitore, për të kaluar më pas në shpalljen e tij si një njësi shtetërore autonome shqiptare.

Pikërisht pse çonte në rrjedhime të tilla, bashkimin e viseve shqiptare në një vilajet të vetëm e gjejmë edhe në mendimin politik e në veprimtarinë praktike të mendimtarëve të tillë me pikëpamje radikale, si Pashko Vasa, Abdyl Frashëri, Sami Frashëri, si edhe në vetë aktet e Rilindjes. Abdyl Frashëri, që njihej si luftëtari më i vendosur për autonominë, madje edhe për shkëputjen e plotë të Shqipërisë nga Perandoria Osmane, në memorandum min që i dërgoi sultanit, më 13 tetor 1880 (kur, siç shprehej ai, «flotat e Gjashtë Fuqive të Mëdha, si zhgaba shqyese, sulmuan një qytet të vogël si Ulqini»), u detyrua të kufizohej me një masë të tillë shumë të ngutshme, të domosdoshme dhe nga më të rëndësishmet, siç ishte «bashkimi i Shqipërisë në një vilajet të vetëm, me emrin «vilajeti i Shqipërisë»». Udhëheqësi i lëvizjes kombëtare e vlerësonte këtë si një nga mjetet që do «t'u priste rrugën lakmive të shteteve fqinje», lakmi që nxiteshin edhe

19) A. Frashëri, *Letër nga Janina*, «Basirët», Istanbul, nr. 2416, 7/19, prill 1878.

20) *Akte të Rilindjes...*, dok. 52.

nga «ndarja e Shqipërisë në katër vilajete», ku, krahas shqiptarëve, që përbënin shumicën e popullsisë së tyre, kishte edhe pakica sllave e greke, si «një masë që do të mbronte e do të siguronte tërësinë e Shqipërisë në kua-drin e Perandorisë Osmane». Në kushtet e atëhershme tepër të ndërlikuara ndërkombëtare, Abdyl i quante atë kritike gjendjen e Shqipërisë dhe atë real rrezikun që kërcënonte tërësinë e trojeve të saj e vetëqenien e shqiptarëve si komb, saqë u detyrua në këtë memorandum t'u bënte lëshime koncepteve të veta radikale për zgjidhjen e çështjes shqiptare. «Le të mos i jepet Shqipërisë asnjë privilegj ose formë administrative e veçantë, — i shkruante Abdyli sulltanit. — Le të administrohet ajo sipas ligjeve, me të cilat administrohen vilajetet e tjerë perandorake. Mjafton që të katër vilajetet të bashkohen në një vilajet të vetëm».²¹ Këtë kërkesë Abdyl Frashëri ia paraqiti sulltanit si një aspiratë të mbarë popullit shqiptar.

Ideja e bashkimit të viseve shqiptare në një vilajet të vetëm përshkon memorandumet dhe peticionet që iu dërguan Fuqive të Mëdha dhe Portës së Lartë në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX deri në shpalljen e Pavarësisë. Ajo paraqitet në dy forma: së pari, si kërkesë e veçantë, që u shtrua sidomos në periudhat e ndërhyrjeve më të ashpra të Fuqive të Mëdha dhe të monarkive ballkanike, dhe, së dyti, si pjesë e platformës autonomiste të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në memorandumet e peticionet e shumta, e sidomos në ato të kryengritjeve të mëdha të viteve 1910-1912. Në të dyja rastet bashkimi i viseve shqiptare do t'i nënshtrohej, sikurse shprehëj Sami Frashëri, qëllimit kryesor të shqiptarëve: ruajtjes së tërësisë territoriale të Shqipërisë, të gjuhës dhe të kombësisë shqiptare dhe formimit të një shteti autonom kombëtar.²²

21) Promemorja e A. Frashërit, parashtruar sulltanit, 13 tetor 1880. Bashbakanllik Arshivi, Istanbul, Yildiz Eşas Evrakı, Kisim 14, Evrak nr. 2239.

22) S. Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë...*, f. 59.

3. Ekzistencën e shqiptarëve si një komb i vetëm dhe të drejtën e tyre për të pasur shtetin e vet të pavarur nuk mund t'i vinte në pikëpyetje ndarja e tyre në tri besime fetare, në atë mysliman, të cilit i përkiste shumica dërrmuese e popullsisë së vendit, në atë ortodoks e në katolik. Megjithatë, në kushtet e atëhershme, kur Porta e Lartë dhe Patrikana greke e Stambollit u mohonin shqiptarëve kombësinë, vinin shenjën e barazimit midis fesë dhe kombësisë, duke i quajtur shqiptarët myslimanë turq, ortodoksët grekë dhe katolikët latinë, besimet e ndryshme ushtrorin ndikimin negativ në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.

Në rrethana të tilla, bashkimi kombëtar i popullit shqiptar dhe organizimi i tij në një shtet të pavarur nuk mund të arriheshin pa atë luftë të vendosur që atdhetarët rilindës zhvilluan kundër reaksionit klerikal të të tri besimeve, e cila i dha Rilindjes Shqiptare një tipar të veçantë, e bëri të dallohet nga lëvizjet kombëtare të shteteve fqinje. Ndryshe nga vendet e tjera të Ballkanit, ku borgjezia, për shkak se popullsia i përkiste të njëjtit besim fetar, e përdori kishën si armë ideologjike në luftën për çlirimin kombëtar dhe më pas për të përmbushur lakmitë e saj pushtuese, në Shqipëri kleri ishte një faktor negativ, siç shprehej F. Noli, «një vegël politike» në duart e të huajve, që punonte për t'i përçarë e për t'i asimiluar shqiptarët, dhe frenonte kështu bashkimin e tyre kombëtar. Ishte meritë e veçantë e rilindësve, që e vlerësuan drejt këtë rol reaksionar të klerit, që kuptuan se për të arritur bashkimin e shqiptarëve, aq të nevojshëm për çlirimin e tyre kombëtar, duhej të kapërceheshin dastitë fetare dhe të shkëputeshin masat nga ndikimi përçarës i klerikëve të të tri besimeve. «Te bashkimi pa dallim feje dhe krahine, — shkruante shoku Enver Hoxha, — ata shihnin bazën e vetme të luftës për çlirimin e Shqipërisë».²³

Një luftë e tillë nuk mund të zhvillohej nga pozitë e ateizmit, ngaqë pjesa më e madhe e rilindësve ishin

23) Enver Hoxha, *Vepra*, vëll. 24. Tiranë, 1977, f. 10.

vetë besimtarë dhe në kushtet e prapambetjes ekonomike e kulturore të vendit, kur feja kishte lëshuar rrënjë në ndërgjegjen e njerëzve, populli ynë, sikurse theksonin me të drejtë atdhetarët më të përparuar, nuk kishte arrihur deri në atë shkallë sa t'i mërzhitej feja dhe t'i shporrte priftërinjtë e hoxhallarët jashtë vendit.²⁴ Megjithatë, me qëndresën kundër reaksionit klerikal, iluministët e vendosën Rilindjen Kombëtare Shqiptare në një platformë më të përparuar, në parimin e kombësisë, të shqiptarisë, që bashkonte gjithë popullin tonë, pa dallim feje. Nocioni i «shqiptarisë si feja e shqiptarit», që përshkon një literaturë të tërë politike dhe artistike të Rilindjes sonë, ishte afetar, një nocion politik që synonte bashkimin e shqiptarëve pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare.²⁵

Ideologjisë reaksionare të panislamizmit, panortodoksizmit etj., që kishte gjetur mbështetje edhe në disa qarqe çifligare e borgjeze turkomane e grekomane dhe që identifikonte fenë me kombësinë, rilindësit i kundërvunë racionalizmin e tyre, konceptin mbi kombin shqiptar si një kategori e veçantë, që ishte një dhe i pandarë, megjithëse u takonte tri besimeve fetare. «Shqiptari është shqiptar para se të jetë mysliman a i krishterë», — shkruante Sami Frashëri.²⁶ Mendimtarët rilindës i mbaheshin pikëpamjes se kombësia dhe feja nuk janë e njëjta gjë, se ato përfaqësojnë dy kategori të ndryshme shoqërore dhe nuk mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën. Ata luftuan kundër propagandës kalifatiste të sulltanëve osmanë dhe asaj nanheleniste të Patrikanës greke, që ngrinin «besimin fetar në parim kombësie dhe zëvendësonin racën (kupto: kombësinë) me dogmë, ritin me atdhe, që ishte krejt e papranueshme». Nuk janë as myslimanizmi, as krishteri-

24) «Shqipëria», Magaga (Egjipt), nr. 4, 5 maj 1907. *Për orthodhoksët*.

25) St. Pollo. *Mbi disa tipare dalluese themelore të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare*, në: «Studime historike». Tiranë, 1970, nr. 3, f. 121.

26) S. Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë...*, f. 39.

mi, — arsyetoni rilindësit, — ata që formojnë popujt, kombet, por gjuha, doket, zakonet e karakteristikat e tjerë që i dallojnë kombësitë nga njëra-tjetra.²⁷ Pas propagandës panhelënistë që identifikonte krishterimin me helëlizmin dhe i quante grekë shqiptarët ortodoksë, sepse kishin besim të përbashkët me ta, rilindësit shihnin rivendikimet e qarqeve të caktuara politike ndaj popullsisë shqiptare dhe trojeve të saj.

Këto ishin pikëpamje përparimtare dhe, ndonëse të parashtruara pothuajse një shekull më parë, mbeten gjithnjë të freskëta, shërbejnë si dëshmi për të kundërshtuar si konceptet antishqiptare të atyre «studiuesve» të huaj, të cilët ndarjen e shqiptarëve në tri fe e interpretonin si ndarje «në tri grupe», për çdo njërin nga të cilët feja na paska qenë «një flamur kombëtar», ashtu edhe shtrembërimet që propaganda e ndonjë vendi fqinjë, duke ringjallur konceptet mesjetare kalifatiste dhe patriarkiste, i bën në ditët tona gjendjes së sotme të kombit shqiptar.

Përpyekjeve të jashtëzakonshme të rilindësve u kush-tohet ai bashkim politik i popullit shqiptar, pa dallim feje e krahine, që u realizua në vitet e Lidhjes së Prizrenit (1878-1881) dhe u ruajt gjatë gjithë Rilindjes. Vendimet e Lidhjes dhe gjithë veprimtaria e saj, vinte në dukje Sami Frashëri më 1878, «ishin frymëzuar nga patriotizmi, atdhedashuria... dhe mbështeteshin në parimin e kombësisë dhe jo në fanatizmin fetar».²⁸ Ky bashkim i shqiptarëve të të tri besimeve ishte rrënjësor thellë në ndër-gjegjen e kombit shqiptar, ishte një e vërtetë e pohuar edhe në dokumentacionin e huaj bashkëkohës. Në relacionet që funksionarët e administratës osmane në Shqipëri i dërgonin Portës së Lartë pranohej se midis myslimanëve shqiptarë, që përbënin shumicën e popullsisë, dhe të krishterëve ekzistonte një bashkim me tradita të lashta e që i ka

27) P. Wasa, *vep. e përm.*, f. 56. Shih edhe: «I foni tes Alvanias», 13 tetor 1879 dhe 19 janar 1880.

28) «Terxhuman-i Shark», 17/10 qershor 1878, nr. 81, f. 3.

qëndruar kohës, se ky unitet do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Këtë bashkim të shqiptarëve të të tri besimeve funksionarët osmanë ua atribuonin devotshmërisë kombëtare dhe patriotizmit të shqiptarëve, të cilët, siç theksonin ata, ishin aq të fortë, saqë ndryshimet në fe nuk mund t'i dobësonin aspak.²⁹

Është i njohur kontributi që dha në luftën kundër reaksionit klerikal për bashkimin kombëtar të popullit shqiptar një brez i tërë atdhetarësh demokratë, në fundin e shek. XIX dhe në fillimin e shek. XX, i përbërë nga Jani Vruho, Shahin Kolonja, Fan Noli, Aleksandër Drenova, Anton Zako Çajupi, Aleksandër Xhuvani, Hilë Mosi, Nikolla Ivanaj, Petro Nini Luarasi, Bajram e Çerçiz Topulli, Dervish Hima, Mihal Grameno etj., të cilët, duke ecur në hullinë e hapur nga Lidhja e Prizrenit dhe themeluesit e saj, demaskuan në dhjetëra artikuj, botuar në shtypin patriotik të kohës, veprimtarinë përçarëse të klerit të të tri besimeve. Në pikëpamjet dhe veprimtarinë e tyre, lufta kundër dasive fetare, të mbjella nga kleri, zinte një vend po aq të rëndësishëm sa edhe qëndresa kundër sunduesve osmanë dhe armiqve të tjerë të jashtëm. Klerin ata e shihnin si një armik po aq të rrezikshëm sa edhe Perandorinë Osmane.³⁰

Lufta e gjithanshme e rilindësve për demaskimin e reaksionit klerikal ishte një faktor i rëndësishëm politik në lëvizjen kombëtare, që dha frytet e tij në forcimin e unitetit të popullit shqiptar. Ndonëse i shkaktuan pengesa Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, sunduesit osmanë dhe fuqitë e tjera të huaja, përballë forcës së bashkimit të shqiptarëve, nuk arritën t'i përçajnë e t'i hedhin ata në luftë me njëri-tjetrin. Sikurse vinte në dukje me kënaqësi Pashko Vasa, ndërmjet shqiptarëve myslimanë dhe atyre të krishterë nuk ka pasur kurrë «cmirë të rrënjosur as edhe armiqësi shekullore», se «ndryshimet fetare s'kanë qenë

29) *Lidhja Shqiptare e Prizrenit në dokumentet osmane 1878-1881*. Përgatitur nga K. Prifti. Tiranë, 1978, dok. 40.

30) «Kombi», Boston, nr. 58, 25 tetor 1907.

shkak për t'i shtytur në përçarje».³¹ Është një e vërtetë e provuar historikisht, që nuk i ka shpëtuar vështrimit të Sami Frashërit, se shqiptarët «nuk kanë njohur ato grindje, luftëra fetare, masakra të mëdha e të tmerrshme që kanë ndodhur» jo vetëm në vendet e Lindjes, por edhe «në vende të qytetëruara të Evropës».³²

Mungesa e një fanatizmi të tillë fetar, që Jani Vreto në Apollogjinë e vet ua atribuonte shqiptarëve të të gjitha besimeve e sidomos atyre myslimanë,³³ zotërimi tek ata i ndjenjës kombëtare mbi atë fetare, përbënin për rilindësit, dhe jo vetëm për ta, por edhe për lëvizjen demokratike-revolucionare dhe nacionalçlirimtare që u zhvillua më pas në vendin tonë, një truall të përshtatshëm për bashkimin e të gjitha forcave të kombit shqiptar në luftën për çlirimin kombëtar dhe mbrojtjen e pavarësisë së vendit. Ky faktor, si edhe kontributi që dhanë rilindësit në luftën kundër reaksionit klerikal të tri besimeve do të ushtronin ndikimin e vet, kuptohet si një premisë ndihmëse, përkrah atij revolucioni ideologjik, kulturor e tekniko-shkencor, që u realizua nga PPSH pas çlirimit të vendit, në formimin e brezave të tërë, madje edhe të një populli ateist, çka përbën, në planin shoqëror e ideologjik, një nga arritjet e pashoqe të shekullit tonë.

4. Shpallja e Pavarësisë dhe formimi i shtetit kombëtar më 28 nëntor 1912 përbën një ngjarje të shënuar që do të mbetet e paharruar në historinë e kombit tonë, jo vetëm për nga rrjedhimet që pati për të ardhmen e atdheut, por edhe për forcën e bashkimit politik të shqiptarëve përballë pushtuesve të rinj e tepër të rrezikshëm ballkanas. Ajo ishte vepër e mbarë popullit shqiptar dhe e qindra atdhetarëve që vepronin në gjirin e tij. Në emër «të të gjithë popullit, myslimanë e të krishterë», «në emër të të gjithë Shqipërisë dhe kombit shqiptar», shpalli Pavarësinë, më 25-28 nëntor 1912, nën grykën e pushkëve dhe

31) P. Wasa, *vep. e përm.*, f. 91.

32) S. Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë...*, f. 45-46.

33) J. Vreto, *Vepra të zgjedhura*. Tiranë, 1973, f. 225.

të topave të ushtrive pushtuese, popullsia e Elbasanit, Tiranës, Durrësit, Peqinit, Lushnjës dhe e qyteteve të tjera.³⁴

Vetë Kuvendi i Vlorës, që shpalli pavarësinë dhe formoi Qeverinë e Përkohshme, si nga përbërja e tij ashtu edhe nga vendimet që mori, kishte një karakter mbarëshqiptar, shprehu aspiratat shekullore të të gjithë kombit për t'u bashkuar në shtetin e vet kombëtar. Pjesëmarrja në të e delegatëve nga të gjitha qytetet e Shqipërisë, duke përfshirë edhe ato që ishin pushtuar nga ushtritë serbe, malazeze e greke, i dha këtij Kuvendi karakterin e një Asambleje Kombëtare mbarëshqiptare. Kjo ishte njëherazi dëshmi e vendosmërisë së të gjithë shqiptarëve për të formuar një shtet unik, në të cilin të përfshiheshin të gjitha viset e banuara prej tyre. Këtë vendosmëri shqiptarët e Kosovës, të Dibrës e të viseve të tjera, të udhëhequr nga një bërthamë unike ushtarako-politike të përbërë nga Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri, Idriz Seferi, Sali Gjuka, Ramadan Zaskoci etj., e shprehën jo vetëm me delegatët që dërguan në Kuvendin e Vlorës, por edhe me qëndresën e pashembullt që u bënë kudo, në Podujevë, Llap, Ibër, Kumanovë, Gjakovë, Prishtinë, Lumë e qendra të tjera, ushtrive serbomalazeze, të cilat u dyndën në trojet shqiptare. Këto nuk ishin beteja thjesht lokale, për mbrojtjen e qyteteve të Kosovës, por një qëndresë që bëhej për ruajtjen e tërësisë së gjithë truallit shqiptar ose, siç shpreheshin atdhetarët kosovarë në deklaratën dërguar Fuqive të Mëdha në tetor 1912, për «t'i dalë zot tërësisë tokësore të Shqipërisë», «për t'i parë trojet shqiptare të bashkuara, me një formë të qeverisuri e sundimi politik».³⁵

E parë nga pikëpamja e kontributit që dha në bashkimin kombëtar të popullit shqiptar, qeveria e I. Qemalit ze një vend të rëndësishëm në historinë e popullit tonë. Me krijimin e saj dhe të vetë shtetit kombëtar, shqiptarët siguruan atë qendër udhëheqëse që u kishte munguar prej

34) *Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj*. Tiranë, 1963, dok. 3, 6-9, 11, 13.

35) *Akte të Rilindjes...*, dok. 169.

rreth pesë shekujsh, e cila, siç shprehej shtypi patriotik, «do të bashkonte nën flamurin e Shqipërisë gjithë popullin shqiptar».³⁶ Ndonëse nuk pati jetë të gjatë, Qeveria e Vlorës dhe forcat patriotike që u grumbulluan rreth saj, zhvilluan një veprimtari të dendur, dolën të bashkuara si brenda vendit, ashtu dhe në rrafsh ndërkombëtar, kundrejt lakmiye pushtuese të monarkive fqinje dhe vendimeve të padrejta të Konferencës së Ambasadorëve që u mbajt në Londër më 1912-1913. Qeveria e Përkohshme i kundërshtoi vendimet e Konferencës së Londrës, sepse ato binin ndesh me aspiratat e ligjshme të shqiptarëve, të cilët, siç theksohej në deklaratat e kësaj Qeverie, si «grupimi etnik më kompakt dhe më homogjen në Gadishullin Ballkanik,» kishin të drejtë të formonin shtetin e tyre të bashkuar kombëtar, sepse ato vendime nuk merrnin parasysh parimin e kombësisë, por e zëvendësonin atë me «të drejtën e luftës e të pushtuesit».

Në viset e pushtuara nga ushtritë serbe protesta kundër vendimeve të padrejta të Konferencës së Londrës u shoqërua me kryengritjen kundër zgjedhës serbo-malazeze që shpërtheu në Dibër në shtator të vitit 1913, u shtri gjatë muajit tetor në Ohër, Strugë, Tetovë, në Malësinë e Gjakovës, në Prizren e në vise të tjera të Kosovës. Në thirrjen drejtuar Fuqive të Mëdha, më 15 tetor 1913, kryengritësit dibranë e kosovarë ngritën zërin kundër krimeve të ushtrisë serbo-malazeze, që mbyti në gjak fshatrat shqiptare, i ktheu ato në krematoriume, ku u dogjën për së gjalli qindra gra e foshnje, dhe kërkoi nga Evropa si mjet shpëtimi «t'u jepte të drejtën të rronin të lirë në atdheun e tyre të njëshëm».³⁷ Kryengritja e shtatorit të vitit 1913 ishte shkëndia e parë e asaj lëvizjeje masive nacionalçlirimtare që do të zhvillohej, në vitet 1918-1925, në Kosovë e në

36) A. Puto, *Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914*. Tiranë, 1978, f. 126-127. «Liri e Shqipërisë», Sofje, 22.7.1913.

37) *Qeveria e Përkohshme e Vlorës...*, dok. 322. Shih edhe D. Tucoviç, *Serbia dhe Shqipëria*. Prishtinë, 1968, f. 82-84.

viset e tjera të aneksuara nga Jugosllavia, nën drejtimin e Komitetit «Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës».

Lufta e popullit tonë për mbrojtjen e tërësisë territoriale të vendit dhe për bashkimin kombëtar nuk ka cenuar kurrë ndonjëherë të drejtat e popujve të tjerë të Ballkanit. I. Qemali dhe atdhetarët shqiptarë i quanin të ligjshme aspiratat e popujve të tjerë të Ballkanit për të çliruar bashkatdhetarët e tyre nga sundimi i Perandorisë Osmane dhe për të siguruar bashkimin e plotë kombëtar. Por ata nuk mund të pranonin që kjo luftë të bëhej në dëm të shqiptarëve, duke penguar bashkimin e tyre kombëtar dhe duke gjymtuar rëndë trojet e popullsinë e tyre, duke masakruar e shpërngulur nga vatrata amtare qindra mijëra shqiptarë. «Zgjidhje» të tilla të çështjes kombëtare në Ballkan, të cilat mbrohen e përlegjen edhe nga historiografia e sotme e vendeve fqinje, u imponuan, sikurse theksonte V. I. Lenini, nga «interesat e borgjezisë» dhe interesat «dinastike» të monarkive ballkanase, si edhe nga borgjezia reaksionare, imperialiste e Evropës që «nxit shovinizmin dhe armiqësinë kombëtare»³⁸ midis popujve.

Ishin Serbia dhe monarkitë e tjera ballkanike fqinje ato që pa u kënaqur me cungimin e rëndë që u bënë trojeve shqiptare në Konferencën e Londrës, më 1913, u orvatën me forca ushtarake e mjete diplomatike të likuidonin qysh në embrion shtetin e pavarur shqiptar. Një sintezë të politikës së Serbisë dhe të Jugosllavisë që u krijua më pas, e cila i përshtatet edhe qëndrimin të monarkive të tjera ballkanike, ka dhënë funksionari i Ministrisë së Jashtme të Jugosllavisë, Ivan Vukotiči, në raportin, dërguar qeverisë së tij në vitin 1939. «Ne, — shkruante ky, — asnjëherë nuk kemi pasur simpati për ta (për shqiptarët)... Në kombinacionet tona politike dhe diplomatike, si edhe në politikën tonë Ballkanike, ne vazhdimisht kemi synuar të luftojmë të gjitha kërkesat shqiptare për krijimin e shtetit të pavarur, thjesht për arsye se ky shtet mund të

38) V. I. Lenini, *Veprat*, vëll. 19, Tiranë, 1957, f. 21.

themelohej vetëm kundër nesh dhe kundër synimeve tona kombëtare.»³⁹

Rreziku i copëtimit përfundimtar të kombit tonë, i zhdukjes së shtetit të pavarur shqiptar, që u shfaq me gjithë forcën gjatë Luftës së Parë Botërore, e sidomos në punimet e Konferencës së Paqes të Parisit, të viteve 1919-1920, mund të kapërcehej vetëm në qoftë se shqiptarët do të dilnin para saj si një popull i bashkuar e kompakt me qeverinë e tyre, e cila do ta përfaqësonte zyrtarisht shtetin shqiptar. Marrëveshja që arritën në këtë Konferencë, më 13-14 janar 1920, përfaqësuesit e Anglisë, të Francës e të Italisë për copëtimin e Shqipërisë midis Italisë, Greqisë e Jugosllavisë, sipas klauzolave të Traktatit të Londrës të 26 prillit të vitit 1915, shkaktoi një shqetësim të madh e të ligjshëm në mbarë popullin shqiptar, i dha një shtysë të re e të fuqishme forcave të ndryshme shoqërore të vendit që të afroheshin me njëra-tjetrën, të forconin unitetin politik dhe të thërrisnin në janar të vitit 1920 Kongesin e Lushnjës. Ky ishte një kuvend mbarëshqiptar, siç thuhet në dokumentet e tij, fryt i «përfundimit të një marrëveshjeje të përgjithshme të të gjitha viseve të Shqipërisë», që mori përsipër detyrën e «forcimit të bashkimit e vëllazërimit ndërmjet shqiptarëve, për të siguruar vetëqeverimin e plotë të Shqipërisë dhe unitetin e gjithë shqiptarëve».⁴⁰ Ajo që karakterizoi Kongresin e Lushnjës dhe Qeverinë Kombëtare të Sulejman Delvinës, ishte bashkimi rreth saj i të gjitha forcave patriotike të popullit dhe i trojeve shqiptare. «Asnjëherë në historinë e vet, — deklaronte në ato ditë Aqif pashë Elbasani, — kombi shqiptar nuk ka qenë i bashkuar si

39) B. Krizman, *Studim i dr. Ivo Andriçit mbi Shqipërinë në vitin 1939*, në «Časopis za Sovremenu Povijest», Godina IX, Zagreb, 1977, nr. 2 (24), f. 81.

40) *Lufta e popullit shqiptar për çlirimin kombëtar 1918-1920*, (Përmbledhje dokumentesh). Përgatitur nga M. Çami etj. Tiranë, 1976, vëll. II, dok. 1.

është sot, me një dëshirë të patundur që të ketë qeverinë e vet, pas formulës «Shqipëria për shqiptarët»».41

Në një kohë me përpjekjet që bëri në rrafsh ndër-kombëtar, pranë Konferencës së Paqes së Parisit, kundër traktativave për copëtimin e Shqipërisë midis tri shteteve fqinje dhe për pavarësinë e plotë të vendit, qeveria e re, e vendosur në Tiranë në shkurt të vitit 1920, vazhdoi me konsekuencë veprën e nisur nga Ismail Qemali, bashkoi njëra pas tjetrës viset e ndryshme të vendit. Por u desh të çlirohej edhe Vlora me krahinën përreth, që kishte mbetur ende nën pushtimin italian, të derdhej gjaku i qindra luftëtarëve të tjerë që të kryhej vepra e bashkimit kombëtar. Lufta për çlirimin e Vlorës ka hyrë në historinë e Shqipërisë si një epike e lavdishme, në të cilën u shfaq me tërë madhësitinë e saj forca e unitetit të popullit shqiptar për mbrojtjen e tërësisë dhe të pavarësisë së atdheut. Shtypi shqiptar shkruante në ato ditë se «Lufta e Vlorës është një çështje e përbashkët e lidhur me jetën e Shqipërisë».42 Në betejat e përgjakshme e të pabarabarta që u zhvilluan në qershor-korrik të vitit 1920 kundër një ushtrie të shumtë në numër e të armatosur deri në dhëmbë, në Drashovicë, në Kotë, në Kabinë, në Gjorm, Llogara, Tepelenë e brenda në Vlorë, bashkë me fshatarët e qytetarët e këtyre viseve që përbënin bërthamën kryesore të forcave shqiptare, ishte përfshirë një komb i tërë, e gjithë Shqipëria, mijëra vullnetarë nga të gjitha anët e vendit, jo vetëm nga krahinat e afërta të Beratit e Gjirokastrës, por edhe nga Tirana, Elbasani, Korça, Peqini, Kavaja, Shijaku, Kruja, Mati, Dibra, Gramshi etj.43 Ishin kompaktësia, uniteti i veprimit, guximi, patriotizmi i zjarrtë, që populli shqiptar shfaqti në luftën e armatosur të Vlorës, ata faktorë që bënë të pavlefshëm Traktatin famëkeq të Londrës të 26 prillit 1915, si edhe projektet antishqiptare të Konferencës së

41) *Po aty*, vëll II, dok. 89.

42) «Populli», Shkodër 17.7.1919. «Drita», Gjirokastrë, 16.6.1920 dhe 31.7.1920.

43) *Lufta e popullit shqiptar...*, vëll. II, dok. 323.

Paqes, ata faktorë që ruajtën shtetin e pavarur të bashkuar shqiptar në kufijtë e vitit 1913.

*
*
*

Ndonëse i takojnë një periudhe disi të largët, këto përpjekje të atdhetarëve shqiptarë për bashkimin kombëtar mbajnë gjithnjë një theks aktual. Me jehonën që rezatuan në periudhat pasardhëse, me gjurmët e pashlyeshme që lanë në mendimin politik dhe në veprimtarinë praktike të lëvizjes demokratike e asaj revolucionare të mëvonshme, ato përbëjnë një trashëgimi të vyer, e cila, sikurse thekson shoku Enver Hoxha, «kaloi brez pas brezi si një mësim e testament i madh»,⁴⁴ që historia e kaluar i la së tashmes e së ardhmes së popullit tonë.

44) Enver Hoxha. *Kur u hodhën themelët e Shqipërisë së re*. Tiranë, 1984, f. 11.

KRISTO FRASHËRI

FORCAT SHOQËRORE DHE PAVARËSIA KOMBËTARE

Roli që luajtën forcat shoqërore shqiptare në Shpalljen e Pavarësisë Kombëtare të Shqipërisë është i lidhur, si problem historiografik, me çështjen se kush e pati përparësinë, faktori i brendshëm apo faktori i jashtëm, në ngjarjen historike të vitit 1912. Historiografia shqiptare ka pohuar vazhdimisht, qysh para Çlirimit, se shteti shqiptar i pavarur ishte vepër e forcave shoqërore të brendshme dhe jo krijesë e diplomacisë së Fuqive të Mëdha. Megjithatë, historianët shqiptarë të Paraçlirimit e trajtuan rolin e forcave shoqërore të marrë në tërësi. Ky ishte hapi i parë drejt vlerësimit shkencor të saj, por hap i pamjaftueshëm.

Pas Çlirimit, historianët shqiptarë e argumentuan më tej rolin e faktorit të brendshëm në Shpalljen e Pavarësisë Kombëtare. Madje, ata vunë në dukje se bartësit kryesorë të lëvizjes kombëtare rilindëse dhe, për pasojë, farkëtarët kryesorë të Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare qenë masat e gjera popullore dhe jo qarqet bejlero-çifligare, siç kanë pretenduar në të kaluarën disa historianë, të cilët nuk e mohonin rolin vendimtar të faktorit të

brendshëm. Teza e argumentuar e historiografisë së sotme shqiptare ka kohë që ka fituar qytetarinë shkencore edhe në historiografinë ndërkombëtare. Megjithatë, ka ende disa historianë të izoluar, kryesisht në Jugosllavi, të cilët vazhdojnë ta nënvlerësojnë rolin aktiv që luajtën forcat e brendshme shoqërore në përmbysjen politike të vitit 1912 dhe të përsërisin tezën, tashmë të perënduar, sipas së cilës shteti shqiptar i pavarur ishte krijesë artificiale e diplomacisë evropiane apo pjellë e Austro-Hungarisë, e cila ua imponoi vullnetin e saj kancelarive të tjera të mëdha.

Historiografia shqiptare e ditëve tona nuk e ka për detyrë që të merret me teza, të cilat e kanë humbur prej kohësh kredinë shkencore dhe të cilat ringjallen vetëm në saje të motiveve politike të caktuara. Sot detyra e saj është ta thellojë studimin analitik mbi strukturën klasore që sundonte në Shqipëri rreth vitit 1912 dhe të ndriçojë rolin që luajtën forcat e saj shoqërore të marra veç e veç, në pavarësinë kombëtare, për të kuptuar zhvillimin e mëtejshëm të shtetit të ri shqiptar.

*
* *

Struktura shoqërore e Shqipërisë në dhjetëvjeçarët që paraprinë Shpalljen e Pavarësisë Kombëtare, ishte tepër komplekse. Forcat shoqërore, të marra në tërësi, përbënin një unitet, por edhe një diversitet. Komponentët e saj kishin interesa të përbashkëta, por edhe interesa të veçanta, pika që i bashkonin, por edhe pika që i ndanin, dialektikën e ekuilibrit, por edhe unitetin e të kundërtave. Si rrjedhim, roli që ato luajtën si bartëse të proceseve ekonomike dhe shoqërore apo kontributi që ato dhanë si pjesëmarrëse të lëvizjes politike dhe ideologjike, që çoi në Shpalljen e Pavarësisë Kombëtare, nuk ishte i njëjtë. Si njëra, ashtu edhe tjetra ishin në varësi me vendin që ato zinin në kostelacionin e shoqërisë shqiptare, me fun-

ksionin që ato kryenin në jetën politike të Shqipërisë dhe me peshën që ato kishin në sistemin e kontradiktave të vendit me Perandorinë Osmane.

Gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit të sundimit osman, baza ekonomike e rendit feudal — tesarrufi i spahiut — ishte aboluar prej kohësh, qysh më 1832. Vendin e tesarrufit e kishte zënë prona private mbi tokën, me të gjitha prerogativat e pronës tokësore borgjeze. Edhe në qytet, disiplina esnafore, e cila mbante nën zgjedhë feudale prodhimin zejtar, ishte shturrur. Me këto ndryshime, ishin hequr barrierat mesjetare që pengonin zhvillimin e lirë të ekonomisë së tregut dhe rritjen e shpejtë të punishteve kapitaliste.

Por në Perandorinë Osmane, kalimi nga prona feudale në pronën borgjeze, nuk ndodhi nga poshtë, por nga lart. Si rrjedhim klasa sunduese nuk e përmbysi, por e ruajti superstrukturën shtetërore feudale, të cilën e pajisi me arna borgjeze. Por, me gjithë arnat tanzimatiste, superstruktura shtetërore feudale dhe përqendrimi i pushtetit qendror perandorak në duart e klasës sunduese osmane krijuan në Shqipëri, një asfiksi të theksuar për format kapitaliste të ekonomisë. Asfiksinë e shkaktonte në radhë të parë administrata e degjeneruar perandorake me plogështinë e strukturës shtetërore, arbitraritetin e hallkave administrative dhe korrupsionin e aparatit burokratik, të cilat mbytnin që në hapat e parë çdo nismë për investime kapitale në fushën e industrisë dhe të bujqësisë. Atë e keqësonte politika parazitare buxhetore që ndiqte Porta e Lartë ndaj provincave, me anën e së cilës ajo tërhoqte nga Shqipëria në Stamboll, nëpërmjet fiskut, me miliona groshë në vit, kurse këtu nuk kryente asnjë investim që t'i shërbente ekonomisë së vendit por shpenzonte vetëm një të tretën e tyre, aq sa duheshin për të nërballuar mbajtjen e administratës lokale. Asfiksinë e thellonte më tej politika e dyerve të hapura që ndiqte Porta në fushën e tregtisë ndaj fuqive perëndimore. e cila e rriti importin në përpjesëtime më të mëdha se eksportin shqiptar, afërsisht në raport 3 me 1, rrjedhimisht e shtoi më tej varfërimin e pasurisë monetare që kryente

Porta me anën e fiskut, në dëm të zhvillimit të forcave prodhuese kapitaliste.

Si pasojë e këtyre faktorëve të marrë bashkërisht, vendin e mbërtheu amullia e përgjithshme. Punishtet kapitaliste që filluan të ngriheshin me nismën e reshperëve të mëdhenj apo të bejlerëve çifligarë. qysh gjatë viteve '60 dhe '70 të shekullit të kaluar, hynë në krizë. Amullia vazhdoi deri në fund të sundimit osman. Shqipëria mbeti, deri në Shpalljen e Pavarësisë, një vend me superstrukturë feudale, por pa bazë ekonomike feudale dhe, në të njëjtën kohë, një vend me ligje ekonomike të tregut, por pa njësirë ekonomike kapitaliste.

Nga ky gërshetim marrëdhëniesh shoqërore, Shqipëria pati, në pragun e Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare një strukturë klasore komplekse. Si në katet e larta, ashtu dhe në shtresat e ulëta të popullsisë, gërshetoheshin forcat shoqërore të trashëguara nga rendi feudal-ushtarak, disa të degraduara, disa të transformuara, me forcat e reja shoqërore të lindura nga zhvillimi i marrëdhënieve kapitaliste, por që ende nuk ishin konsoliduar si forca politike aktive.

Në katet e larta të shoqërisë shqiptare ekzistonin ende, kryesisht në viset e brendshme malore, pasardhësit e derebejve të kohës së timareve apo «bejlurçinat» siç cilësohen në shtypin e kohës, të cilët nuk kishin arritur të krijojnë, si bejlerët e fushave dhe të luginave, prona çifligare. Por ndonëse e kishin humbur prej kohësh tesarrufin mbi tokën e fshatarit, bejlurçinat qëndronin ende, në sajë të përkrahjes politike që u jepte pushteti perandorak osman, në radhët e klasës sunduese perandorake. Si rrjedhim, Shqipëria ende nuk ishte çliruar nga këto forca klasore të degraduara, thellësisht parazitare, që nuk kishin lidhje me asnjë nga sektorët e ekonomisë së vendit, por që jetonin jashtë kohës së tyre, duke zhvatur me dhunë, me anën e reparteve personale, rentën feudale nga fshatarët pronarë të krahinave të tyre, pa gëzuar tesarrufin feudal. Për këtë arsye, këta krerë derebej nuk kishin interes të shkëputeshin nga Perandoria Osmane,

as ta ndryshonin regjimin e saj anakronik. Ata përfaqësonin shtresën më reaksionare të vendit.

Përkundrazi, klasa e re që kishte lindur gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit të sundimit osman — borgjezia e prodhimit — ishte, si forcë shoqërore përparimtare për atë kohë, e interesuar që ta ndryshonte superstrukturën shtetërore feudale. Por ajo ishte ende në fillimet e saj dhe nuk çonte peshë në fushën e ekonomisë. Nga mënyra e jetesës, ajo ose ndodhej, ose kishte hyrë në katet e larta të shoqërisë shqiptare. Nga pikëpamja ideologjike ajo e kishte kthyer fytyrën drejt qytetërimit borgjez evropian. Por duke qenë, si forcë shoqërore, tepër e dobët, borgjezia e prodhimit, ende nuk kishte zënë vend, si forcë politike, në radhët e klasës sunduese. Ajo qëndronte në opozitë, por edhe nga kjo pikëpamje lidhjet e saj shoqërore dhe politike me masat popullore ishin aq të pakta, sa ajo nuk kishte filluar ende ta luante rolin e saj historik, si udhëheqëse e Lëvizjes Kombëtare dhe e revolucionit demokratik.

Fitorja e pronës private mbi pronën feudale, fuqizoi kryesisht bejlerët çifligarë, të cilët kishin lindur si klasë qysh në shek. XVII dhe kishin zënë, qysh në shek. XVIII, vendin kryesor në radhët e klasës sunduese shqiptare. Ashtu si më parë, edhe tani, në dhjetëvjeçarët e fundit të sundimit osman, bejlerët çifligarë, disa qindra familje, vazhdonin të ishin, të gjithë me kombësi shqiptare. Në pragun e Shpalljes së Pavarësisë, ata zotëronin bashkërisht rreth 55 për qind të tokave të punueshme. Ata vazhdonin, në përgjithësi, të përdornin në pronat e tyre, format feudale të shfrytëzimit të fshatarëve bujq. Megjithatë, nën ndikimin e ekonomisë së tregut, ata ishin lidhur tashmë me tregun e brendshëm nëpërmjet shitjes dhe blerjes së prodhimeve bujqësore dhe të pronave tokësore, madje, edhe të prirjes për të kryer investime në sferat e ndryshme të ekonomisë së vendit. Bejlerët çifligarë kishin hyrë, kështu, së bashku me çifligarët e rinj jo bejlerë, në rrugën e borgjezimit.

Zhvillimi i shpejtë i ekonomisë monetare në qytet dhe në fshat, brenda dhe jashtë çifligut, fuqizoi në mënyrë

të veçantë bazën ekonomike të borgjezisë reshperë. Me fitimet gjithnjë në rritje që kishte siguruar deri në Shpalljen e Pavarësisë Kombëtare, borgjezia reshperë ishte kthyer në një pronare kapitalesh të konsiderueshme monetare. Por në kushtet e vështira që ishin krijuar për të kryer investime në fushën e prodhimit, pra për t'u kthyer në një borgjezi industriale, ajo ishte pushtuar nga prirja tjetër, e cila e nxiste të kryente investime në sferën tokësore, pra të kthehej në një borgjezi çifligare.

Kështu, prirja që kishte pushtuar pronarët kryesorë të kapitalit tokësor dhe monetar — bejlerët çifligarë për të ushtruar veprimtari tregtare, reshperët e mëdhenj për t'u bërë pronarë çifligarë dhe të dyja kategoritë së bashku për të kryer investime në fushën e prodhimit industrial, i çoi ata në afrimin e këtyre dy bashkudhëtarëve kryesorë të popullsisë shqiptare, në një front të vetëm shoqëror. Kështu u formua aleanca çifligaro-reshperë, e cila përfaqësoi, nga pikëpamja e bazës ekonomike, klasës sunduese në Shqipëri në vitet e fundit të sundimit osman.

Pavarësisht se dy pjesëtarët kryesorë të klasës sunduese shqiptare — çifligarët dhe reshperët — vazhduan ta vilnin mbivlerën kapitaliste me format feudale të shfrytëzimit, në kushtet social-ekonomike të diktuar nga sundimi i huaj ata u vunë në raporte të reja me Perandorinë Osmane dhe me përfaqësuesen e klasës sunduese perandorake, Portën e Lartë.

Para së gjithash, prona e tyre çifligare, e kthyer në pronë private, tani ishte e lidhur me tapinë e tokës, pra nuk ishte e kushtëzuar, si tesarrufi i spahiut, me shërbimin ushtarak. Bejlerët çifligarë të periudhës së fundit të sundimit osman, ishin nga pikëpamja e bazës ekonomike, forca shoqërore të pavarura nga Porta e Lartë. Ata ishin të lidhur politikisht me Perandorinë Osmane, jo se kjo i pajiste, siç ndodhte me spahinjët e dikurshëm, me timare feudale, por se mbronte pronësinë çifligare dhe lehtësonte rritjen e saj. Por nga ana tjetër, bejlerët çifligarë qenë të lidhur edhe me Shqipërinë, mbasi këtu ndodheshin pronat e tyre të patundshme, të cilat i bënë ata të pavarur nga Porta. Madje, lidhja e tyre me Shqi-

përinë u bë më jetike se lidhja me Perandorinë Osmane. Kështu lindën kontradiktat midis klasës sunduese shqiptare dhe klasës sunduese perandorake.

Kontradiktat midis tyre kishin, para së gjithash, karakter ekonomik. Ashtu si borgjezia reshperë, edhe bejlerët çifligarë nuk mund të pajtoheshin me praktikën e grabitjes fiskale dhe me politikën e dyerve të hapura që ndiqte Porta e Lartë, sepse ato nuk e lejonin ekonominë çifligare të rriste të ardhurat, as të shtrihej në krejt pronën e madhe. Përkundrazi, ato e gozhduan ekonominë çifligare në amulli dhe si pasojë e tyre, rreth 70 për qind e pronës çifligare mbeti tokë djerr. Ajo që thuhet për borgjezinë kombëtare se e mësoi patriotizmin në treg, mund të pohohet edhe për bejlerët çifligarë. Interesi që kishin bejlerët çifligarë për të mos u shkëputur nga Perandoria Osmane dhe në të njëjtën kohë për të mbrojtur tregun e brendshëm nga varfërimi i vazhdueshëm, ishte motivi kryesor, i cili i nxiti ata të kërkonin, së bashku me borgjezinë reshperë, bashkimin e trojeve shqiptare në një vilajet të vetëm, të pajisur me disa të drejta autonomiste, të paktën me një gardh financiar kundrejt Portës së Lartë dhe tregut ndërkombëtar.

Kontradiktat midis tyre u shtrinë edhe në sferën kulturore. Dora-dorës me borgjezimin e tyre ekonomik, bejlerët çifligarë hynë në rrugën e borgjezimit kulturor, të cilën e kishin shkelur më parë reshperët e pasur. Nën ndikimin e marrëdhënieve ekonomike gjithnjë në rritje të Shqipërisë me tregjet e Evropës, qarqet reshperë dhe pas tyre qarqet çifligare filluan ta kthenin fytyrën nga kultura perëndimore. Pirja e bejlerëve çifligarë për t'i shkolluar fëmijët e tyre me kulturë laike në shkollat evropiane u duk qysh në vitet '40 të shekullit të kaluar. Procesi i borgjezimit të jetës ekonomike të vendit solli në të njëjtën kohë nevojën për të dalë nga obskurantizmi mesjetar jo vetëm shtresat e larta, por edhe vetë prodhuesit e lidhur me tregun. Rreth mesit të shek. XIX qarqet çifligare-reshperë mendonin se hopi kulturor mund të kryhej duke i arsimuar prodhuesit në gjuhën e sferës së tyre fetare — në turqisht, greqisht ose italisht. Por shko-

limi në gjuhë të veçanta i pjesëtarëve të të njëjtit komb, binte në kundërshtim me interesin që kishin vetë shtresat e larta për të krijuar një formacion administrativ autonom, me një identitet kombëtar të ndryshëm nga ai i Perandorisë Osmane, i monarkive fqinje dhe i shteteve të tjera evropiane. Këtë identitet të veçantë, vilajeti shqiptar do ta fitonte duke i dhënë administratës lokale karakter shqiptar dhe duke e zhvilluar arsimin në gjuhën shqipe. Qarqet çifligare-reshpere, iu kundërvunë kështu, nën ndikimin e platformës rilindëse politikës së osmanizimit që Porta ndiqte në Shqipëri me anën e arimit turqisht.

Në thelb, qarqet çifligare-reshpere nuk kërkonin më tepër se atë që Faik Konica quante «autonomi buxhetore dhe gjuhësore». Por kriza e përgjithshme që po kalonte, Perandoria Osmane, në shek. XIX dhe në fillim të shek. XX nuk mund të mos linte gjurmë në platformën e tyre politike. Sa më tepër tronditeshin themelet e saj, aq më shumë bejlerët çifligarë lidheshin me Shqipërinë, aq më tepër Shqipëria identifikohet si atdheu i tyre i mirëfilltë. Kështu, siç thotë me të drejtë shoku Enver Hoxha, bejlerët shqiptarë kur panë se barka osmane po mbytej, rrëmbyen flamurin e nacionalizmit. Thelbin e këtij nacionalizmi e ka shprehur njëri nga bejlerët çifligarë më të fuqishëm të dhjetëvjeçarëve të fundit të sundimit osman, Abedin Pashë Dino, i cili në një letër që i drejtonte sulltanit më 1879 theksonte, ndër të tjera, se të interesuar më tepër se kushdo, madje edhe se vetë Porta e Lartë, për të shpëtuar trojet shqiptare nga copëtimi, ishin pronarët e tokave. Kush ka tapi, ai e do atdheun — kështu pretendonin bejlerët e borgjezuar në dhjetëvjeçarët e fundit të sundimit osman. Një nga përfaqësuesit e qarqeve çifligare të borgjezuara, e përmblihte më 1900, në këtë mënyrë, platformën e tyre politike: «Lëvizja shqiptare nuk do të ketë karakter separatist. Ajo është një lëvizje thjesht gjuhësore, reformiste dhe vetëmbrojtëse. Ne do të vazhdojmë ta konsiderojmë... ekzistencën e Perandorisë Osmane si kusht për vetëekzistencën tonë: Por ne, — shtonte më tej, — tani e tutje do të punojmë në mënyrë të tillë që nëse

një ditë, për faj të turqve dhe jo për faj tonin, Perandoria Osmane do të shembet, ajo të mos e tërheqë Shqipërinë në këtë shembje».

Forcat shoqërore më të shtypura dhe më të shfrytëzuara të Shqipërisë në pragun e Shpalljes së Pavarësisë ishin prodhuesit e fshatit dhe të qytetit të zhveshur nga mjetet e prodhimit. Pararojën e përbënin shtresat e reja që kishin lindur gjatë shek. XIX — punëtorët e punishteve kapitaliste dhe argatët e fermave çifligare. Megjithatë, masën e formonin ende shtresat e trashëguara nga rendi feudal — bujqit e çifligjeve dhe çirakët e zejtarëve. Por edhe këta, në kushtet kur prodhimi bujqësor dhe zejtar ishte lidhur me tregun, po merrnin përherë e më tepër tiparet e mëditësve të rendit kapitalist. Veçse numri i tyre ishte tepër i kufizuar. Në fshat, ndërsa pronarët çifligarë zotëronin rreth 55 për qind të tokave të punëshme, bujqit dhe argatët e angazhuar në këto toka kishin në përdorim vetëm më pak se një të tretën e tyre dhe përfaqësonin vetëm 16-18 për qind të popullsisë agrare. Po ashtu në qytet, krahët e punës në marrëdhënie ekonomike me borgjezinë shqiptare, përfaqësonin vetëm 12-14 për qind të prodhuesve qytetarë.

Mëditësit e qytetit dhe të fshatit, si prodhues të zhveshur nga mjetet e prodhimit, përfaqësonin, nga pikëpamja shoqërore, forcat më revolucionare të shoqërisë shqiptare. Megjithatë, nga pikëpamja ideologjike, as të parët, as të dytët nuk e kishin fituar ende ndërgjegjen klasore proletare, mbasi të dy palët synonin që një ditë të blinin tokën e nevojshme ose të hapnin punishte më vete dhe të ktheheshin në prodhues të pavarur. Pavarësisht nga iluzionet mikroborgjeze, urrejtja e tyre e përditshme dhe, për pasojë, lufta e tyre e përditshme, drejtohej më tepër kundër pronarit të veçantë, i cili i shtypte dhe i shfrytëzonte për ditë, sesa kundër administratës perandorake osmane, me të cilën kishin fare pak marrëdhënie direkte shfrytëzimi. Lëvizja shoqërore për çlirim nga zgjedha klasore kishte pra, për ta, një forcë tërheqëse më të madhe se lëvizja kombëtare për çlirim nga zgjedha osmane. Si rrjedhim, mëditësit e fshatit dhe të

qytetit nuk qëndronin, nga pikëpamja politike, në pararojë të lëvizjes kombëtare, por vetëm si reparte ndihmëse të saj.

Shumicën dërrmuese të popullsisë së Shqipërisë, rreth 82 për qind të saj, e përbënin fshatarët dhe qytetarët, pronarë të mjeteve të prodhimit, — pronarë të tokës dhe të bagëtisë në fshat, të punishtes apo të dyqanit në qytet. Si prodhues të pavarur ata nuk kishin marrëdhënie direkte ekonomike as me bejlerët çifligarë, as me reshperët e mëdhenj. Përkundrazi, këto forca të konsiderueshme prodhuese, të cilat me potencën e tyre numerike dhe me peshën e tyre ekonomike, i jepnin tonin jetës shoqërore të vendit, ndodheshin prej disa dhjetëvjeçarësh në marrëdhënie direkte shfrytëzimi me administratën perandorake osmane. Pësia e rëndë e taksave shtetërore, korrupsioni i funksionarëve të hallkave administrative, shërbimi i detyrueshëm shumëvjeçar ushtarak, mungesa totale e asistencës sociale, nuk bënin gjë tjetër veçse e thellonin më tej procesin e varfërimit dhe të diferencimit ekonomik dhe shoqëror që po shkaktonin, mbi fshatarët dhe zejtarët luhatjet e theksuara të çmimeve në treg, borxhet e shpeshta me kamatë të rëndë, konkurrenca rrënuese e mallrave të huaja dhe, veç këtyre, praktika e copëzimit të pronës së vogël me anën e trashëgimisë.

Si pasojë e këtij procesi, në periudhën e fundit të sundimit osman u përmbys raporti që sundonte më parë në kostelacionin e forcave shoqërore të fshatit dhe të qytetit. Tani në fshat, epërsinë numerike, si ekonomi bujqësore, nuk e kishin, si më parë, fshatarët e mesëm, por fshatarët e vegjël, të cilët më 1912, përfaqësonin rreth 53 për qind të popullsisë agrare, kurse fshatarët e mesëm tani kishin zbritur në 24 për qind të saj. Veç kësaj mesatarja e pronës së tyre ishte ulur më tej, në 5 dynymë tokë për familje, mbasi një pjesë e mirë e saj kishte rënë në duart e fshatarëve të pasur. Po ashtu në qytet, pak mjeshtra mundën t'i kthenin punishtet e tyre zejtare në punishte manufakturore. Përkundrazi, mjaft prej tyre u kthyen në zejtarë të vegjël.

Si rrjedhim, shtresat mikroborgjeze e ndienin më

tepër se forcat e tjera shoqërore peshën e sundimit osman. Zgjedhën e huaj e ndienin në mënyrë të veçantë fshatarët e vegjël, të cilët me ngastrën e tokës që zotëronin nuk e siguronin dot bukën e vitit për familjet e tyre. Fshatarët e vegjël, të cilët përfaqësonin masën kryesore të forcave prodhuese të vendit jetonin kështu në një varfëri të përherëshme. Ndonëse nga pikëpamja sociale, ishin pronarë të mjeteve të prodhimit, për nga gjendja ekonomike ata ishin, po të përdorim një shprehje të V.I. Leninit, «pronarë të mizerjes». Për këtë masë fshatarësh dhe qytetarësh të vegjël, administrata perandorake osmane ishte, sipas shprehjes së Sami Frashërit, jo një bari, por një ujk. Si rrjedhim, shtresat mikroborgjeze dhe në radhë të parë, fshatarët e vegjël nuk kishin asnjë interes të qëndronin nën zgjedhën e saj. Ato ishin pra, forcat shoqërore më të interesuara për të çliruar atdheun, për të fituar pavarësinë.

Por reagimi i masave fshatare nuk qe kudo njëlloj. Në trevat malore, me marrëdhënie patriarkale ende të pashturrura plotësisht, malësorët e varfër u përpoqën ta lehtësonin peshën e mjerimit duke kundërshtuar pagesën e taksave shtetërore, shërbimin e detyrueshëm ushtarak dhe në përgjithësi, vendosjen e administratës perandorake në viset e tyre. Sikurse dihet, reagimi i malësorëve u shpreh me një varg të gjatë konfliktesh të armatosura, të cilat vazhduan me dhjetëra vjet, të njohura me emrin jo të saktë «kryengritje kundër Tanzimatit» — jo të saktë, sepse malësorët nuk luftuan kundër një reforme, por kundër administratës perandorake që ajo sillte me vete. Ballafaqimi luftarak i malësorëve me Portën kthehej në një ballafaqim politik, kur veprimet luftarake midis tyre ndërpriteshin. Gjatë këtyre ballafaqimeve, në radhët e malësorëve veprime fermentimi politik dhe shoqëror në favor të ndërgjegjes kombëtare dhe të lëvizies për pavarësi, ndërgjegje kjo që arriti kulmin e vet në kryengritjet e mëdha që ato zhvilluan në vitet e fundit të sundimit osman.

Në viset e tjera të vendit, atje ku ligjet e tregut kishin depërtuar thellë në jetën ekonomike të fshatit dhe ku

Porta kishte mundur të vendoste administratën e saj shtetërore, ndodhi ndryshe. Këtu ritmet e proletarizimit të prodhuesve të vegjël u ngadalësuan në një farë shkalle nga fenomeni i mërgimit në masë të krahëve të punës jashtë vendit.

Në këto vise, kurbeti preku kryesisht fshatarët e vegjël dhe qytetarët e rrënuar. Siç dihet, me kontributin financiar të mërgimtarëve, masa të tëra fshatarësh të vegjël e përballuan deri në një farë mënyre buxhetin familjar dhe i shpëtuan degradimit të mëtejshëm ekonomik, pra proletarizimit të tyre të plotë. Por, sikurse vë në dukje V.I. Lenini kur flet për fshatarësinë ruse, mërgimi ekonomik duke e përmirësuar deri në një farë shkalle gjendjen e fshatarëve të vegjël e dobësoi luftën e tyre klasore, në rastin tonë, luftën kundër administratës osmane. Në fakt, ai e dobësoi luftën në frontin e armatosur, por jo luftën politike dhe ca më pak luftën në frontin ideologjik. Përkundrazi, fenomeni i mërgimit, e shtriu lëvizjen kombëtare edhe jashtë kufijve të Shqipërisë, kudo ku u formuan komitete mërgimtarësh shqiptarë apo koloni shqiptare të mërgimit, siç cilësohen në letërsinë historiografike.

Duke shkuar në mërgim, fshatarët dhe qytetarët morën me vete jo vetëm shqetësimet për problemet e fshatit apo të qytetit të tyre, por edhe urrejtjen kundër pushtuesit shekullor osman. Në mërgim, ata ranë në kontakt me bashkatdhetarë të viseve të tjera të atdheut, zhvilluan së bashku me ta ndërgjegjen e solidaritetit kombëtar dhe, aty ku patën liri veprimi, kaluan shumë shpejt në formimin e organizatave patriotike. Në mërgim, ata ranë në kontakt me ide të reja dhe me eksperiencë të re. Gjatë kthimeve të shpeshta pranë familjeve të tyre, mërgimtarët sillnin në fshatin apo në qytetin e lindjes, pikëpamje të reja dhe mentalitete të reja jo vetëm mbi jetën, mbi punën, mbi shoqërinë, por edhe mbi luftën politike dhe shoqërore, ideologjike dhe kulturore kundër armiqve të çështjes kombëtare.

Ka ndonjë shkrimtar të huaj që e tepron rolin e kurbetit dhe pohon se Lëvizja Kombëtare Shqiptare lindi

jashtë Shqipërisë. Kjo nuk është e vërtetë. Fshatarët dhe qytetarët shkuan në mërgim me dashurinë e atdheut dhe me urrejtjen kundër pushtuesit. Mërgimi nuk bëri gjë tjetër veçse u dha mundësi mërgimtarëve ta shprehnin haptas dashurinë për atdheun, pa frikë se persekutoheshin. Nuk mund të mohohet fakti se për hir të lirisë së veprimit, mërgimi e shpejtoi procesin e kulturimit patriotik të fshatarëve apo qytetarëve kurbetlinj, por ky proces kishte filluar qysh në atdhe. Veç kësaj, procesi i kulturimit patriotik përfshiu edhe fshatarët apo qytetarët që nuk e njohën mërgimin. Si çdo lëvizje revolucionare edhe lëvizja kombëtare nuk mund të importohet. Ajo lind në truallin shoqëror të brendshëm. Kur trualli nuk është i përgatitur, i dëbon idetë e reja, të cilat kur është i përgatitur i krijon vetë apo i gjen edhe pa pasur mërgimtarë. Naum Veqilharxhi, Kostandin Kristoforidhi apo Sami Frashëri i përgatitën abetaret e gjuhës shqipe jo se kishin nevojë mërgimtarët e kolonive, por se i kërkonin qytetarët dhe fshatarët e Shqipërisë. Shkollat shqipe u ngritën brenda në Shqipëri përpara se të ngriheshin kolonitë e mërgimit. Revolucionarizimi ideologjik i lëvizjes kombëtare nuk erdhi nga jashtë, por u krye brenda në atdhe, në gjirin e lëvizjeve të armatosura dhe që këtej kaloi në kolonitë e mërgimit.

Shtypja e përditshme që pësonin shtresat e ndryshme të mikroborgjezisë nga pushteti perandorak osman i ktheu këto forca shoqërore me potencë revolucionare, në forca politike më vete. Për më tepër ato kishin një traditë të pasur luftarake, mbasi kishin përballuar vargun e giatë të kryengritjeve antiosmane. Për këtë arsye ato u bënë bartëset krvesore të Lëvizjes Kombëtare dhe të sunitit të saj madhor — clirimit të plotë të Shqipërisë dhe formimit të shtetit kombëtar shqiptar. Nga këto shtresa doli armata e aktivistëve të Rilindjes Kombëtare të luftës për lirinë e Shqipërisë, për shkollën shqipe, për kulturën kombëtare, për pavarësinë e atdheut. Ideologët e mirëfilltë rilindës. frymëzimin e tyre ideologjik nuk e morën nga aspiratat e bejlerëve cifligarë apo të reshperëve të mëdhenj, por nga shqetësimet e fshatarëve dhe

të zejtarëve të vegjël. Në fakt, ideologët më të shquar rilindës qenë, ashtu siç i ka përcaktuar shoku Enver Hoxha, «demokratë, revolucionarë dhe iluministë», pikërisht sepse shprehën në thelb interesat e masave të gjera prodhuese. Penat patriotike revolucionare të dhjetëvjeçarit të fundit të sundimit osman e kuptonin fitoren e pavarësinë kombëtare jo si qarqet çifligare-reshpere, si një shkëputje të thjeshtë të Shqipërisë nga Perandoria Osmane apo si një zëvendësim mekanik të administratës perandorake turke me administratën shtetërore shqiptare, por shumë më tepër se një fitore politike. Ata e kuptonin pavarësinë kombëtare, ashtu siç e konceptonin shtresat e ulëta, si një përmbysje cilësore, jo vetëm të strukturës politike apo të sistemit arsimor, por edhe të strukturës ekonomike dhe të pozitave shoqërore. Përfytyrimin më klasik të vizionit që kishin rilindësit përparimtarë për Shqipërinë e pavarur e ka dhënë Sami Frashëri në veprën e tij të njohur «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet?» që botoi më 1899. Mund të thuhet se nga pikëpamja doktrinare, vepra e Sami Frashërit e trajton çështjen kombëtare nga këndi i interesave të masave prodhuese mikroborgjeze, të cilat e shikonin rrugën e zhvillimit drejt ekonomisë borgjeze vetëm në kushtet kur Shqipëria të fitonte pavarësinë.

Shpa'lja e pavarësisë kombëtare ishte pra, vepër e masave të gjera prodhuese të qytetit dhe të fshatit. Me vendimin që mori Kuvendi Kombëtar i Vlorës ato shkundën robërinë pesëshekullore osmane dhe formuan shtetin kombëtar të pavarur. Me shpalljen e saj, populli shqiptar shënoi në të njëjtën kohë një fitore historike mbi politikën e mohimit të të drejtave kombëtare që kishin rrdjekur ndaj Shqipërisë Fuqitë e Mëdha dhe monarkitë fqinie, institucionet klerikale dhe bejllurçinat e degraduar. Por ndonëse pavarësia kombëtare ishte pjellë e revolucionit kombëtar të masave të gjera prodhuese, përmbysja politike nuk u shoqërua me përmbysje shoqërore. Pushteti politik mbeti përsëri në duart e qarqeve çifligare-borgjeze. Shteti shqiptar lindi kështu si një shtet me karakter çifligaro-borgjez, karakter të cilin e ruajti

edhe pasi e rimori veten më 1920, nga tronditjet që pësoi gjatë Luftës së Parë Botërore, madje, edhe pas jetës së shkurtër që pati Revolucioni Demokratiko-Borgjez i Qershorit më 1924.

Por ndërkohë, shtresat çifligaro-borgjeze kishin hyrë në rrugën e degradimit klasor. Pas vitit 1912, procesi i rritjes së pronës tokësore latifondiste në tërësi mori fund një herë e përgjithmonë. Në vend të tij veproi me ritme më të shpejta procesi i copëzimit dhe i pakësimit të pronës së madhe latifondiste, i cili në fakt kishte filluar qysh në çerekun e fundit të shek. XIX. Gjatë viteve '20 dhe sidomos gjatë viteve '30. ritmet e copëzimit dhe të pakësimit të pronës së madhe latifondiste morën përpjesëtime të papara deri atëhere. Me këto përpjesëtime, baza ekonomike e bejlerëve çifligarë erdhi vazhdimisht duke u ngushtuar. Nga 140.000 ha tokë që zotëronin pronarët çifligarë më 1912 brenda kufijve të sotëm të Shqipërisë, më 1945 pronat e tyre ishin pakësuar dhjetëfish. Ato qenë ulur në 14.550 ha. Masat që mori regjimi i Zogut, ndihmuan në borgjezimin e mëtejshëm të ekonomisë çifligare. por nuk e ndaluan shpërbërjen e pronës çifligare. Dobësimi i bazës ekonomike solli si pasojë degradimin klasor të pronarëve çifligarë. Qarqet çifligare dhe borgjeze, filluan të kërkonin mbështetje gjetkë duke e sakrifikuar edhe pavarësinë e Shqipërisë. Pasojë e këtij degradimi klasor ishte degjenerimi politik, i cili i çoi ata në kapitullimin e tyre para Italisë fashiste në prill të vitit 1939 dhe para Gjermanisë hitleriane në shtator të vitit 1943.

Tokat që humbën pronarët çifligarë nuk kaluan në duart e fshatarëve të vegjël, por të fshatarëve të pasur, të cilët në pragun e çlirimit të Shqipërisë zinin, si pronarë vendin e parë në kostelacionin e forcave shoqërore të fshatit. Edhe e ashtuquajtura reformë agrare zogiste nuk e likuidoi masën e fshatarëve pa tokë, madje as e pakësoi numrin e tyre, sepse krahas qindra familjeve që u pajisën me tokë nga pronat shtetërore, me mijëra familje fshatarësh të vegjël i humbën ngastrat e tyre. Po ashtu

edhe në qytet, ekonomia zejtare erdhi, sidomos gjatë viteve '30, duke u rrënuar vazhdimisht.

Megjithatë, ndryshimi më i rëndësishëm që ndodhi në strukturën shoqërore të Shqipërisë së pavarur, ishte zhvillimi i klasës punëtore. Numerikisht klasa punëtore e angazhuar në objektet industriale që e paktë, sepse edhe njësitë kapitaliste të prodhimit, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, mbetën të kufizuara. Por radhët e tyre u rritën me evolucionin që pësuan forcat prodhuese në sektorë të tjerë të ekonomisë. Të përfshira në qerthullin e ligjeve ekonomike kapitaliste të epokës së imperializmit, ndryshoi, për shembull, përmbajtja dhe karakteri i prodhuesve të vegjël të qytetit dhe të fshatit. Përditë e më tepër, zejtaret e vegjël dhe fshatarët e vegjël morën tiparet e punëtorëve mëditës. Tiparet e reja klasore që ata morën lehtësuan përhapjen e ideologjisë marksiste jo vetëm në radhët e masave punëtore, por edhe në gjirin e prodhuesve të vegjël.

Si pasojë e këtij evolucioni u krijua një front i përbashkët politik midis klasës punëtore dhe shtresave mikroborgjeze, të cilat synuan të çliroheshin nga pushteti çifligaro-borgjez i Ahmet Zogut dhe nga klasa shfrytëzuese çifligaro-reshpëre, e cila si klasë e degjeneruar politikisht, ishte gati të shkelte pavarësinë kombëtare dhe të hynte nën ombrellën e Italisë fashiste. Pikërisht në këto rrethana, lufta e masave popullore kundër regjimit të Zogut, zhvillohej në fakt jo vetëm për çlirimin e tyre shoqëror, por edhe për të shpëtuar pavarësinë kombëtare të atdheut. Flamurin e luftës për pavarësinë kombëtare e mbajtën përsëri në dorë masat prodhuese, por këtë radhë nën udhëheqjen e klasës punëtore dhe jo të shtresave mikroborgjeze. Kështu u krijua baza shoqërore, e cila çoi në themelimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë dhe në epopenë e lavdishme që u zhvillua, nën udhëheqjen e saj, me Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare.

PASQYRA E LËNDËS

ALEKS BUDA	— Fjala e hapjes	5
STEFANAQ POLLO	— Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë	9
SOFOKLI LAZRI	— Lëvizja Kombëtare Shqiptare dhe revolucioni popullor	33
ALFRED UÇI	— Kultura kombëtare në rrjedhat e luftës për liri e pavarësi	49
ARBEN PUTO	— Pavarësia e Shqipërisë në kuadrin e procesit çlirimtar në Ballkan	67
HEKURAN MARA VENIAMIN TOÇI	— Mendimi ekonomik shqiptar në periudhën e pavarësisë	87
KRISTAQ PRIFTI	— Uniteti kombëtar dhe pavarësia	107
KRISTO FRASHËRI	— Forcat shoqërore dhe pavarësia kombëtare	129

Tirazhi 2000

Formati 78x109/32

Stash 2204-82

Shtypur KOMBINATI POLIGRAFIK

Shtypshkronja e Re, Tiranë 1987